



SOT

Themeluar në 26 Tetor 2002

Çmimi 30 lekë

E Enjte 4 Korrik 2024



Pazar në tavolinë, ja si **Belinda Balluku** i jep pa tender 12 milionë euro kompanisë holandeze që po ndërton portin e ri në Porto Romano, zbardhen detajet e forta nga skandali



Faqe 6

Ja arsyet e forta që po vonojnë SPAK të firmosin fletë-arrestet për Sali Berishën dhe Ilir Metën, emri i tyre ka dalë dhe në vrasje, Idajet Beqiri zbardh informacionet e fundit dhe paralajmëron “ditë të zeza” për Flamur Nokën, si do ta fundosë dosja voluminoze që po hetojnë prokurorët specialë

Faqe 3



Deputeti i PS Bujar Çela zbardh prapaskenat “bombastike”: Ja si u infiltrua Ilir Meta nga Sali Berisha brenda Partisë Socialiste, detajet nga bashkëpunimi me ish-Sigurimin e Shtetit dhe këshilltari brenda strukturës së SPAK që po i bën ‘gropën’ ish-presidentit

Faqe 2

Ja emrat e kandidatëve për kreun e Gardës së Republikës, kush janë 6 aplikantët, rikthehet ish-kryepolici i njohur, mes tyre edhe një grua

Faqe 9

Spartak Ngjela paralajmëron ndryshime drastike pas 5 korrikut, ja çfarë do të ndodhë me ardhjen e ambasadorit të ri amerikan në Tiranë, goditja e madhe që do të marrë PD dhe goditjet ‘VIP’ që po përgatit SPAK

Faqe 5



Faqe 10

“Kuvendi gjithëserb” trazon sërish ujërat në Ballkan, Perëndimi humb durimin me Dodikun, Përfaqësuesi i lartë i komunitetit ndërkombëtar kërcënon liderin serb të Bosnjës, ja vendimi i fundit që ka nxitur polemika



Faqe 11

Dhjetëra mijëra ushtarë rusë kanë zbarkuar në kufirin me Ukrainën, vendosen edhe armët bërthamore në gatishmëri, shteti “vasal” po pret “dritën jeshile” nga Kremli, ja çfarë do të ndodhë nëse ata sulmojnë papritur

Gazmend Koduzi: Skandali i Onkologjikut simptomë e sistemi të degraduar, reforma e demokratëve euroatlantike vendos qytetarin të parin, me parimin ‘paraja ndjek pacientin’

Faqe 4

Ja pse rritja e pensioneve është një gënjeshtëri, niveli i tyre pritet të shkojë në kufijtë e qesharakes, eksperti i njohur i ekonomisë paralajmëron lajme jo të mira për pensionistët

Faqe 7

I dhuroi tokë Arqile Bollanos, SPAK kërkon arrestim të dytë për Jorgo Goron, në hetim dhe kryetar i komanduar i Bashkisë Himarë që përfitoi 4900 metra dhe bëri mbivendosje

Faqe 8

KOMENT & ANALIZË

Faqe 16-18

Nga Bardhyl BEJKO

“Diskriminim” me rrugë të standardeve ndërkombëtare?!

Nga Tritan KALO

Koha për ndryshime thelbësore politike është një emergjencë kombëtare

Nga Qamil GJYREZI

PD euroatlantike ka statut, baza kërkon dhënien fund tranzicionit dhe korrupsionit!

Nga Ilmi QAZIMI

Gjemba e hithra, këto fakte e shifra

Nga Gjon NEÇAJ

“Atdheu dhe nëna nuk harrohen!”

RAJON & BOTË

Macronit i buzëqesh fati, përmbysen sondazhet, e djathta nuk e siguron dot shumicën, çfarë pritet të ndodhë në 7 korrik, ja pse opsioni i “bashkëjetesës” politike po kundërshtohet kaq shumë

Faqe 13

Përmbysje e madhe në horizont, zbulohet e vërteta për largimin e Biden, edhe Obama është pesimist, ja pse presidenti ka shumë gjasa të humbë zgjedhjet, kush është gruaja që mund të zërë vendin e tij

Faqe 12

politikë

“Sali Berisha po vuan shumë keq në atë ballkon dhe ajo vula nuk do të ketë asnjë funksion për të bashkuar opozitën rreth tij”

Deputeti i PS Bujar Çela zbardh prapaskenat “bombastike”: Ja si u infiltrua Ilir Meta nga Sali Berisha brenda Partisë Socialiste, detajet nga bashkëpunimi me ish-Sigurimin e Shtetit dhe këshilltari brenda strukturës së SPAK që po i bën ‘gropën’ ish-presidentit

Deputeti socialist, Bujar Çela ka komentuar situatën politike në vend, ndërsa ka hedhur akuza të forta në adresë të ish-kryeministrit Sali Berisha dhe presidentit të Partisë së Lirisë, Ilir Meta. Gjatë një interviste për gazetën “SOT”, deputeti Çela zbardh prapaskenat “bombastike”, ndërkohë që tregon si u infiltrua Ilir Meta nga Sali Berisha brenda Partisë Socialiste. Po ashtu, ligjvënësi i PS zbulon edhe detaje nga bashkëpunimi i zotit Meta me ish-Sigurimin e Shtetit. Ndër të tjera, zoti Çela flet edhe për një këshilltar brenda strukturës së SPAK që po i bën ‘gropën’ ish-presidentit Ilir Meta.



struktura kriminale. Sali Berisha është mëshiruesi i këtij objekti që ka SPAK-u si strukturë e drejtësisë së re të pavarura e cila nuk besoj se do të dëgjoj protestat çjerrëse të Sali Berishës ose qorrazi e mbështesin nga përfitimet që kanë nxjerr duke i rënë më qafe popullit shqiptar, mjedisit shqiptar, politikës shqiptare si dhe integritit të tej zgjatur të Shqipërisë në Europë e duke na bërë të mos besueshëm.

-Nga ana tjetër edhe ish-presidenti Ilir Meta nuk mbetet pas nga Sali Berisha, ku gjatë një takim me banorët e banorëve në Roskovec iu bën thirrje qytetareve shqiptareve duke iu thënë me një deklaratë se “Merrni armët kundër maskarenjve, do vij dhe unë me kallash se di të qëlloj mirë”. Si e komentoni këtë deklaratë dhe a duhet të dënohet për këtë thirrje?

Tashmë, ish-Presidenti në emër të tjetërsuar, këto deklaratat i ka bërë edhe herë të tjera. Unë i jam drejtuar edhe medias nëpërmjet jush dhe opinionit e veçanërisht strukturës së SPAK, se nuk ka se çfarë heton pasi këto janë thirrje anti-shqiptare, thirrje të cilat nuk kanë nevojë të hetohen. Këto janë vepër kriminale, vepër të cilat çdo pushtues do t'i dënonte dhe jo më ne që mbrojmë lirinë, demokracinë e këtij vendi. Jo vetëm SPAK që është struktura më e lartë e sistemit të drejtësisë dhe Ilir Meta është një ndër krye materialet që duhet të ketë SPAK në punën e përditshme. Ky i fundit ka Ilir Metën dhe Sali Berishën. Nuk ka gjykim shterues ndaj Sali Berishës në rast se nuk dënohet në fillim Ilir Meta i cili është bashkëpunëtori i vjetër i cili që në socializëm spiunonte shokët dhe duke futur brenda radhëve

zotit Meta dhe drejtësia e re po vepron tashmë për t'i sekuestruar pasurinë e padeklaruar?

Ai është duke bërë një teatër familjar ku po mundohet duke ua shitur të gjithë shqiptarëve e nga ana tjetër po mundohet të luaj edhe me SPAK-un. Nuk besoj se SPAK ka kohë të nevrkoset e të mërzhitet nga këto deklaratat. Me deklaratat të tilla e të përditshme që bën zoti Meta, nuk shfaqësohet e përkundrazi vazhdon të bëjë teatër e rëndon situatën në të cilën ndodhet. Ai vazhdon të bëjë teatër nga një këshilltar i cili e këshillon që të sillt në këtë mënyrë. Mbase ka dhe ndonjë këshilltar brenda strukturës së SPAK, që i thotë sillu si i papërgjegjshëm, hidhu nëpër kalanë e nis të bësh garë me Edi Ramën se kush loz më shumë. Unë them se mbase është dhe dikush tjetër që e këshillon të tallet që të fitoj kohë ndaj drejtësisë së re. SPAK dhe reforma në drejtësi i shpërben çdo kujt që nuk ka mundësi ekonomike, që nuk ka mik, i shërben atij që i beson qeverisë së tij dhe beson në zot. SPAK dhe struktura kundër korrupsionit dhe kriminit të organizuar është shpresë për votuesit shqiptar të ndershëm që nuk i lidh gjë as me krimin edhe as me korrupsionin. Por, thjeshtë ka qenë i mashtruar i Sali Berishës dhe i Ilir Meta e ndoshta dhe ndonjë kolegu im se ka shumë që premtojnë rrugës por ndërrojnë më pas.

-Gjithashtu në SPAK ka shumë

dosje dhe kallëzime të cilat janë mbërritur në strukturën e drejtësisë së re ndaj te korrupsionarve, pjesë dhe aktor të politikës shqiptare, a mendoni se pritet ditët në vijim të ketë arrestime dhe si e shihni punën e SPAK, në proces avangardë apo të ngadalë për sa kohë nuk kemi arrestime deri tani?

Unë kam besim të plotë ndaj SPAK dhe të gjithë strukturave të reja në sistemin e drejtësisë. Mbase dhe unë jam si i gjithë populli dhe qytetarët ku dua dënime dhe arrestime të shpejta pasi duket se asgjë nuk po bëhet por ligjet dhe ato vepra që gjykon kjo strukturë, me të vërtetë duan kohën e saj, pasi nuk mund të ketë dënime të gabuara e duke kërkuar falje. Prandaj, këto vendime dhe kalime në Gjykatë SPAK-u i bën të menduara sepse nuk mund të bëjë korrigjime e si të tillë ka një reformë shumë të thellë në drejtësi të dënimeve. Por nga ana tjetër nuk mund të gjykoj SPAK në kryerjen e një dënimi pas një procesi, pasi nuk thonë kot se drejtësia do dava dhe para, do kohën e saj e cila kjo e fundit herë vret e herë edhe shëron. Ndaj si e tillë, koha është gjykatësi më i drejtë. Ndaj unë sot i të gjithë qytetarët kam një mendim dhe them se SPAK është një strukturë aq e matur, e strukturuar, e trajnuar nga vendi i demokracisë së madhe, i cili e udhëheq, e inicion, e paguan dhe kam besim se rezultatet do të jenë shumë të gjithë pranuar.

Intervistoi: Rigels SELIMAN

Ministria e Drejtësisë nxjerr për konsultim strategjinë kombëtare kundër pastrimit të parave

Ministria e Drejtësisë ka nxjerrë për konsultim publik Strategjinë Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit për periudhën 2024-2030. Ky dokument është produkt i një procesi të gjatë koordinimi dhe bashkëpunimi ndër-institucional, duke përfshirë praktikantët më të mirë të fushës dhe nevojat e evidentuara nga institucionet e përfshira. Qëllimi kryesor i Strategjisë është krijimi i një ekonomie dinamike dhe një sistemi financiar të sigurtë dhe të integruar, duke përmirësuar dhe modernizuar regjimin kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Strategjia synon garantimin e sigurisë së shtetasve shqiptarë dhe respektimin e të drejtave dhe lirive individuale.

Për të arritur këtë qëllim, janë identifikuar katër prioritetet kryesore: Përmirësimi i politikbërjes dhe koordinimit. Rritja e efektivitetit operacional në parandalim. Përmirësimi i efikasitetit operacional të organeve ligjzbatuese dhe agjencive të tjera. Përdorimi dhe shfrytëzimi i inovacioneve teknologjike duke zvogëluar rreziqet. Strategjia adreson masat specifike për arritjen e qëllimeve dhe prioritetëve të saj, duke marrë parasysh edhe harmonizimin me dokumente të tjerë strategjikë kombëtarë. Në dokumentin udhëzues për formulimin e strategjisë, janë përfshirë dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe politikat për nxitjen e ritmeve të zhvillimit ekonomik të vendit, sigurimin e

mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve dhe integritimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Plani i veprimit i Strategjisë përfshin një seri masash për periudhën 2024-2027, duke përcaktuar objektivat specifike dhe treguesit strategjikë. Masat janë rezultat i një procesi të përbashkët dhe dakorduar nga autoritetet publike dhe sektori privat, të cilët janë të përfshirë në luftën dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Kjo strategji pritet të përforcojë përpjekjet e autoriteteve për të penguar kriminelët dhe kërcënimet e sigurisë kombëtare që të aksesojnë në sistemin financiar të vendit, duke siguruar kështu një sistem financiar të qëndrueshëm dhe të besueshëm për të gjithë qytetarët shqiptarë.

Idajet Beqiri: Ndaj Metës dhe Berishës ka një numër të madh kallëzimesh penale

Ja arsyet e forta që po vonojnë SPAK të firmosin fletë-arrestet për Sali Berishën dhe Ilir Metën, emri i tyre ka dalë dhe në vrasje, Idajet Beqiri zbardh informacionet e fundit dhe paralajmëron “ditë të zeza” për Flamur Nokën, si do ta fundosë dosja voluminoze që po hetojnë prokurorët specialë

Rigel SELIMAN

Avokati i njohur Idajet Beqiri ka komentuar zhvillimet e fundit politike. Në një reagim për gazetën “SOT”, zoti Beqiri tregoi arsyet e forta pse Prokuroria e Posaçme (SPAK) po vonon firmosjen e fletë-arresteve për ish-kryeministrin Sali Berisha dhe ish-presidentin Ilir Meta, kur i ka të gjitha provat para syve. Sipas tij, SPAK do t’i verifikojë deri në fund e të bëjnë një hetim shterues. D.m.th, t’ua hedhin poshtë të gjitha pretendime të pa baza dhe që të dali procesi i rregullt, i pastër nga çdo lloj pikëpamje edhe përmes provueshmërisë dhe e ligjshmërisë e të gjithë procesit. “Mesa duket meqë e ka si procedim të parë, si për Saliun, si për Ilir Metën dhe këto janë dy ish-Presidentët e Republikës dhe ish-Kryeministra, SPAK-u do që t’i zbatojë të gjitha procedurat e t’i ketë të gjitha të pastra, t’u garantojë një proces të rregullt ligjor me qëllimin që të ketë një përputhshmëri me nenin 6 e Konventës Europiane për liritë dhe të drejtat e njeriut. Ç’ka do të thotë që në çdo lloj aspekti e pretendimi që ata ngrenë kur pyeten, pasi iu janë marrë deklaratimet atyre, për gjithçka që akuzohen e për çdo provë që ka kundër tyre, etj, të paktën në këto procese që janë të hapura si për Sali Berishën dhe për Ilir Metën. Ata paraqesin pretendimet e tyre e SPAK do t’i verifikojë deri në fund e të bëjnë një hetim shterues. D.m.th, t’ua hedhin poshtë të gjitha pretendime të pa baza dhe që të dali procesi i rregullt, i pastër nga çdo lloj pikëpamje edhe përmes provueshmërisë dhe e ligjshmërisë e të gjithë procesit. Kjo e bën SPAK-un si fillim pasi është çështje e parë që do të futet faktikisht sa të hapet rruga e pastaj ato janë varg kallëzimesh penale kundër tyre dhe krimet që ata kanë kryer. Pasi janë krime të jashtëzakonshme, jo vetëm korrupsion por deri dhe në vrasje dhe pastaj ato do të vazhdojnë”, deklaroi avokat Beqiri.

Emri tyre del edhe në vrasje

Avokat Idajet Beqiri theksoi gjithashtu se emri i Berishës dhe Metës del edhe në vrasje. “Kjo është e para sipas vlerësimit tim e duan që çdo gjë ta kenë të kopsitur mirë por nga ana tjetër unë shoh që edhe një lloj ‘politike’



ku po gjejnë momentin e duhur, po krijojnë edhe terren duke marrë e duke vënë në bankën e të akuzuarve edhe për gjëra të vogla dhe kur të vij problemi pastaj të thonë se për gjëra kaq të vogla, për afëra të vogla i kemi të arrestuar, i kemi në burg, po ju që keni bërë këtë malin e madh me korrupsion dhe me krim që ka shkaktuar dëme të pallogaritshme vendit e popullit shqiptar. Edhe kjo është një lloj politike e cila nuk duhet pranuar dhe jam kundër pasi kush ka shkëlur ligjin nuk duhet të bëjmë shumë hesape dhe temenaja, pasi këto nuk janë të veçantë por para ligjit të gjithë janë të barabartë. E derisa themi para ligjit të gjithë të barabartë, standarti është një. Ato standarde që kemi zbaruar për të gjithë shqiptarët duhet të zbatohet për këta. Kuptohet, kurrën e kurrës nuk duhet shkëlja e ligjit dhe të drejtat e njeriut, një ish-Presidenti dhe një ish-Kryeministri, nuk e merr dot me mend se çfarë mund të bëjnë më pas për qytetarët e thjeshtë. Por ama kurrën e kurrës nuk duhet t’i mbivlerësojmë dhe t’i bëjmë mbinjerëz, sikur janë fantazma e kanë zbritur nga qielli”, u shpreh avokati Beqiri.

Si do fundoset Flamur Noka?

Nga ana tjetër, avokati Idajet Beqiri ka paralajmëruar “ditë të zeza” edhe për ish-ministrin e Brendshëm, Flamur Noka, të cilin e ka kallëzuar në SPAK. Zoti Beqiri, tha se përpjekjet e tij për t’u përgjigjur atij me kallëzim penal ndaj tij, por edhe nga mediat janë të dështuara, pasi në fund

sipas Beqirit, Noka nuk do ta justifikojë dot pasurinë e tij. “Fakti që SPAK e ka regjistruar procedimin penal, fakti që kanë filluar hetimet kundër tij, fakti që po verifikohen pasuritë e tij e me çfarë mjete i ka vendosur ato ai vetë në emër të tij por edhe në emër të vëllait, motrës së tij e pjesëtarëve të tjerë të familjes së tij. A i justifikon apo jo me të ardhurat që ka, a i ka deklaruar këto të ardhura apo nuk i ka deklaruar, a e ka shpërdoruar detyrën e ministrit të Brendshëm. Ai po hetohet për këto dhe derisa po hetohet, kjo do të thotë që ai kallëzim penal është i bazuar se ndryshe nëse kallëzimi penal që çohet në SPAK nuk është i bazuar dhe nuk ka element të veprës penale, nuk ka dyshime të arsyeshme, Prokuroria e Posaçme nuk fillon procedimin penal fare dhe merr vendimin e procedimit penal se nuk ka bazë etj. Por fakti që e ka filluar do të thotë që ka dyshime të bazuara në prova të cilat tregojnë që ai edhe pastrim të parave ka bërë edhe mos deklarim të të ardhurave ka bërë por as nuk justifikon pasuritë që i ka vendosur dhe që me të ardhurat e tija ai nuk mund të viheshin kurrë gjatë gjithë jetës. Përpjekjet e tija me kallëzime e me të tjera, janë dëshpërim e tij por që fundin e kanë që nuk do ua marr njeri në konsideratë e do ua hedhë poshtë pasi nuk bëhet fjalë për shpifje por bëhet fjalë për gjëra që ai i ka kryer dhe për ato duhet të përgjigjet para ligjit

“Përpjekjet e tija me kallëzime e me të tjera, janë dëshpërim i tij por që fundin e kanë që nuk do ua marr njeri në konsideratë e do ua hedhë poshtë pasi nuk bëhet fjalë për shpifje por bëhet fjalë për gjëra që ai i ka kryer dhe për ato duhet të përgjigjet para ligjit”, përfundon reagimin për gazetën “SOT”, avokat Idajet Beqiri.

Berisha: Më 11 korrik t’i dëshmojmë njëri-tjetrit dhe botës se ne jemi shumica, se ne jemi fitorja, e ardhmja, ndryshimi

Kryetari i Partisë Demokritike, Sali Berisha i ka bërë thirrje dje qytetarëve nga ballkoni i banesës së tij, që t’i bashkohen protestës kombëtare të thirrur nga opozita në 11 korrik përpara Kryeministrisë. “Të premen, qyteti te bashkia. Prania e kreut të grupit strukturuar kriminal të bashkisë, që mbrohet nga Altin Dumani, është poshtërim për të gjithë qytetarët e Tiranës. Ndaj dhe e premtja le të jetë dita e fundit e tij. Dita e turpit e tij. Dita që duhet të varet në shtyllën e turpit të historisë. 11 korriku është dita e çdo shqiptari. Është dita e të gjithë qytetarëve që e duan Shqipërinë. Është dita e çdo shqiptari që i qan, që i lëngon shpirti dhe zemra për zbrazjen e këtij vendi. Është dita e çdo

qytetari që i dhemb shpirti dhe zemra kur mendon se 18 përqind e fëmijëve nuk kanë më shumë se ose një dy vakte ushqim në ditë. Është dita e çdo shqiptari që ka zemër dhe i dhemb shpirti kur mendon se qindra e mijëra të sëmurë me sëmundje të rënda nuk marrin dot ilaçet e tyre sepse Edi Rama blen stolinë për oborrin e tij 4 milionë euro. Sepse shpenzon me udhëtimet me avion-taksi 21 milionë euro. Ndaj dhe me 11 korrik, t’i dëshmojmë njëri-tjetrit, t’i dëshmojmë botës se ne jemi shumica. Se ne jemi fitorja. Se ne jemi ardhmja. Se ne jemi ndryshimi. Sepse ne do bëjmë zgjedhje të lira, do fitojë opozita, do fitojë Shqipëria. Rrofshi ju, rroftë Shqipëria. Fitore, fitore, fitore”, deklaroi dje Berisha.

Sali Berisha: Altin Zamani dhe Gjoka me 5 mbiemra, fshehën dokumentin që thotë se 5D e Veliajt, plotëson çdo kusht si grup i organizuar kriminal

Ish-kryeministri Sali Berisha ka akuzuar drejtuesin e SPAK, Altin Dumanin dhe gjyqtaren e Gjykatës së Posaçme, Irena Gjoka, se janë fshehur dokumentin që flet se dosja 5D e drejtorëve bashkiak të Erion Veliajt, i plotëson kushtet juridike për t’u hetuar si grup i organizuar kriminal. “Miq të e mi, përsëri në këtë sistem të shndërruar në degë të ekzekutivit, nuk ka vetëm Gjoka me pesë mbiemra, Zamani me tre mbiemra, Kraja xhelat Sigurimi, Millonai skllave mjerane e bandave, por ka gjykatës të ndershëm, të cilët i thanë Edi Ramës, na pe se krimi i asociuar ekziston. Se grupi i organizuar kriminal ekziston në administratën. Se drejtorët e Erion Veliajt janë grup i strukturuar kriminal. Prej një muaji, Altin Zamani, prej një muaj Gjoka me pesë mbiemra që qëndron aty për krimet që ka kryer, bashkë me atë tjetrin, kanë fshehur dokumentin. Dokumentin i cili thotë se 5D e Erion Veliajt plotëson çdo kusht ligjor për t’u cilësuar grup i organizuar kriminal. Por Altin Zamani, në marrëveshje me Edi Ramën, ka

ndaluar përdorimin e neneve për grup të strukturuar kriminal apo për organizatë kriminale për zyrtarë të administratës, ministra e të tjerë. Neni thotë: grup i strukturuar kriminal quhet kur tre persona ose më shumë janë të lidhur në një veprë penale, bashkëpunojnë për një kohë të caktuar. Plotësojnë çdo kriter, grupi i strukturuar kriminal është Edi Rama, Engjëll Agaçi, Artur Metani, Erion Veliajt. Qytetarë dhe qytetare, kur një prokurorë pa asnjë mbrojtje guxon dhe godet klanet e kriminit të Edi Ramës, kur një gjykatës në emër të ligjit shpall grup të strukturuar kriminal banditët e Erion Veliajt, a nuk është ky një detyrim madhor për çdo shqiptar të ngrihet në këmbë për t’u treguar vendin këtyre bandave? Nuk mund të presë një shoqëri e tërë nga një prokurorë apo disa, nga një gjykatës apo disa, që të shkëlmojë këtë shtet kriminal mafioz, që shkëlmon çdo ligj, çdo normë, çdo parim? Jo dhe jo, duhet të jemi ne, qindra mijëra, të bëjmë detyrën tonë”, nënvizoi dje kreu i PD, Sali Berisha para qytetarëve nga ballkoni i banesës së tij.

"PD përmes programit të saj i shpall luftë korrupsionit, duke mbështetur SPAK"

Gazmend Koduzi: Skandali i Onkologjikut simptomë e sistemi të degraduar, reforma e demokratëve euroatlantikë vendos qytetarin të parin, me parimin 'paraja ndjek pacientin'

Drejtuesi i Departamentit të Shëndetësisë së Demokrateve Euroatlantikë, Gazmend Koduzi ka komentuar aktualitetin në vend. Gjatë një interviste për gazetën "SOT", zoti Koduzi theksoi se skandali i Spitalit Onkologjik është simptomë e sistemi të degraduar. Sipas tij, reforma e Demokratëve Euroatlantikë vendos qytetarin të parin me parimin "paraja ndjek pacientin".

-Zoti Koduzi, cilat janë prioritetet kryesore të demokratëve euroatlantikë në këtë moment?

Aktualisht vendi ndodhet në udhëkryq, nëse do të marrë rrugën europiane duke luftuar korrupsionin, zhvilluar demokracinë përmes zgjedhjeve të lira dhe të ndershme apo do të rrëshqasë në autoritarizëm. Nëse do të ndër-marrë reforma për të zhvilluar ekonominë, rritur punësimin, rritur të ardhurat e familjeve, ulur koston e jetesës, reformimin e sistemit shëndetësor që është në koma apo do të vazhdojmë të lëngojmë, dhe shqiptarët të emigrojnë. Nisur nga shqetësimet kryesore të qytetarëve dhe shoqërisë tonë, është detyra e politikës, por mbi të gjitha e jona si forcë e djathtë, që t'i delegojmë problemet dhe japim qytetarëve mënyrën e zgjidhjes së tyre.

-Si mendoni se mund të kontribuojë më së miri në përparimin e vendit në këtë kohë?

Ne si forcë politike bazohemi në ideologjinë e djathtë, që ka në themel familjen, pronën, ligj dhe rend, besimin në Zot. Bazuar në këto parime, ne prezantuar para shqiptarëve programin tonë politik, që ju jep zgjidhje shumë problemeve të shoqërisë. Ne i japim zgjidhje përfundimtare çështjes së pronës, që gjatë 34 vjetëve jo vetëm ka frenuar zhvillimin ekonomik, por ka shkaktuar me mijëra viktima. Madje në këtë pikë, ne i kërkojmë ndjesë qytetarëve dhe pronarëve, që Partia Demokratike si forcë e djathtë, nuk e ka zgjidhur por e ka komplikuar çështjen e pronës përmes zbatimit të ligjit 7501 si dhe legalizimit të zënies së pronës. Ne i japim zgjidhje përfundimtare problematikave të mbartura dhe dëmshpërblimit të ish të përndjekurve politikë, që është një plagë e hapur e shoqërisë. Për zhvillimin ekonomik dhe rritjen e punësimin dhe të ardhurave, ne bazohemi në parimet e djathta: qeveri e vogël dhe taksa të ulta. Taksa e sheshtë 9% mendojmë që do të formalizojë më shumë ekonominë dhe lejojë që qytetarët të kenë më shumë sasi monetare për të shpenzuar për të mirën e familjes. Ne mendojmë që çështja kyçe që duhet zgjidhur dhe ndikon në cilësinë e qeverisjes dhe demokracisë është reforma



zgjedhore. Për këtë kemi tashmë një vit që kemi propozuar dhe hedhur për debat në publik propozimin tonë për votimin elektronik, votimin e shqiptarëve që banojnë jashtë vendit, listat e hapura dhe barazinë e votës.

-Çfarë strategjish keni për të adresuar çështjet kyçe në sektorin e shëndetësisë?

Shëndetësia është një nga sektorët më të rëndësishëm në skemën politike, sepse përveç se kujdeset për shëndetin e popullatës, nga ana tjetër është edhe një komponent shumë i rëndësishëm ekonomik që qarkullon 6% të GDP ose afro 1.4 miliardë Euro në vit. Sistemi shëndetësor shqiptar është më pak i reformuar në vend, madje është një rudiment i sistemit socialist Semashko, ku ofruerit e kujdesit shëndetësor (qendrat shëndetësore, spitalet) financohen bazuar në buxhet historik, ndërsa personeli mjekësor paguhet me rrogë fikse pavarësisht performancës së tyre. Ne ju kemi prezantuar shqiptarëve vizionin tonë për shëndetësinë dhe reformat që do të kryejmë. Momenti kryesor kur qytetarët u ndërgjegjësuam për gjendjen në shëndetësi dhe nevojën e reformimit, ishte gjatë epidemisë së covid-19, ku sistemi ynë shëndetësor performoi më keq nga gjithë rajoni dhe nuk ju përgjigj pritishtësisë të popullatës. Shqipëria pati numrin e vdekjeve të tepërta (excess deaths) më të lartit në rajon me afërsisht 15000, qytetarë që nuk diagnostikoheshin në kohë, pamundësi trajtimi në spital, dhe shpenzime katastrofike nga xhepi deri në 50 mijë Euro për ata që ikën jashtë vendit. Faktikisht, programi ynë i delegon dhe ju jep zgjidhje të gjitha këtyre problemeve, duke vendosur në qendër të sistemit qytetarin dhe nevojat e tij. Kjo fillon në radhë të parë duke reformuar politikbërjen dhe mentalitetin me të cilin behën politikën dhe ligjet në sistemin shëndetësor. Gjithë të mirat apo të këqijat e sistemit shëndetësor vijnë nga politikbërja, që burimin e kanë në Ministrinë e Shëndetësisë. Gjatë 11 vjetëve të qeverisjes socialiste, ky institucion është dre-

dhe kompanive prestigjioze, duke hapur rrugën barnave me origjinë jo të sigurtë, cilësi e ulët, si dhe uljen e numrit të alternativave. Nuk u mendua asnjëherë që pacienti të trajtohet me mjekime bashkëkohore, minimalisht të krahasueshme me vendet e rajonit. Barnat me rimbursim bazohen në një listë të kufizuar, që hartohet mbi baza klienteliste. Lista e barnave me rimbursim në vend ka vetëm 255 molekula, ndërsa vendet rajonit të Adriatikut kanë 962 molekula, ndërsa shpenzime për capita është 35 Euro, krahasuar me 158 Euro vendet e Adriatikut. Ne përmes reformës do të sigurojmë akses në shumëllojshmëri barnash cilësore për çdo qytetar, në çdo farmaci, me efikasitet të garantuar, bashkëkohore dhe pa mungesa si ndodh tani në farmacitë spitalore dhe të rrjetit të hapur. Çdo pacient do marrë me rimbursim të gjitha barnat që ka nevojë për trajtimin e sëmundjes (rimbursim bazuar në diagnozë), dhe jo si deri tani, për një numër të kufizuar që ka lista.

-Çfarë mendoni për skandalin e Onkologjikut? Si duhet të vepronë një qeveri e përgjegjshme në këtë moment?

Skandali te onkologjiku është një simptomë e sistemi shëndetësor të degraduar në dimensionin moral, organizativ dhe institucional. Sigurisht, është e papranueshme që mjekët të cilët kanë bërë betimin e Hipokratit, për t'u përpjekur deri në momentin e fundit për të shpëtuar jetën e pacientit, nuk shërojnë por "vrasin" pacientët duke mos u dhënë dozën e duhur të barit. Punonjësit e administratës, ata që paguhën dhe kanë për detyrë zbatimin e rregullave dhe udhëzimeve, bëhen bashkëpunëtorë në korrupsion. Institucioni i QSUT tregoi 11 vite keqmenaxhim ashtu si gjithë sistemi shëndetësor, si dhe mungesë të mekanizmave për të kontrolluar cilësinë e kujdesit ndaj pacientit, nga momenti që hyn në spital dhe deri te hapi i fundit i trajtimit, nëse e merr barin e duhur dhe dozën e përshkruar nga mjeku. Faktikisht, kjo situatë është pasojë e demagogjisë politike të Ramës për shëndetësi falas, ndërkohë që e ka bërë më të shtrenjtë jo vetëm jetën, por edhe vdekjen. Kjo nuk do të ndodhte, nëse shëndetësia jonë do të kishte mjaftueshëm fonde për të blerë barna, poltronë për të marrë mjekimin te onkologjiku dhe japë personelit mjekësor paga dinjitoze, por shëndetësia jonë është më e keqfinancuara në rajon me 2,9% të GDP, dhe një pjesë e mirë e saj prej 53 milion Euro në vit shkojnë për koncesione korruptive në xhepat e klientëve të Ramës. Prandaj onkologjiku nuk ka barna mjaftueshëm, dhe pacientët duhet të paguajnë në dorë edhe për të marrë dozën e radhës në spital apo

për të tejkaluar radhën. Sipas një studimi që kam kryer për arsytet e ikjes së personelit mjekësor, ata zgjedhin të ikin për të ardhura më të mira, zhvillim profesional, karrierë shkencore, status social. Mjekët dhe infermierët shqiptarë janë më të keqpaguarit në rajon, spitale që drejtohen nga mësues historie, biologjie, oficerë, punonjës socialë, biznesmen që nuk kanë lidhje me shëndetësinë. Në këtë situatë të shëndetësisë, mbi 1000 mjekë kanë zgjedhur të ikin prej vitit 2013, pjesa më e madhe kanë ulur kokën dhe kryejnë detyrën, ndërkaq një numër i vogël përkulen dhe deformohen nga realiteti duke abuzuar me detyrën, misionin dhe jetën e pacientëve. Nëse do të kishim një qeveri të përgjegjshme, në radhë të parë do jepte dorëheqjen Ministri Shëndetësisë, si përgjegjës për politikbërjen në sistemin shëndetësor, dorëheqje të Drejtorit të QSUT dhe Shefit të Shërbimit onkologjik, si dhe një plan masash për ndërhyrje emergjente me investime dhe rritje buxheti për onkologjikon, por jo vetëm të tij, si dhe me plan reformash. Por kjo qeveri, nuk ka vizion, nuk ka dëshirë të reformojë sistemin, aq më pak të jetë e përgjegjshme.

-Si do të vepronë PD për të përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve nëse do të ishte në pushtet?

Cilësia e jetës e qytetarëve sot është e cënuar nga shumë element: çmimet e larta, papunësia, të ardhurat e ulëta, mungesa e rendit, korrupsioni, kujdesi shëndetësor, siguria ushqimore, siguria e ambientit. PD përmes programit të saj i shpall luftë korrupsionit, duke mbështetur SPAK si institucion që ka besueshmërinë e 60% të popullatës, që po i jep fund kulturës së pandëshkueshmërisë, ngritjes së karabinierisë, gjetjes dhe sekuestrimit të pasurive publike të vjedhura, aplikimi i taksës së sheshtë 9%, uljes së informalitetit që është në nivelin 40%, zhvillimit të bujqësisë përmes mbështetjes me 100 milion Euro grante dhe 50 milion Euro investime në infrastrukturë, hapjes së vendeve të punës, zhvillimit të teknologjisë dixhitale përmes trajnimit të rinisë dhe rritjes së të ardhurave të tyre. Pra, është një platformë multidimensionale, ku secila fushë është pjesë e një mozaiku të madh, që është ekonomia shqiptare. Ne shpresojmë që qytetarët shqiptarë të besojnë në programin tonë, si dhe të na besojë si alternativë qeverisë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 me qëllim që të zbatojmë të gjithë planin tonë politik, me qëllim dhënien fund të periudhës kaotike 32-vjeçare, të ashtuquajtur "tranzicion politik", por që realisht është qeverisje nga një kastë politike që doli nga xhepat e Partisë së Punës.

Intervistoi: Rigels SELIMAN

Spahiu: Beleri 'Kalë Troje' i Berishës për t'i vënë zjarrin Himarës me shkrepësen e Greqisë

Analisti i njohur, Kreshnik Spahiu ka folur për situatën në Bashkinë e Himarës dhe Fredi Beleri. Gjatw njw prononcimi pwr mediat, zoti Spahiu deklaroi dje se Beleri është "Kali i Trojës" që ka lënë Sali Berisha për t'i vënë flakën Himarës dhe Shqipërisë me ndihmën e shkrepëses greke. Më tej ai tregoi dhe procedurat që do të ndiqen për të mbajtur zgjedhjet e reja në Himarë. "Ligji parashi-

kon procedurën si realizohet, në momentin aktual kemi konflikt interesi, një kryetar bashkie është eurodeputet. Në bazë të ligjit për organizimin e pushtetit gjyqësor. KQZ heq mandatin dhe çon presidentit dekretin për shpalljen e zgjedhjeve. KQZ nuk e bëri. Brenda 45 ditësh duhet të realizohen zgjedhjet në momentin që presidenti i shpall. Shkon javën e parë të gushtit ose javën e par të shtatorit. Fillimi

i vjeshtës është beteja finale mes Shqipërisë dhe Greqisë në Himarë. Beleri është Kali i Trojës së Sali Berishës për t'i vënë zjarrin Himarës dhe Shqipërisë me shkrepësen e Greqisë. Është një individ që do fusi në histori PD për aleancën zyrtare me klanin më të rrezikshëm grek. Nëse Kurti do bënte koalicion me pakicat serbe dhe Radoiçin në Kosovë, do ekzekutohej politikisht brenda 24 orëve. Ndjej

keqardhje që mijëra demokratë që e sollën PD si një lëvizje historike patriotike qytetarë o nuk janë më me këtë parti ose janë ajo pjesë që nuk i kanë mbetur fije patriotizmi, integriteti, bëjnë paqe me djallin në kurriz të interesave të Shqipërisë. Janë ata që nuk kanë asnjë lloj parimi. Ka dhe një problem të tretë që është në burg dhe nuk do marrë dot mandatin e euro deputetit deri në tetor. Është dënua me

2 vite burg i mbeten disa muaj", deklaroi ai. Ndërkohë juristi Kreshnik Spahiu komentoi edhe vetëflijimin e Pal Trashaj që piu fostoksinë para dyerve të SPAK pasi përmbaruesit e mikrokredive i kishin sekuestruar pasuritë atij dhe familjarëve. Sipas Spahiu, hetimi i Prokurorisë ka vijuar me vonesë dhe nuk janë arrestuar kokat e këtyre kompanive, që janë fajdexhinj me licencë.

Ngjela: Qeveritë shqiptare në 20 vitet e fundit kanë rënë në një korrupsion të nivelit të lartë

Spartak Ngjela paralajmëron ndryshime drastike pas 5 korrikut, ja çfarë do të ndodhë me ardhjen e ambasadorit të ri amerikan në Tiranë, goditja e madhe që do të marrë PD dhe goditjet 'VIP' që po përgatit SPAK

Xhoana VRANIÇI

Në axhendën e senatit në 5 korrik është vendosur edhe emri i ambasadorit të ri amerikan në Tiranë. Pas miratimit në senat, ambasadori Kostelancik pritet të nisë detyrën në Shqipëri. Shtëpia e Bardhë riemëroi Kostelancik këtë vit si ambasador në Shqipëri, duke rifilluar kështu procesin për shqyrtimin e kandidaturës, pasi në përfundim të kalendarit legjislativ të vitit të kaluar, së bashku me dhjetëra emërimet të tjera, ajo nuk u fut në rendin e ditës të Senatit për votim. Pas këtij zhvillimi, gazeta "SOT" kontaktoi me avokatin e njohur Spartak Ngjela, i cili tha se me ardhjen e ambasadorit amerikan, në Shqipëri do të ketë ndryshime të mëdha, pasi sipas tij ndërrimet e ambasadorëve amerikanë nga njëri shtet në tjetrin, sjellin me vete edhe metodat e reja. Avokati shprehet se Kostelancik do të ndryshojë në të gjitha aspektet politike ose juridike edhe në legjislacion dhe kudo. "Ardhja e ambasadorit David J. Kostelancik do



t'i jap më shumë forcë çështjes së demokracisë, në të gjitha aspektet politike ose juridike edhe në legjislacion dhe kudo. Ndërrimet e ambasadorëve, ndërrojnë edhe metodat. Ndërrimet e ambasadorëve amerikanë nga njëri shtet në tjetrin, sjellin me vete edhe metodat e reja", tha Ngjela. Sipas avokatit, tani që vjen ambasadori i ri, ndryshon problemi pasi vetëm ambasadori ka lidhje direkte me presidentin amerikan. "Të gjitha këto mund të marrin vlerë edhe më të re, pasi shkoi gjatë

mungesa e ambasadorit. Për të gjitha këto ngjarje, nuk kishte një primat këtu në vendin tonë, një të parë dhe sigurisht që kanë qenë të rezervuara përgjigjet. Tani që vjen ambasadori i ri, ndryshon problemi pasi vetëm ambasadori ka lidhje direkte me presidentin amerikan. Pasi e tillë është kushtetuta e tyre, pasi quhet përfaqësues i presidentit në vendin ku shërben si ambasador. Atëherë do të shikojmë që do të kemi besoj përmirësime në favor të Shqipërisë", tha ai.

Goditja e madhe për PD

Nga ana tjetër, avokati Ngjela komentoi dhe zhvillimet e fundit brenda PD, ku shihet se Argita Malltezi po merr frenat e selisë blu. I pyetur se si e sheh këtë lëvizje të Sali Berishës, Ngjela tha se Partia Demokratike do të dëmtohet shumë. Ai tha se një "non grata" pritet t'i hapë shumë probleme të mëdha kësaj partie në funksion të botës perëndimore dhe sidomos në funksion të SHBA-së dhe Britanisë së Madhe. "Do të dëmtohet Partia Demokratike. Nëse do të vazhdojnë përsëri me 'non-gratat', do ketë dëm PD në funksion të botës perëndimore dhe sidomos në funksion të SHBA-së dhe Britanisë së Madhe", tha Ngjela.

Zhvillime të forta brenda SPAK

Po ashtu avokati Spartak Ngjela tha se Prokuroria e Posaçme, e krijuar dhe financiar nga amerikanët do ta çojë deri në fund misionin për të cilën është krijuar, që të arrestojë të gjithë pushtetarët e lartë të korrumpuar. Avokati teksa foli për goditjet e SPAK në PS, tha

se shteti shqiptar dhe qeveritë të paktën në këto 20 apo 15 vitet e fundit, kanë rënë në një korrupsion të nivelit të lartë dhe dihet që do të vijë edhe ndëshkimi. Pra sinjalet sipas tij janë se SPAK do të çojë pas hekura emra të tjerë "VIP". "Ajo është gjë normale pasi dihet tani dhe opinionin publik e njeh mirë situatën që shteti Shqiptar dhe qeveritë në Shqipëri, te paktën në këto 20 apo 15 vitet e fundit, kanë rënë në një korrupsion të nivelit të lartë dhe dihet që do të hyjë edhe ndëshkimi. Aq më tepër që u krijua edhe SPAK-u. Duhet të kemi parasysh edhe një gjë që SPAK-u u krijua dhe doli jashtë nga sistemi gjyqësor klasik, pikërisht për faktin se dhe Gjykatat dhe Prokuroritë kanë qenë të korrumpuara. Prandaj e ngritën SPAK-un me Prokurori dhe Gjykatë të veçantë, e cila është kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Vetëm për këtë qëllim është ngritur struktura e SPAK dhe besoj se do ta çoj deri në fund qëllimin e saj", përfundoi Spartak Ngjela.

Debate në Komisionin e Sigurisë Kombëtare për moszhvillimin e seancës dëgjimore me kreun e Autoritetit të Sigurisë Kibernetike

Komisioni për Sigurinë Kombëtare debatoi dje në lidhje me mospraninë në komision të kreut të Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike Iglj Tafa, i thirrur për të raportuar mbi veprimtarinë e institucionit që ai drejton për vitin 2023. Kreu i Komisionit Parlamentar, deputeti i Partisë Socialiste Nasip Naço njoftoi se drejtuesi nuk është paraqitur gjë që solli kërkesën e deputetit të Partisë Demokratike

Ervin Saliçani që Komisioni i Sigurisë t'i depozitojë kallëzim penal për "shpërdorim detyre". "Është e paimagjinueshme që në një shtet të së drejtës, në një shtet demokratik të kërkohet që të vijë nga Kuvendi një drejtues institucioni, që rrogën e ka 2.5-fish më shumë sesa Presidenti i Republikës dhe ai të mos paraqitet. Është për Sigurinë Kibernetike, që çdo ditë dalin të dhëna të shtetërore dhe kjo është arsyeja që ai nuk vjen", tha Saliçani. Kryetari i Komi-

sionit për Sigurinë Kombëtare, Nasip Naço tha se "ka marrë dijeni stafi, jo drejtori", ndërsa deputeti i PD, Ferdinand Xhaferrri u shpreh se situata është e rëndë. Qefaliaj e konsideroi këtë një gjyq publik të padrejtë ndaj kreut të Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike. Ai tha se anëtarët me kohë të pjesshme të komisionit s'mund të bëjnë gjyqe publike. Sipas tij, ardhja e drejtuesit të këtij institucioni është risi për

komisionin e sigurisë që ndoshta ka sjellë dhe mosmarrëveshje mes stafit ndihmës të komisionit dhe drejtuesit të institucionit. "Drejtuesi i institucionit është profesionist, kompetent dhe mjaft serioz dhe jam i bindur se do të vijë në një moment tjetër", tha Qefaliaj. Deputeti i PS, Toni Gogu tha se halli i opozitës është Berisha dhe jo siguria kibernetike. Ai shtoi se kreu i Agjencisë për Sigurinë Kibernetike ka paraqitur raportin vjetor të punës dhe do të

vijë në komision. Kreu i Komisionit të Sigurisë, Nasip Naço mbylli punimet e komisionit, duke theksuar se në program të komisionit janë dhe seancat dëgjimore me AMP, me SHISH, me drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve, si edhe drejtorin e AKSHTI. Po ashtu Naço kërkoi njoftimin e kreut të Agjencisë për Sigurinë Kibernetike me qëllim caktimin e një date tjetër për zhvillimin e seancës dëgjimore.


aktualitet

Ja detajet nga vendimi i qeverisë

Pazar në tavolinë, ja si Belinda Balluku i jep pa tender 12 milionë euro kompanisë holandeze që po ndërton portin e ri në Porto Romano, zbardhen detajet e forta nga skandali

Për herë të parë shteti shqiptar do të prokurojë një kontratë të majme mbikëqyrjeje me pazar në tavolinë. Një vendim i mbledhjes së fundit i Këshillit të Ministrave ka autorizuar Autoritetin Portual Durrës në varësi të Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës që drejtohet nga Belinda Balluku, që të negociojë dhe lidhë marrëveshje pa tender me kompaninë holandeze Royal Haskoning, e cila ka në ndërtimin e portit të ri në Porto Romano. “Me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave vendosi të autorizojë Autoritetin Portual Durrës për të negociuar drejtpërdrejt dhe për të lidhur marrëveshje konsulence me subjektin ndërkombëtar “Royal Haskoning DHV”, brenda fushës së kompetencës së saj, një fushë me interes strategjik për proceset e konkurrimit, kontraktimit, ndërtimit dhe mbikëqyrjes së portit të ri të integruar të Durrësit në Porto Romano,” thuhet në vendimin e qeverisë.

“Kapitali.al” ka mësuar nga burime të mirëinformuara se bëhet fjalë për një kontratë prej plot 12 milionë eurosh, e cila do të jepet në tavolinë, pa garë dhe



larg procedurave standarde të prokurimit publik. Por kjo është vetëm maja e ajsbergut.

Tender për projektin dhe jo vetëm

Në nëntor të vitit 2021, Autoriteti Portual i Durrësit i dha bashkimit të kompanive mes Royal Haskoning dhe shqiptares ABKONS, tenderin 9.5 milionë euro për hartimin e projektit të detajuar teknik të portit të ri në

zhvillimin e tenderit dhe fillimin e ndërtimit të portit shumë shpejt janë përsëritur disa herë gjatë këtyre dy viteve, ku rasti më i fundit ishte para dy javësh. Por deri më tani tender nuk ka patur dhe premtimet dyvjeçare kanë rezultuar mashtrim. Megjithatë pavarësisht se tenderi për ndërtimin e portit nuk është hapur ende, deri tani qeveria shqiptare i ka dhënë 9.5 milionë euro dyshes së kompanive Royal Haskoning-Abkons për të hartuar projektin, si dhe po bën gati edhe 12 milionë euro të tjera për konsulencën e tenderit dhe mbikëqyrjen e veprës. Në total gati 22 milionë euro.

Biznes apo lobim transnacional?

Dhënia e kontratave të majme të konsulencës me pazare të mbyllura në tavolinë është një praktikë që ngre dyshime shumë të mëdha. Më vonë do të dalin të dhëna të tjera të detajuara që dëshmojnë se si qeveria hodhi në erë ligjin për t'u hapur rrugë këtyre pazareve. Por përdorimi i kontratave të konsulencës, potencialisht për lobime transnacionale është vetëm njëra anë e shqetësimit. Paralelisht, ekspertët brenda institucioneve të përfshira kanë

shqetësimin se këto kontrata pa garë mund të prodhojnë një tjetër pasojë edhe më të rëndë. Atë të paracaktimit të kompanive që do të marrin tenderin 420 milionë euro për ndërtimin e Portit përmes një skemë të njohur tashmë. Kontraktimi i një kompanie të huaj sa për emër në letrat e tenderit dhe dorëzimi real i kontratës tek kompani vendase të lidhura me pushtetin. Kjo është një skemë e përdorur gjerësisht në tenderat e veprave të mëdha publike gjatë viteve të fundit. Në të gjitha këto raste përdoren kompanitë ndërkombëtare të konsulencës si koperturë, të cilave u ngjiten nga pas shushunjat vendase të korrupsionit. Në rastin e tunelit të Llogorasë, kontrata e mbikëqyrjes u fitua nga prestigjiozja Hill por asaj i ngjiten pas kompaninë e Valter Begajt, biznesmenit të arrestuar nga SPAK për korrupsion në skemë me ish drejtorin e rrugëve, Evis Berberi. Sidoqoftë, firma në tenderin e radhës do të jetë e Pirro Vengut dhe duket se qeverisë nuk i mbarojnë asnjëherë vullnetarët kamikazë, të cilët firmosin pazare me direktivë nga lart dhe më pas shpallen nga pushteti si derra që hanë dardha pas kurrizit të udhëheqësve.

Investimet energjetike në bregdet, tender 473 mln lekë për linjën e re 35 kV në Rajonin e Vlorës

Me një fond limit prej 473 mln lekë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka hapur tenderin për ndërtimin e linjës së re 35 kV, që do të lidhë nënstationin Kafaraj dhe nënstationin Hoxharë e Re, në Rajonin e Vlorës. Sipas dokumenteve të tenderit, linja e re me dy qarqe do ketë parametra dhe standarde edhe për linje 110kV nëse në një perspektivë do të jetë e nevojshme rritja e nivelit të tensionit. Hapja e këtij tenderi vjen pas atij të pak javëve më parë, për ndërtimin e një nënstationi të ri elektrik në zonën e Akërnisë, si dhe zhvillimin e linjës 35 kV Akërnë - Aeroporti i Vlorës. Ky tender kishte një fond limit prej 427 mln lekësh, ndërsa në dokumentet shoqëruese specifikohet se arsyetja e ndërtimit

ishte siguria e furnizimit me energji elektrike e aeroportit të Vlorës, që parashikohet të nisë funksionimin vitin që vjen. Në dokumentet e tenderit, OSSH specifikonte se procedura prokuruese është hapur pas vlerësimit të gjendjes aktuale të rrjetit të tensionit të mesëm 35kV në zonën bregdetare që furnizon nëntacionet midis rajonit Akërnë - Aeroporti - Vlorë, sidomos në nënstationin Kafaraj dhe problematikat me furnizimin me energji elektrike në periudhat e ngarkuara të stinës së verës. Ndërkohë që, paralelisht me aeroportin synohet rritja e sigurisë së furnizimit me energji elektrike të abonentëve familjarë dhe bizneseve të zonës turistike bregdetare.

Belinda Balluku inspekton detajet e fundit: Të premten hapet tuneli i Llogorasë

Në tunelin e Llogorasë janë duke u kryer punimet e fundit. Paraditen e së premtes edhe kjo vepër e rëndësishme infrastrukturore do të hapet për qarkullimin e automjeteve. Me një gjatësi prej 5.9 kilometrash tuneli i Llogorasë shkurtor ndjeshëm kohën e udhëtimit drejt bregdetit të jugut, duke rritur njëkohësisht edhe parametrat e sigurisë rrugore. Zëvendëskryeministrja, njëherësh ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku ndoqi nga afër përgatitjet e fundit që po bëhen para hapjes për qarkullimin e automjeteve të tunelit, së bashku me drejtorin e Autoritetit Rrugor Shqiptar, Gentian Gjyli dhe kryetarin e bashkisë së Vlorës, Ermal Dredha. “Jemi në momentet e fundit të përfundimit të tunelit të Llogorasë. Parashikohet që pasnesër, në datë 5, ditë e premtë, në orën 10, do të jetë momenti i hapjes së këtij tuneli. Sigurisht në kantier do të vazhdohet puna, pasi po dorëzohet para afatit, ashtu siç

kemi bërë tashmë me të gjitha veprat tona të mëdha infrastrukturore, por tuneli i Llogorasë ka një vlerë tjetër edhe për historikun e infrastrukturës shqiptare. Unë e quaj një gur kilometrik, pasi bëhet fjalë për një tunel i cili është 5.9 kilometra i gjatë, dhe është një nga veprat infrastrukturore të kategorisë së rëndësishme për sa i përket tuneleve edhe në rang Europe. Futet në tunelet e gjatësisë së madhe”, bëri të ditur Balluku. Zëvendëskryeministrja tha se ndërtimi i kësaj vepre është një tjetër premtim i mbajtur i cili po hapet për lëvizjen e automjeteve para afatit të parashikuar, duke shtuar se janë marrë të gjitha masat për sa i takon mirëmenaxhimin të kësaj vepre. “Duke pasur parasysh që ky është një tunel totalisht modern nga ana e konstruksionit, por nga ana tjetër duhet të keni parasysh se është një tunel i menaxhuar në mënyrë elektronike, dixhitale. Në hyrje, në anën e Dukatit, kemi të vendosur qendrën e

monitorimit të këtij tuneli, një qendër totalisht e ngritur mbi digjitalizimin që në të ardhmen mendojmë që të përdorim dhe inteligjencën artificiale për të menaxhuar të gjithë flukset e tunelit, për të kontrolluar sigurinë rrugore brenda këtij tuneli”, tha Balluku. Drejtori i ARRSH njoftoi se në bashkëpunim me Policinë Rrugore është përgatitur edhe plani i menaxhimit të trafikut për muajt në vijim, kur tuneli do të jetë në funksion. “Jemi në bashkëpunim të ngushtë me Policinë Rrugore. Është i përgatitur plani i menaxhimit të trafikut gjatë 3 muajve në vazhdim, për sa kohë të jetë në operim tuneli. Shpresojmë që përdoruesit e tunelit të ecin me shpejtësinë e rekomanduar nga Autoriteti Rrugor dhe Policia Rrugore. Jemi gati”, u shpreh Gjyli. Nga ana e tij edhe kryebashkiaku Dredha tha se tuneli i Llogorasë lidh Vlorën me pjesën tjetër të bregdetit të jugut brenda një kohe shumë më të shpejtë dhe me siguri të lartë.

Selami Xhepa jep informacionet e rëndësishme

Ja pse rritja e pensioneëve është një gënjeshtëri, niveli i tyre pritet të shkojë në kufijtë e qesharakes, eksperti i njohur i ekonomisë paralajmëron lajme jo të mira për pensionistët

Xhoana VRANIÇI

Eksperti i njohur i ekonomisë Selami Xhepa ka komentuar vendimin e qeverisë për rritjen e pagave në administratën publike dhe skemën e re të pensioneëve. Në një intervistë për Top News, Z.Xhepa ka thënë se ky ishte një vendim i cili do duhej të ishte marrë madje shumë vite më përpara, në kuptimin që përmes një procesi të ngadalë por të qëndrueshëm të rritjeve dhe kompensimeve të pagave e për pasojë dhe të pensioneëve. Sipas tij, pavarësisht se presim që mund të kemi një rritje të të ardhurave për pensionistët për shkak të rritjes permanente të pagës minimale dhe bashkë me to edhe të pagës maksimale, mbi të cilën aplikohet llogaritja e kontributeve, sërish shëndoshja financiare e Institutit të Sigurimeve Shoqërore do të jetë shumë modeste sepse raporti i kontribuuesve me kontribuuesit, numri i atyre që kontribuojnë në sistem për pensionistët përfitues, do të vazhdojë që të ketë përmirësime.

-Si do ta vlerësonit këtë vendim të qeverisë sa i përket rritjes së pagave në administratën publike?

Kjo është faza e fundit ndoshta e planit të shpallur nga qeveria e Shqipërisë që prej vitit të kaluar dhe mesa duket ideja e kalimit drejt një page mesatare në ekonomi me 900 euro, po fillon që të marr trajtat e veta në finale duke shkuar drejt realizimit të plotë. Është thjeshtë një proces i politikave të vazhduara dhe që në gjykimin tim janë të domosdoshme në kontekstin e zhvillimeve ekonomike që ka në Shqipëri dhe gjendjen social-ekonomike së vendit. Së dyti, në raport që kemi me vendet fqinje dhe në raport me mundësitë që ka ekonomia e vendit. Është një vendim i cili ndoshta do duhej të ishte marrë madje shumë vite më përpara, në kuptimin që përmes një procesi të ngadalë por të qëndrueshëm të rritjeve dhe kompensimeve të pagave e për pasojë dhe të pensioneëve. Ndoshta nuk duhet të kishte kaluar një periudhë mëse të gjatë duke qenë vendi me nivelin më të ulët të pagave krahasuar me rajonin. Është një zhvillim pozitiv e mendoj se ka



nevojë të vazhdohet e të ruhet me tempin që të paktën është parashikuar dhe në paketën e reformave aktuale.

-Rritja e pagave në raport me sipërmarrjen private, kjo e fundit a është në kushtet e duhura për të konkurruar me pagat në administratën publike?

Nga pikëpamja ekonomike, pagat në administratën publike nuk mund të vendosen në mënyrë fiktive përtej mundësive, që ka ekonomia për të prodhuar apo për të shpërndarë të ardhura. Nëse e shohim në nivel krahasimor me vendet e rajonit, Shqipëria nuk është ndër vendet që ka nivelin më të lartë të shpenzimeve për pagë apo personeli në raport me GDB-së ose në raport me shpenzimet totale buxhetore gjatë një viti. Nga kjo pikëpamje, mendoj se jemi brenda varialbave krahasuese dhe me vendet e tjera të rajonit. Madje Shqipëria vijon përsëri të mbetet me nivelin më të ulët. Sa i takon impakteve që ka kjo rritje në ekonomi në tërësi, pa diskutim që ka nevojë të studiohet. Realizimi i një operacioni të tillë në një kohë të kufizuar dhe me përmasa të mëdha, sepse bëhet fjalë për rritje goxha të ndjeshme dhe nga kjo pikëpamje efektet e saj mund të krijojnë premisa për rritjen e mëtejshme të inflacionit. Vetë Banka e Shqipërisë në raportet e saj dhe në arsyet se është treguar e kujdesshme në politikën e saj të normave të interesit, ka qenë se faktorët e brendshëm që ushqejnë inflacionin, vazhdojnë të mbeten me forcë të madhe. Nga kjo pikëpamje, një efekt mund të jetë që rritja e pagave të ushqejë drejt rritjes së mëtejshme të inflacionit, ç'ka në një farë kuptimi e zbeh

efektin e mirëfilltë në të ardhurat reale që marrin qytetarët. Së dyti, impakti i saj është në raport me sektorin privat, kjo është një sfidë për arsye se mundësia e sektorit privat për të konkurruar në tërheqjen e fuqisë punëtore me kualifikimet e duhura. Me nivelet aktuale të pagave, mendoj që është problematike. E si e tillë kjo rivalizon në mënyrë të drejtpërdrejtë sektorin privat në të gjitha sektorët ekonomike.

-Profesor cili është impakti që do të jap në ekonomi rritja e pagave në sektorin publik, merr një notë pozitive apo shoqërohet me shumë problematike?

Në thelbin e vetë, mendoj se është pozitive e duke mos harruar dhe fenomenin e rritjes së çmimeve që ka gërryer në mënyrë dramatike të ardhurat e qytetarëve shqiptarë. Nga kjo pikëpamje, kompensimi i të ardhurave edhe për shkak të fenomenit të inflacionit, mendoj se ishte një domosdoshmëri pa asnjë diskutim. Së dyti, çdo rritje e të ardhurave në ekonomi është një element pozitiv që i ndikon rritjes së konsumit e për pasojë rritja e konsumit e udhëheq rritjen ekonomike. Kështu që ka një sërë lidhjesh shkak-pasojë pozitive që e bëjnë një nismë për t'u përshëndetur. Por kjo duhet shoqëruar dhe me masat edhe nga ana e sektorit privat, pasi ky kompesim i pagave, sigurisht që ka nevojë të ndiqet edhe nga sektori privat. Nga ajo se çfarë ne kemi parë gjatë vitit 2022, sipas statistikave që janë botuar ka rezultuar se rritja e pagave në sektorin privat ka qenë shumë më modeste, mesatarisht 13%. Që do të thotë se kemi përsëri një rritje të madhe të hendekut

në shpërblime apo ndarje të pagave mes sektorit publik dhe asaj privat, kur logjika duhet të jetë e kundërta.

-Kjo rritje e pagave në sektorin publik a ka rrezik të nxisë punësimin gri në sektorin privat?

Kjo dihet që rritja e pagave në sektorin privat duke ditur prej kohësh fenomenin e nën raportimit të asaj punës gri apo të themi të asaj pune në të zezë, punës së individëve të cilët nuk rezultojnë kund të regjistruar në institucionet e administratës, qoftë asaj tatimore apo të ISSH-së. Fenomeni i nën raportimit është një fenomen shumë serioz dhe shumë masiv.

-A ka mundësi buxheti shtetëror duke qenë se skema e pensioneëve në disa momente është diskutuar në pamundësi financiare për të përballuar të gjitha detyrimet që ka në kategori të pensioneëve?

Fakti është se pensionet e reja për pensionistët e rinj, kanë filluar që të dalin me vlera relativisht të pranueshme, ç'ka do të thotë se kostoja e këtij instituti do të vazhdojë e do të vij duke u rritur gjatë viteve të ardhshme por nga ana tjetër të ardhurat e ISSH-së do të vazhdojnë që të jenë jo në nivele të tilla që të përballojnë barrën financiare apo detyrimet që ka akumuluar për pagimin e detyrimeve për pensionistët. Pavarësisht se presim që mund të kemi një rritje të të ardhurave për shkak të rritjes permanente të pagës minimale dhe bashkë me to edhe të pagës maksimale, mbi të cilën aplikohet llogaritja e kontributeve, sërish shëndoshja financiare e Institutit do të jetë shumë modeste sepse raporti i kontribuuesve me kontribuuesit, numri i atyre që kontribuojnë në sistem për pensionistët përfitues, do të vazhdojë që të ketë përmirësime. Aktualisht është gati 1.12 dhe pritet që të shkojë në më pak se 1 me 1. Që do të thotë se një i punësuar e njëkohësisht edhe një pension shtesë përveç pagës së tij. Nga kjo pikëpamje është realisht e vështirë që instituti i ISSH-së apo qeveria të ketë mundësi për të bërë një reformë madhore. Sidoqoftë edhe ato ide që janë diskutuar gjatë muajve të fundit, mendoj se duhet të përshpejtohen. Pensionistët të cilët janë me pension nën nivel mesatar, të kenë një rritje më të lartë në mënyrë që të paktën dyfishin e rritjes që kanë pen-

sionet në tërësi në mënyrë që të ketë ngushtim mes pensioneëve më të larta dhe pensioneëve të ulëta. Dhe kjo është një barrë pasi numri i pensionistëve me pensione që janë nën pension minimal është tepër i lartë bazuar në strukturën e pensioneëve që ka Instituti i Statistikave, 30%-40% e pensionistëve që jetojnë me pensione nën nivelin e pensionit mesatar por kjo është masa mëse e domosdoshme. Në kontekstin e rritjes së pagave, nëse nuk vazhdohet dhe me politikat e indeksimit të pensioneëve, koeficienti i zëvendësimit i raportit të pensioneëve me pagën do të vazhdojë të përkeqësohet gjithnjë e më shumë, ç'ka do t'i bëjë pensionet nën nivele jo vetëm të pamjaftueshme por edhe në kufijtë e qesharakes.

-Shqipëria nuk e ka të njohur me ligj minimumin jetik, megjithatë duket se po propozohet nga opozita aktualisht e në momentin që vijën në qeveri partitë politike i devijojnë këtij premtimi të mbajtur në fushata elektorale për shkak të kostos që ka. Keni ju pritshmëri që në të njohim me ligj si vend e si shtet me minimumin jetik e rrjedhimisht nuk do të kishim pensione nën këtë masë të përcaktuar si minimumin jetik dhe asnjë lloj përfitimi tjetër çfarë përfshihet në mbrojtjen sociale?

Në vendet e BE ka një standard të përcaktuar për atë që konsiderohet jo minimum jetik por si pjesa e popullsisë që konsiderohet me të ardhurat jo të mjaftueshme dhe kjo konsiderohet kur një individ apo një familje bie nën 60% të të ardhurave median që ka shoqëria. Pra, më shumë sesa minimumi jetik është një indikator i cili përdoret për vendet shumë të varfra, për ata që e kanë të pamundur edhe jetesën. Ndërsa Shqipëria mendoj se është në rrugën për t'u përafëruar të paktën me praktikatat dhe standardet e BE, mendoj se ka ardhur koha për ta parë në këtë këndvështrim. Pra, për të adoptuar një standard jo më thjesht në vijën e varfërisë që ka Banka Botërore e cila i referohet 10 vendeve më të varfra të botës, vendeve të Afrikës por të marrim si sistem reference atë që përdoret nga BE. Dhe nëse në adoptojmë këtë standard, mendoj se mund të konsiderohet i tejkualuar përcaktimi i minimumit jetik.

■ Sipas prokurorisë Arqile Bollano nuk duhet të përfitonte pronësinë mbi dy ngastrat e tokës

I dhuroi tokë Arqile Bollanos, SPAK kërkon arrestim të dytë për Jorgo Goron, në hetim dhe kryetar i komanduar i Bashkisë Himarë që përfitoi 4900 metra dhe bëri mbivendosje

Rëndohet pozita penale e ish-kryetarit të bashkisë Himarë Jorgo Goro, pasi prej disa ditësh Prokuroria e Posaçme (SPAK), mësohet ti jetë drejtuar gjykatës, me një kërkesë për caktimin e masës së sigurisë “arrest në burg”, për ish-zyrtarin e Partisë Socialiste. Hetimi i nisur fillimisht nga prokurori i Vlorës Arjan Xhaferaj, por i transferuar një muaj më parë në Tiranë, duket se tashmë po finalizohet nga prokurori i SPAK, Elvin Gokaj, i cili mësohet ti jetë drejtuar gjykatës së posaçme me një kërkesë për sekuestrimin e një sipërfaqe toke në Himarë, që është përfituar në mënyrë të parregullt dhe caktimin e masës së “arrestit në burg” për ish-kryebashkiakun, Jorgo Goro. Gazetari i “Ora News”, Elton Qyno ka mësuar se bëhet fjalë për një sipërfaqe toke prej 4900 metra katror, e ndodhur në zonën e Livadhut në Himarë, e cila është përfituar në mënyrë të padrejtë nga Arqile Bollano, aktualisht kryetar i komanduar nga PS në bashkinë Himarë. Hetimet e SPAK janë përqendruar dhe tek përfituesi i këtyre dy pasurive Arqile Bollano dhe një person tjetër që kanë qenë pjesë e grupit të punës, të cilët ndërtnan listën emërore të personave që fituan tokë në mënyrë të padrejtë në Himarë. Me këto ritme që po ecën hetimi, ka gjasa që bashkia e Himarës të mbetet sërish pa kryetar. Por deri në këtë fazë ku ndodhet hetimi i kësaj çështje, aktualisht SPAK



masë sigurimi “arrest në burg”, ka kërkuar vetëm për ish-kryetarin e bashkisë Himarë, Jorgo Goro, i cili për momentin vijon të jetë në burg për shkak të një procedimi tjetër që bën fjalë për tjetërsimin e një sipërfaqe toke prej mbi 5 mijë metra katror, e përfituar kjo nga Artan Gaçi, burri i ish-ministres së Jashtme, Olta Xhaçka.

Kërkesa e SPAK

Tashmë kërkesa e SPAK është në shqyrtim nga Gjykata e Posaçme, e cila pasi të vlerësojë dhe kontrollojë provat e prokurorisë, brenda 5 ditëve duhet të dale me një vendim për caktimin e një mase ndaj Jorgo Goros dhe sekuestrimin e dy gastrave të tokës me sipërfaqe totale prej 4900 metra katror. Sipas dosjes hetimore rezultojnë se kallëzimi është bërë fillimisht në komisariatit të Himarës, nga një banor i zonës i cili posedonte tokën e rregullt dhe e kishte fituar atë në bazë të ligjit 7501. Në dosje

del se 9 vite më parë, një punonjës i rëndësishëm i bashkisë Himarë, i quajtur Arqile Bollano, që sot mban postin e kryetarit të komanduar të bashkisë Himarë, ndërtoi një listë emërore për disa banorë të zonës, të cilët duhet të trajtoheshin me tokë nga bashkia Himarë. Ndërtimi i kësaj liste argumentohej, me faktin se këto familje nuk ishin trajtuar me tokë bujqësore në vitin 1991-1992, por për shkak se ishin përdorues faktik të disa ngastrave toke, këto sipërfaqe duhet ti njiheshin nga ana e Bashkisë Himarë. Në kohën e paraqitjes së listës së përfituesve në Bashki, Arqile Bollano, ishte pjesë e grupit të punës në bashkinë Himarë, ku kryente plotësimin e procedurave që do shpallnin emrat përfitues të tokës. Pikërisht në këtë listë, ishte dhe emri i Arqile Bollanos, njeriut kryesor që drejtonte grupin e punës për trajtimin e personave me tokë nga ana e bashkisë së Himarës.

Dosja hetimore

Sipas dosjes hetimore del se Bollano vetë firmoste, vetë verifikonte dhe më pas vetë rezultojnë të jetë përfituesi i dy ngastrave me tokë me një sipërfaqe totale prej 4900 m² në zonën e Himarës. Bollano, përfitoi pronësinë mbi dy sipërfaqet e tokës, ku tek njëra prej tyre prona e fituar nga zyrtari i bashkisë, u mbivendos në pothuajse 80 për qind mbi masurinë e një mësuesi në Himarë. Një fakt i tillë është provuar dhe përmes një akti-ekspertimi topografik të kryer nga prokuroria që ka ndjekur rastin. Por rezultojnë se firmëtar final për përfitimin e këtyre dy ngastrave nga zyrtari Arqile Bollano dhe personave të tjerë, rezultojnë të jetë kryetarit i asaj kohe, Jorgo Goro, aktualisht në burg për akuzën e “Shpërdorimit të detyrës” lidhur me rastin e tokës të përfituar në zonën e Himarës nga Artan Gaçi, burri i deputetes së PS, Olta Xhaçka. Sipas dosjes hetimore, Jorgo Goro, në cilësinë e kryetarit të bashkisë Himarë, ka firmosur për përfitimin e dhjetëra mijë metra katror tokë nga disa familje bujqësore. Praktika është përpiluar dhe argumentuar në formën se këto familje bujqësore nuk janë trajtuar me tokë gjatë vitit 1991-1992. Dhe për shkak se këto familje dispononin dhe kishin në përdorim faktik disa ngastra me sipërfaqe toke në zonën e Himarës, këto toka duhet t'i njiheshin nga bashkia. Mes përdoruesve faktikë në listën e përfituesve është dhe Arqile Bollano, aktualisht kryetar

i komanduar i bashkisë Himarë. Por nga verifikimet e kryera nga prokuroria, ka rezultuar se në periudhën e përpilimit të kësaj praktike, 2015-2016, Bollano ishte pjesë e grupit të punës që ka ndërtnuar listën e përfituesve. Ndërkohë nga një verifikim i kryer nga prokuroria, ka rezultuar se Arqile Bollano, nuk duhet të përfitonte pronësinë mbi dy ngastrat e tokës, pasi ai rezultoi në librin e fermerit se është trajtuar me tokë në vitin 1991. Ligji e përcakton qartë se familjet bujqësore që janë trajtuar me tokë nga komisionet e ndarjes së tokës, përjashtoheshin nga përfitimi, edhe nëse ishin përdorues faktikë të një sipërfaqe toke. Kjo pasi pjesën takuese. Por kjo gjë nuk është mbajtur parasysh, sikundër nga ana e kreut të bashkisë Himarë, Jorgo Goro, nuk është marrë asnjë masë për të kryer verifikime në teren nëse tek këto sipërfaqe toke, ka mbivendosje ose jo, nëse mbi këto sipërfaqe toke ka ndërtime me leje ose pa leje, nëse për këto sipërfaqe toke ka apo jo pretendentë të tjerë të pronësisë, nëse është e rregulluar marrëdhënja mes kufitarëve, etj. Për shkak të këtyre shkeljeve të njëpasnjëshme dhe nisur nga pozita juridike e Arqile Bollanos, i cili mban funksionin e kryetarit të komanduar të bashkisë Himarë, prokuroria e Vlorës vendosi të shpallë moskompetencën dhe dosjen t'ia kalojë për hetime të mëtejshme prokurorisë së posaçme SPAK.

KQZ vendos sot për zgjedhjet në Himarë, zbardhet pr/vendimi dhe shkaqet pse Fredi Beleri nuk ushtron dot detyrën e kryebashkiakut

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pritet që sot të kërkojë nga presidenti shpalljen e zgjedhjeve të reja në Himarë. KQZ do të mbledhet për të shqyrtuar mandatin e Fredi Belerit, i cili u dënua nga Apeli me 2 vite burg. Sipas vendimit të hartuar nga stafi i KQZ, ai është në kushtet e pamundësisë së ushtrimit të detyrës, pasi preket nga ligji i dekriminalizimit. Për këtë arsye duhet të shpallen zgjedhjet të reja. “Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 1736 prot., datë 27.06.2023 i ka kërkuar informacion/dokumentacion Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nëse është marrë ndonjë vendim penal në ngarkim të shtetasit z. Dhionisios (Alfred)

Petro Beleri. Gjithashtu Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr.1785 prot, 1.07.2024 i ka kërkuar informacion zyrës së gjendjes gjyqësore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, për z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me shkresën nr.933/1 prot, datë 1.07.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve shkurtimin e vendimit penal nr. 26, datë 25.06.2024, dhënë në ngarkim të z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri. Sipas këtij vendimi të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. 14, datë 05.03.2024 e Gjykatës së

Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas së cilës është vendosur: “Deklarimi fajtor i të pandehurve Pandeli Kokaveshi dhe Dhionisios (Alfred) Beleri, për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” kryer në bashkëpunim dhe dënimin e tij me 2 (dy) vite burgim”, thuhet në vendimin e KQZ që do shqyrtohet sot. Në nenin 2 pika 1 shkronja “b” e ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, përcaktohet se vepra penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” parashikuar nga neni 328 i K.Penal hyn në kategorinë e veprave penale, për kryerjen e të cilave persona të caktuar nuk

mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetar bashkie, etj. Në nenin 10, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 138/2015, përcaktohet se KQZ brenda kompetencave të veta, “...shpall pavlefshmërinë e mandatit kur kushtet e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë verifikohen pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve, në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe para fillimit të ushtrimit të mandatit nga personi i shpallur i zgjedhur në kundërshtim me këtë nen, si dhe shpall mandatit, në përputhje me Kodin Zgjedhor...”. Në këto rrethana vlerësohet nga KQZ se Fredi Beleri i zgjedhur Kryetar i Bashkisë Himarë nuk mund të ushtrojë këtë detyrë për shkak të

ndalimit që vjen nga ligji 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Sipas Kushtetutës, Presidenti i Republikës dekreton datën e re të zgjedhjeve brenda 48 orësh nga marrja e njoftimit. Zgjedhjet mbahen jo më parë se 30 ditë dhe jo më vonë se 45 ditë nga data e njoftimit të ndërprerjes së mandatit. Kjo do të thotë se 3 datat e mundshme për të vendosur janë 4, 11 dhe 18 gusht. Pra në një nga këto data himarjotët do të votojnë. Sa u takon kandidatëve, pak a shumë emrat kanë dalë. Për kampin e Partisë Socialiste do të jetë perfekt i Vlorës Vangjel Tavo. Në kampin opozitar Petro Beleri, djali i Fredi Belerit.

Ndryshimet në ligj "liberalizuan" pozicionin, a është i paracaktuar kreu i Gardës?

Ja emrat e kandidatëve për kreun e Gardës së Republikës, kush janë 6 aplikantët, rikthehet ish-kryepolici i njohur, mes tyre edhe një grua

Elmas BOGDANI

Janë zbardhur dje emrat që po kandidojnë për kreun e Gardës së Republikës. Deri më tani kanë aplikuar 6 persona dhe në mesin e tyre është edhe një grua. Aplikimet janë mbyllur me datë 26 qershor, të muajit që lamë pas. Aktualisht kandidatët janë në proces vlerësimi që pritet që procesi të përfundojë brenda 45 ditëve. Komisioni i Vlerësimit do të rendisë kandidatët dhe më pas do t'ia paraqesë Ministrisë të Brendshme, Taulant Balla. Mes kandidatëve vihet re edhe emri i ish-drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Artan Didi. Artan Didi, ish-kreu i Policisë së Shtetit dha dorëheqjen për shkak të çështjes së ekstradimit në Belgjikë të deputetit Mark Frroku. Didi dha dorëheqjen në 31 mars të vitit 2015 duke argumentuar për mosekstradimin e Frrokut se: "nuk pata kapacitetin e mjaftueshëm për të parandaluar një ngjarje të tillë". Emrat e kandidatëve janë: 1. Artan Didi, 2. Dritan Osmani, 3. Krenar Carcani, 4. Klajdi Hajredinaj, 5. Ermal Onuzi, 6. Jona Lamko.

A është i paracaktuar kreu i Gardës?

Albanian Center for Quality Journalism pak javë më parë bëri një investigim lidhur me ndryshimet e fundit në ligjin që rregullon aktivitetin e Gardës së Republikës, të cilat kanë shkaktuar debate në fushën e sigurisë. Ndryshimet e propozuara eliminojnë sistemin tradicional të promovimit bazuar në meritokraci brenda institucionit, duke e zëvendësuar atë me një kërkesë bazë për 10 vjet përvojë në fushën e sigurisë ose të rendit publik. Kritikët argumentojnë se ky ndryshim minon rritjen profesionale të anëtarëve me shërbim të gjatë në Gardë, ndërsa të tjerë e shohin si një lëvizje drejt ndikimit të shtuar, politik. Më parë drejtuesi i lartë i Gardës vinte nga radhët e vetë institucionit dhe kriteret kryesore për emërimin e tij ishin: shtetësia shqiptare; eksperiencia si punonjësi i Gardës dhe pasja e gradës "Drejtues i parë" ose "Drejtues i lartë"; mungesa e masave të rënda, disiplinore brenda 3 (tri) viteve të fundit dhe mungesa e konflikt të interesit. Por, nga data 21 mars është vendosur që drejtuesi i Gardës të bëhet përmes një konkursi dhe për kandidatët potencialë kriteri i vetëm, i nevojshëm ka mbetur përvoja e punës jo më pak se 10 vjet në fushën e rendit ose të sigurisë.



Detajet nga ligji

Me projektligjin e miratuar në Kuvend, më 21.03.2024, dhe të hyrë në fuqi më 1 maj 2024, pas publikimit të tij në Fletoren Zyrtare, kriteri i gradave dhe i rritjes profesionale brenda institucionit të Gardës së Republikës i kandidatëve potencialë për drejtues të këtij institucioni ka rënë dhe tashmë mjafton eksperiencia e punës 10-vjeçare, një ndryshim që për ekspertët e sigurisë është një absurditet. Eksperti për çështjet e sigurisë, Fatjon Softa, është skeptik. "Po hiqet grada si shkallë kualifikuese për t'u emëruar dhe po vendoset një kriter, ku mjafton të kesh 10 vite punë, që njih sektorin e sigurisë, pra, jo vetëm në Gardë, po mjafton të kesh qenë në Policinë e Shtetit, në Policinë e Burgjeve, mund të kesh qenë në kompani private të sigurisë. Nuk e di se si e klasifikojnë atë periudhën 10-vjeçare dhe gara është e hapur. Kushdo mund të konkurrojë dhe pastaj është ministri i Brendshëm, që përcakton, po themi, personin më të përshtatshëm dhe ia propozon atij, Kryeministrit", tha ai. Me ligjin e vjetër për të mbërritur në këto grada, një punonjësi të Gardës, i cili e kishte nisur karrierën e tij me gradën më të ulët - Inspektor - i nevojiteshin 29 vjet karrierë për të mbërritur në pozicionin potencial të Drejtuesit të Gardës. Por, me ndryshimet e reja, edhe kandidati me gradën Inspektor i Parë mund të katapultohet në krye të këtij institucioni.

Reagimet

Duke iu përgjigjur pyetjeve të deputetit Alibeaj në mbledhjen e Komisionit të Sigurisë Kombëtare në Kuvend, z. Naço tha se, "kriteret, që kemi përcaktuar, janë edhe në ligjin aktual, pra, po ta lexoni me vëmendje se kush punësohet në Gardën e Republikës, në këtë kemi vënë si kriter edhe për drejtorin e Gardës, pra të ketë 10 vjet përvojë në fushën e rendit dhe të sig-

urisë." Në këtë mbledhje deputeti i opozitës, Alibeaj, akuzoi kolegët e majtë për politizim të Gardës. "Jo njerëzit me grada, jo njerëzit me karrierë, jo njerëzit, që kanë milituar brenda strukturës! (A) nuk e meritojnë këta të jenë në krye të Gardës? (Apo duhet) dikush tjetër nga jashtë për hir të garës ose, siç e quani ju, të konkurrencës? Kjo, në fakt, nuk është gjë tjetër veçse një iniciativë ligjore, e cila kërkon që ta politizojë më shumë se sa është politizuar drejtimin e Gardës. Hapni derën, shtegun e ngushtë, nëpërmjet së cilës fusni njerëz, që kanë bekimin partiak, bekimin politik dhe ky është politizim i Gardës", shkruhet në procesverbalin e mbledhjes.

Garda e re me akuzë për paracaktim

"Kjo nuk është bërë në bazë të meritokracisë, kjo është bërë, duke qenë nipi i X apo djali i Y, apo miku i filanit. Kjo nuk është dinjitoze", thotë Reshat Lloji, me gradën kolonel, por i tërhequr nga Garda që në vitin 2006. Ai shton se ka dëgjuar edhe emrin e drejtorit të ri, që do [ishite paracaktuar] ta drejtojë institucionin. "Ligji, që ka qenë, ka qenë më i konkretizuar, sepse komandanti i Gardës

propozoj nga kryeministri dhe nga presidenti dhe vinte nga gradat dhe nga karrierës brenda Gardës". Z. Lloji thotë se brenda Gardës ka njerëz mjaft të aftë dhe të zotë për këtë post. "Ka djem, që i njoh dhe që i plotësojnë të gjitha kriteret për të qenë në krye dhe që shumë mirë mund ta kryejnë detyrën, ndryshe nga dikush që vjen nga jashtë dhe që nuk e njih natyrën e shërbimit, nuk e njih veprimtarinë e Gardës." ACQJ kërkoi koment nga Garda e Republikës dhe nga Ministria e Drejtësisë, që refuzuan që ta komentonin këtë projektligj. Sa i përket besueshmërisë së kandidatëve potencialë, eksperti Softa ngre një shqetësim në lidhje me certifikatën e sigurisë. "Certifikata e sigurisë ka ardhur si rrjedhojë e një pune, pra një mali me punë dhe nuk mund të zëvendësohet aq lehtë nga një vërtetim besueshmërie", thotë ai. Garda nuk është më ajo që ka qenë për kolonel Reshat Llojin. "Një Gardë e vërtetë duhet që t'i ruajë funksionarët e lartë të shtetit, pa qenë e varur. Këtu nuk ka më Gardë. Duhet të hiqet emri Gardë, sepse gradat i kanë lëshuar, detyrat ia kanë lëshuar strukturave policore, pothuajse kanë ndryshuar të gjitha këtu. Nuk ka mbetur më asgjë, kështu që më mirë të mos quhet më Gardë, po repart i Policisë së Shtetit", shprehet ai.

Debatet

Gjatë seancës plenare, në të cilën u miratuan ndryshimet në Ligjin për Gardën e Republikës, pati edhe një debat mes kryetarit të grupit parlamentar të opozitës, Gazment Bardhi, dhe deputetit Nasip Naço, të cilin e akuzoi se ligjin e ri po e përdorte për interesa personale. "Ligji, i nderuar kolegj, është porositur nga

oligarku Shefqet Kastrati, për të emëruar si drejtor të ri të Gardës shtetasin Ermal Onuzi. Ju keni sjellë këtu ligjin e një oligarku, për të bërë drejtor të Gardës një kushëri të këtij oligarku, që ka emër dhe mbiemër".

Ligji kaloi në Parlament me 73 vota pro dhe 23 kundër

Më 11 qershor, Ministria e Brendshme hapi thirrjen për aplikim për pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Gardës së Republikës, duke lënë vetëm 15 ditë kohë për të gjithë aplikantët potencialë, që të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar. Përtej një morie dokumentesh të nevojshme, një pikë kyçe në vlerësimin e kandidatëve do të jetë edhe Platforma personale e qëllimeve dhe e objektivave të aplikantit, përmes së cilës i përgjigjet 18 pyetjeve, që mund të përmblidhen në një: Cili është vizioni dhe cilët janë hapat, që duhen ndërmarrë për përmbushjen e objektivave? Përtej aludimeve mbi persona potencialë, të paracaktuar për pozicionin e hapur, përtej rastësisë tejet të volitshme në datat e dorëheqjes së drejtorit të vjetër të Gardës së Republikës, dorëzimit të propozimit, miratimit në Parlament dhe hyrjes në fuqi, përtej kritereve bazike, që në fusha të tjera nuk do ta lejonin një kandidat të merrte as një post të mesëm drejtues, përtej afatit tejet të shkurtër të lënë në dispozicion të kandidatëve potencialë për të dorëzuar dokumentacionin e plotë për procedurën e përzgjedhjes, pyetja kryesore, që mbetet pa përgjigje, është: Me ndryshimet në ligj, çfarë e shtyn sot një të ri që të përfshihet në radhët e Gardës së Republikës apo një oficer karriere të kërkojë rritje profesionale?

Përzgjidhen katër kandidatë për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë

Në drejtimin e kryetares Klotilda Bushka u zhvillua dje mbledhja e radhës së nënkomisionit "Për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatëve". Në nisje të mbledhjes Bushka shpjegoi procedurën që duhet ndjekur për vijimin e procedurës së vakancave të shpallura për KLGJ dhe KLP, për shkak se lista e parë e kandidatëve të dal nga shorti i datës 13.6.2024 nuk arriti të merrte shumicën e votave të kërkuara në seancë plenare. Në rendin e ditës ishte

votimi i listës së re të kandidatëve për plotësimin e vakancave për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe votimi i secilit prej kandidatëve. Fillimisht u votua për listën e kandidatëve të skualifikuar pas procesit të verifikimit dhe vlerësimit paraprak të listës së kandidatëve dhe asnjë prej tyre nuk arriti të marrë numrin e votave të nevojshme për tu kualifikuar. Në përfundim lista e kandidatëve që u hodh për votim ishte për KLGJ: Eris Hysi, Erind Mërkuri, Erind Gërmenji, Albens Tabaku,

Klodian Gjermeni, Artan Reçi, Bledar Bajri dhe Saimir Kola, ndërsa për KLP ishin: Erind Mërkuri, Erind Gërmenji, Albens Tabaku, Artan Reçi, Bledar Bajri dhe Saimir Kola. Për shkak se asnjë prej kandidatëve nuk arriti të marrë numrin e votave të nevojshme, procedura vijoi me përzgjedhjen me short, nga ku u përzgjedhën e Erind Mërkuri dhe Albens Tabaku për KLGJ-në; si dhe Artan Reçi dhe Bledar Bajri për KLP-në. Në përfundim të mbledhjes Bushka sqaroi se katër kandidaturat do t'i kalojnë për shqyrtim seancës plenare.

r a j o n

Akuzat për rezolutën e Malit të Zi, Vuçiç “lan duart”: Janë gënjeshtra

Pas pjesëmarrjes në seancën e kolegjiut të zgjeruar të Shefit të Shtabit të Forcave të Armatosura të Republikës së Serbisë, Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç, i kërkoi Presidentit të Malit të Zi, Jakov Milatoviç dhe Kryeministrit të Republikës së Malit të Zi, Milojo Spajiq, nëse ka qenë krijuesi i Rezolutës për gjenocidin në kampet Jasenovac, Dachau dhe Mauthausen, e cila është miratuar së fundi nga Parlamenti i Malit të Zi dhe

nëse ka bërë presion që ai dokument të miratohet, shkruan Vijesti. “U kërkoi të dalin publikisht dhe t’u shpjegojnë miqve të tyre kroate dhe perëndimorë, të cilëve u kërkohen falje ditë e natë, duke u shpjeguar se ishte një gabim i madh, të më thonë pse e kanë bërë këtë gabim dhe t’u shpjegojnë njerëzve se po bënë shaka. Kur thanë se ka pasur lidhje mes Beogradit dhe meje personalisht”, tha Vuçiç në konferencën për media. Vuçiç

tha se asnjëherë nuk i ka telefonuar as Milatoviçit, as Spajiqit, as kryetarit të Parlamentit të Malit të Zi Andrija Mandiç. Në konferencën për shtyp, një gazetar permendi edhe artikullin e Jutarnji List për planin e errët të Vuçiçit pas Rezolutës për Jasenovacin. Presidenti i Serbisë tha se disa kanë shkruar më shumë artikuj për të këtë vit se sa për kryeministrin e Republikës së Kroacisë, Andrej Plenkoviç dhe Presidentin e

Republikës së Kroacisë, Zoran Milanoviç, së bashku, shkruan Vijesti. “Kjo tregon mjaft jo vetëm për obsesionin e tyre, por edhe diçka të mirë për mua”, tha Vuçiç. Presidenti serb tha se zyrtarët e huaj i thonë se liderët malazezë u thonë se Rezoluta për Jasenovacin është miratuar për shkak të presionit nga Beograd. Ai shtoi se malazezët nuk duhet ta thonë emrin e tij sepse “ata e dinë se kjo do të ishte një gënjeshtër e qartë.”

Miratimi i deklaratës

“Kuvendi gjithëserb” trazon sërish ujërat në Ballkan, Perëndimi humb durimin me Dodikun, Përfaqësuesi i lartë i komunitetit ndërkombëtar kërcënon liderin serb të Bosnjës, ja vendimi i fundit që ka nxitur polemika

Marsela SHYTIA

Ballkani Perëndimor prej kohësh jeton me frikën e një rreziku në rritje të dhunës etnike të lokalizuar gjatë vitit 2024, veçanërisht në Bosnje dhe Hercegovinë, ku lideri i serbëve të Bosnjës, Milorad Dodik, synon shkëputjen de facto të Republikës Srpska. Dodik, presidenti i Republika Srpska, është përpjekur për dy vitet e fundit të luftojë pushtetin shtetëror nga Bosnja dhe Hercegovina dhe të krijojë institucione paralele, duke kërcënuar se Republika Srpska do të shkëputet përgjithmonë nga Bosnja dhe Hercegovina. Për shkak të “aktiviteteve të tij kundër Marrëveshjes së Dejtonit”, Dodik është në listën e sanksioneve të Shteteve të Bashkuara dhe Mbretërisë së Bashkuar. Dodik ka deklaruar më parë se nuk ka frikë nga paralajmërimet amerikane dhe ka kërcënuar se do të kthejë kufirin e subjektit në një kufi shtetëror. Në këtë kontekst shpjegohen edhe sulmet e tij ndaj Përfaqësuesit të lartë të bashkësisë ndërkombëtare për BiH, Christian Schmidt, të cilin e ka ofenduar jo pak herë edhe në mënyrë direkte. Megjithatë, as përgjigjet e këtij të fundit, nuk kursehen asnjëherë.

Paralajmërimi i Schmidt

Së fundmi, Schmidt, paralajmëroi autoritetet në Republikën Srpska se nuk do të lejojnë



asnjë shkelje të Marrëveshjes së Dejtonit dhe do të përdorin kompetencat e tyre dhe do të reagojnë ndaj miratimit të çdo vendimi që kërcënon sovranitetin e BiH. Schmidt e ka shprehur këtë paralajmërim në një letër drejtuar kryetarit të Asamblesë Kombëtare të RS, Nenad Stevandiç, në lidhje me vendimin që ai organ të shqyrtojë dhe miratojë deklaratën e të ashtuquajturit Kuvend Gjithëserb, në të cilin zyrtarët më të lartë të Serbisë dhe të RS, me mbështetjen e Kishës Ortodokse Serbe (KPS), njoftuan për një lidhje edhe më të ngushtë ndërmjet atij shteti dhe këtij entiteti të Bosnjë-Hercegovinës. Parlamenti i RS-së e miratoi atë deklaratë dhe Schmidt paralajmëroi në një letër drejtuar Stevandiçit, përmbajtja e së cilës u publikua nga “Osloboenje” e Sarajevës dje, se ky është një akt që vë në pikëpyetje detyrimet

dhe përgjegjësitë e RS-së sipas Marrëveshjes së Dejtonit. Ai ka shkruar se entiteti i RS-së nuk i përket vetëm serbëve, por të gjitha kombeve përbërëse, si dhe se entiteti, për shembull, nuk mund ta shpallë si “ditën e shtetësisë” atë që feston Serbia.

Deklarata e Kuvendit Serb

Ai theksoi se entitetet brenda Bosnjë-Hercegovinës nuk janë shtete dhe ekzistojnë vetëm në bazë të Kushtetutës së Bosnjë-Hercegovinës dhe nuk kanë ndonjë sovranitet të veçantë. Prandaj, Komiteti Drejtues i Këshillit për Zbatimin e Paqes (PIC) i bëri thirrje më parë koalicionit qeverisës në RS të kontrolluar nga Milorad Dodik që të ndalojë çdo veprim që minon shtetin, autoritetet e tij dhe karakterin e tij multietnik. “Doja të jem i qartë se një pjesë integrale e mandatit tim është të kundërshtoj çdo kërcënim

ndaj sovranitetit dhe integritetit territorial të shtetit, si dhe çdo përpjekje për të minuar rendin e BiH dhe kuadrin e saj institucional, stabilitetin dhe funksionalitetin. Prandaj, në rastin e akteve legjislative që dalin nga kjo deklaratë, unë nuk do të hezitoj t’ia raportoj këtë Komitetit Drejtues të Këshillit për Zbatimin e Paqes (PIC) dhe të ndërmarr veprimet e duhura dhe vendimtare në përpunje me mandatin tim.

Kritikat e SHBA

Miratimi i kësaj Deklarate është dënuar nga anëtarët e Presidencës së Bosnje e Hercegovinës, Denis Beqiroviç dhe Zheljko Komshić, si dhe nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Sarajevë. Në atë kohë, Ambasada amerikane tha se pikat e dokumentit të Deklaratës së miratuar në “Kuvendin gjithëserb” në lidhje me Marrëveshjen e Dejtonit dhe shtetin e pavarur të Bosnje e Hercegovinës “nuk përfaqësojnë mbrojtjen e Marrëveshjes së Dejtonit, siç autorët pretendojnë, por janë një sulm i planifikuar ndaj kësaj marrëveshjeje dhe ndaj institucioneve shtetërore të Bosnje e Hercegovinës”. Më 10 qershor, Ambasada amerikane në Sarajevë e cilësoi Deklaratën si të rrezikshme, dhe me plot gabime. Megjithatë, mesa duket kampanat e Amerikës bien vazhdimisht në vesh të shurdhët.

Lidhjet me Rusinë, BE dhe SHBA presion Serbisë

Bashkimi Evropian i bëri thirrje Serbisë që të vendosë sanksione kundër Ruisë, për shkak të pushtimit të Ukrainës, pasi Serbia priti zëvendësministrin e Jashtëm rus, Aleksandr Grushko. Më 2 korrik, Grushko u takua me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiç, ndërsa gjatë qëndrimit në Beograd kishte takime edhe me zyrtarët të tjerë të lartë serbë. “Bashkimi Evropian ka qenë i qartë me partnerët tanë: marrëdhëniet me Rusinë nuk mund të jenë normale pas luftës së paprovokuar dhe të pajustificuar të Ruisë kundër Ukrainës”, tha një zëdhënësi i BE-së për Radion Evropa e Lirë. Ai shtoi se Këshilli i BE-së është në dijeni për ndihmat humanitare dhe të tjera të Serbisë për Ukrainën, por se, gjithashtu, pret që Serbia, si vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, të për afrohet me politikën e jashtme evropiane dhe të sigurisë. Departamenti amerikan i Shtetit tha në një deklaratë për Radion Evropa e Lirë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës “nuk besojnë se ndonjë vend duhet t’i japë Ruisë, platformë për të promovuar luftën e saj të agresionit kundër Ukrainës”. “Është e një rëndësie vendimtare të vazhdojmë të qëndrojmë së bashku përballë agresionit të Ruisë”, tha Departamenti i Shtetit.

Petkoviç: Prishtina po e vret dialogun

Kryenegociatori i Serbisë në bisedimet me Kosovën, Petar Petkoviç, tha se “Prishtina po e vret” dialogun për normalizimin e marrëdhënieve. Petkoviç dhe kryenegociatori i Kosovës, Besnik Bislimi, u takuan të martën në Bruksel për një rund të ri bisedimesh, të ndërmjetësuar nga përfaqësuesi i BE-së, Miroslav Lajçak, por që përfundoi pa ndonjë marrëveshje. Palët diskutuan, mes tjerash, për Marrëveshjen Bazë drejt normalizimit të marrëdhënieve, për Aneksin e zbatimit të saj, për të zhdukurit në luftë dhe për një marrëveshje për energjinë. Petkoviç tha në një postim në X se Bislimi i “refuzoi” dhe “kritikoi” të gjitha këto. Në komunikatën për media që lëshoi Bislimi të martën u tha, mes tjerash, se pala serbe refuzoi të angazhohej në diskutime për miratimin e planit të zbatimit dhe zyrtarizimit të Marrëveshjes Bazë, javën e kaluar. Albin Kurti, dhe Aleksandër Vuçiç, ishin më 26 qershor në Bruksel, por zhvilluan vetëm takime të ndara me ndërmjetësuesit evropianë, pasi Kurti e kushtëzoi takimin me Vuçiçin me tri kërkesa: nënshkrimin e Marrëveshjes Bazë, tërheqjen e letrës me të cilën Serbia refuzoi zyrtarisht ta zbatonte marrëveshjen me Kosovën, dhe dorëzimin në Kosovë të Millan Radoiçit.

b o t ë

Vonesat dhe mungesa e gjumit, ja ç'fshihet pas performancës së dobët të Biden në debat

"Isha i lodhur". Presidenti amerikan Joe Biden e justifikon kështu performancën e tij katastrofike në debatin kundër Donald Trump, i cili u transmetua në median amerikane "CNN" javën e kaluar dhe e futi në panik Partinë Demokratike. Qiramarrësi i Shtëpisë së Bardhë fajësoi javët e fundit për shkak të udhëtimeve diplomatike në Evropë dhe G7 në Itali, duke shpjeguar se nuk ishte shumë e zgjuar të kishte "udhëtuar nëpër

botë disa herë" përpara debatit kundër kundërshtarit të tij të ashpër republikan. "Nuk e dëgjova stafin tim dhe më pas gati më zuri gjumi në skenë," tha ai. Në realitet, siç vëren BBC, justifikimi i Biden nuk qëndron: presidenti 81-vjeçar i SHBA, në fakt u kthye në Uashington më 15 qershor, pothuajse dy javë përpara debatit kundër Donald Trump më 27 qershor. Shtëpia e Bardhë tha se presidenti Joe Biden nuk do t'i nënshtrohet një

testi njohës dhe nuk ka sëmundje Alzheimer ose demencë. Duke iu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve, zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë Karine Jean-Pierre deklaroi se nuk është e nevojshme që presidenti amerikan të kryejë teste njohëse. "Ekipi i tij tha se nuk justifikohet në këtë rast," tha Jean-Pierre. "Ne paraqitëm një raport vjetor të plotë dhe transparent për shëndetin e tij. Pastaj ata thanë se nuk është e justifikuar. Nuk

është e nevojshme." Ndërkohë, megjithatë, presioni po rritet jashtë dhe brenda partisë që Biden të bëjë një hap prapa. Deputeti demokrat i Teksasit Lloyd Doggett është i pari që kërkon në mënyrë eksplicite që komandanti i përgjithshëm të tërhiqet nga gara presidenciale, Shpresoj që të marrë vendimin e dhimbshëm dhe të vështirë për t'u tërhequr," tha ai. "Presidenti Biden duhet të bëjë të njëjtën gjë", tha deputeti demokrat.

Kërcënimet e Bjellorusisë

Dhjetëra mijëra ushtarë rusë kanë zbarkuar në kufirin me Ukrainën, vendosen edhe armët bërthamore në gatishmëri, shteti "vasal" po pret "dritën jeshile" nga Kremli, ja çfarë do të ndodhë nëse ata sulmojnë papritur

Marsela SHYTIA

Tensionet janë ndezur përsëri përgjatë kufirit Bjellorusi-Ukrainë. Ukrainasit po përfundojnë me shpejtësi fortifikimet dhe linjat e mbrojtjes, dhe ushtritë bjelloruse dhe ruse kanë ngritur gatishmërinë e tyre luftarake, gjë që u konfirmua nga presidenti i panjohur bjellorus, Aleksander Lukashenko. Forca shtesë të këmbësorisë u dërguan në kufirin me Ukrainën, pasi Kievi është vetëm rreth 150 km larg, dhe sistemet ruse kundërajrore Iskander, të afta për të gjuajtur raketa me ngarkesë bërthamore, si dhe raketa vetëlëvizëse bjelloruse u vendosën lëshuesit. Lukashenko paralajmëroi Ukrainën të mos "luajë me zjarrin" dhe akuzoi Perëndimin se po përpiqet "të tërheqë Bjellorusinë në luftë", por se, siç thotë ai, nëse "kërcënohet siguria dhe sovraniteti i vendit, ai do të godasë me të gjitha mundësitë".

Kërcënimet e Bjellorusisë

Në të njëjtën kohë, siç raportohet nga agjencia ruse e regjimit Ria Novosti, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Bjelloruse, gjenerali Pavel Muravejko, u mburr se "ushtarët bjelloruse kanë mësuar të përdorin armë bërthamore jostrategjike ruse", të cilat, le të kujtojmë, Rusia u vendosën në Bjellorusi në fillim të vitit 2024, gjë që e bëri atë një



“Një shtet nuk është më i mirë se njerëzit që e drejojnë” - shprehet Philip K. Dick.... Një përditësim i bërë postimit tim në FB të bërë pesë vite më parë, të cilit në thelb përpos përditësimit vetëm të disa datave kalendarike, nuku mundet ti heq asnjë presje të vetme në brendinë e tij..... SHËNDETSIA PUBLIKE nuku përbën përjashtim dallues nga “turbulencat shoqërore” nëpër të cilat ka kaluar, po kalon dhe ndoshta edhe për shumë vite do të vijojë të kalojë Shqipëria e këndeji Drinit..... “HOMO DEMONCRATICUS” është pjesë jetësore në çdo qelizë të Shoqërisë sonë, përfshirë mes tyre edhe “HOMO MEDICUS” jo të pakët në Shëndetësinë Publike.... Të huajt kam perceptimin se na kanë bërë dalje me kohë, dhe ata vijnë në na takojnë ne Bruksel e jo vetëm, të na vizitojnë apo të jenë të pranishëm në Forumet e shumta të organizuara nga Pushtet-shteti i këtyre viteve të Demon-kracisë së pas 31.03.1991, thjesht e vetëm për të na tundur para syve “bezen e kuqe” të hyrjes në BE..... Ndërkohë ne vetë po vijojmë dhe ndoshta do të vijojmë të rrimë, duke pritur ende me sytë nga deti e nga qielli, apo që vetë BE dhe SHBA të na e bëjnë Shqipërinë tonë.... Nga të rrahurit e gjoksit e të ngriturit e zërit se “Po bëjmë Shtet” (ERTV), dhe deri në bërjen e tij po rezulton dita-ditës se duhet punë, punë dhe shumë punë SOVRANI foli qartazi gjatë procesit zgjedhor për Pushtetin Lokal të 30.06.2019 si me votimin e tij PRO po ashtu edhe me votimin KUNDËR, ai foli me heshtjen e tij nëpërmjet bojkotit, por ai foli njëkohësisht edhe me paqësinë e neverinë e tij ndaj dhunës dhe përplasjeve ndër vëllezërve të gjakshprishur politikisht të së djathtës dhe së majtës, prej të nxitit e mbajtur gjallë prej jo pakë kokë-nxehtëve në mesin e politikanëve/politiquenërve tanë..... Jemi në fund të varganit në vagonin e trenit të zhvillimeve socio-ekonomiko-politike të vërteta demokratike në Europën e Bashkuar, ndaj që të mundet të ndrojmë vagonin dhe trendin e këtyre

zhvillimeve, DUHET që:
 - të HAPET një kapitull i ri për historinë e këtyre zhvillimeve, ai i Periudhës së Post-tranzicionit sfillitës DEMON-KRATIK, dhe
 - hyrjen në fazën e DEMOKRATIZMIT të vërtetë të Shqipërisë sonë, si dhe
 - të MBROTHËZIMIT të prekshëm për të gjithë, dhe jo vetëm për një grusht individësh të lidhur fort me pusht-shtetin e kohës, sikundër ka ndodhur deri më sot.....
 KOHA e POLITIKANËVE të DEMON-KRACISË së këtyre 33 viteve: S. Berisha, F. Nano, I. Meta, P. Majko, F. Mediu, D. Shehu, V. Dule, P. Milo, N. Ndoka, M. Kryemadhi, P. Vasili, L. Basha tashmë ka mbaruar, POR edhe koha për largimin e vetë E. Ramës and Co. nuku duhet të jetë e largët..... KLIMA politike e acaruar artificialisht dhe alogjike e këtyre muajve e viteve të fundit, e vërtetoj këtë gjë katërcipërisht. Këto 33 vite ishin të mjafta për të provuar mosaftësitë e tyre shtetbërëse, POR thjesht e vetëm pusht-shtetbërëse, për “Të ecur vetëm Për-PARA”..... Janë tejet EMERGJENTE:
 1- REFORMA ZGJEDHORE rrënjësore, me Mazhoritar Kombëtar, e prag hyrës 5% në Parlament, me Lista të hapura si dhe Mundësi për Kandidime reale dhe të PAVARURA nga asnjë Parti aktuale politike. Në zgjedhjet e fundit Parlamentare në Kanada, 4 nga 10 individët në listën për të cilën votuam në Victoria, BC, ishin të pavarur nga asnjë subjekt politik;
 2- Dhënia e mundësisë së votimit edhe të atyre që kanë lënë “dheun-amë”, por që financiarisht “e oksigjenojnë mbijetesën dhe/ose mbrothësimin etij”;
 3- PRESIDENT i zgjedhur direkt nga Populli, me kompetenca më të gjëra, si përfaqësues i tij dhe GARANT i zbatimit dhe i mbrojtjes së Kushtetutës së vendit;
 4- TË SANKSIONOHET në Kushtetutë që Zgjedhjet Parlamentare dhe ato Lokale të katërvjeçarit të ardhshëm të pas 2025 dhe në vijimësi, se ato do të bëhen në të njëjtën ditë, në mënyrë që të EMANCIPOHEMI dhe të QYTET-ËROHEMI, për të mos vijuar të pengojmë njëri-

tjetrin apo të mbrijmë deri aty, sa “ti mbyllim me zinxhir njëri-tjetrit dyert” e Ardhmërisë së vendit.....
 PARLAMENTI i ardhshëm duhet të filloj punën e tij me:
 1- NDRYSHIME thelbësore jetëgjata të Kushtetutës, për të shmangur në të ardhmen Atentatin që ju bë asaj në 21 Prill 2008, duke kthyer atë në një mburojë të një sistemi Partitokratik dhe Autokratik të Kryetarëve;
 2- TË JETËSOJË dhe të mos vijojë zhgënjën e Reformës në Drejtësi si dhe të “mbush sa më shpejt zbrastësinë e REÇBURG-ut”, me ata që na e nxinë jetën dhe ardhmërinë tonë në këto 33 vite asfiksuere të Tranzicionit Demon-kratik..... JAM shprehur edhe më parë pa dalë në pension, se unë vullnetarisht do t’ju ofroj ekspertizën time për shëndetin e atyre, që do të jenë banorët e rinj të ardhshëm të Reçburgut, që ata/ato të rrojnë sa më gjatë si dhe të vuajnë aty bëmat e tyre;
 3- Të SANKSIONOHET me Ligj që Ligj-bërësit dhe Ligjvënësit të jenë plotësisht të përgjegjshëm për fjalët, punën e sjedhjet e tyre si brenda po ashtu edhe jashtë Parlamentit, DUKE qënë qytetarë të barabartë para ligjit, pa asnjë IMUNITET të ndryshëm nga qytetarët jo deputetë të këtij vendi;
 4- Të SANKSIONOHET me ligj kohëzgjatja vetëm në dy e mandate për postet e të gjithë drejtuesve në të katër Pushtetet: Legjislativ, Ekzekutiv, Gjyqësor dhe Lokal;
 5- TË SEKURITOHEN të gjitha pasuritë e tundëshme dhe të patundëshme të vëna në këto 33 vite, jo me punën e ndershme dhe të justifikuar me pagën e marë, DUKE i kaluar ato në fondin e Pasurive Publike në të mirën e të gjithë Popullit;
 6- Në Administratën e Shtetit të mos lejohet të rekrutohet asnjë ish-ministër, ish-deputet, ish-funksionar i lartë i të tre Pushteteve, ish-tenderbërës dhe tenderpërfutës i këtyre 33 viteve, për të “vaksionuar sado pak nga sëmundja e KORRUPSIONIT” Administratën e ardhëshme Publike;
 7- Të sanksionohet me LIGJ Depolitizimi

dhe Departitizimi i kësaj Adminstrate, duke ndëshkuar këdo që përzien punët e Shtetit me ato të Partisë. NËPUNËSI quhet Nëpunës i Shtetit dhe jo Nëpunës i Partisë(ve), e ai duhet ta fitojë moralisht dhe profesionalisht këtë status;
 8- TË zgjidhet më së fundmi konflikti pronësor në vendin tonë, edhe pse mundet që ai të rezultojë disi i dhimbshëm, sepse termi komunist ISH-PRONAR, duhet sa më parë të hidhet në koshin e historisë dhe procesi i Legalizimit abuzive të pronave të rrëmbyera ose të përvetësuara sipas parimit të “tokës së zanum”, duhet prapsur sepse shënon një precedent në historinë e Njerëzimit, KUR vjedhja e grabitja bëhen të ligjshme dhe jo të dënueshme prej tij. KJO klasë/kastë/glasë politike DUHET larguar sa më parë nga skena jonë e zhvillimeve politike.... DUHEN aktorë të rinj, pra Forca Politike/Parti të reja, si dhe Individë të pakorruptuar nga ky sistem i superndotur DEMON-KRATIK në drejtimin e tyre, për të bërë të mundur të fitohet koha e humbur Dhjetor 1990 – Qershor 2024, si dhe për çuar përpara Mbrothësimin socio-politiko-ekonomik të Trojeve Arbërore..... Me shumë dhimbje më duhet të pohoj, por ËSHTË vetëm e vetëm fillimi i fillimit të SHTETBËRËJES thelbësore, nëse një ditë duhet të vijojmë të themi krenar që jemi Shqiptarë..... IRONIKISHT më duhet të pohoj se “tre gjëra të vogla” më kanë penguar të bëja pak prokopi karriero:
 1- Nuku pranova të kem “një nofkë bashkëpunëtori të Sigurimit” para se të nisesha për studime në Francë, sepse disa syresh që e hodhën firmën në letër nuku u doli keq,
 2- Nuku kërkova të kem një tesër të PPSH-së, së cilës ja panë hajrin jo pak kolegë para si dhe pas 15.12.1990 kur “i kthyen xhaketat e kuqe nga astari i saj blu”,
 3- Nuku isha konformist por vetvetja, për çdo dekimë të rrugëtimit tim jetësor dhe profesional 42 vjeçar deri në daljen në pension më 8.09.2023.... KRENARISHT më duhet të pranoj se isha, jam dhe kurdoherë do të mbetem një Mantelbardhë dhe Shqiptar etnik i pa korrupertuar!!! Quo vadis Shqipëria ime!!!

“Diskriminim” me rrugë të standardeve ndërkombëtare?!

Nga Bardhyl BEJKO

Qytetarët e veriut të Shqipërisë janë të barabartë me tërë popullsinë e çdo treve të atdheut tonë. Kush gjykon t’i nënçmojë apo neglizhojë se janë veriorë armiqësohet me tërë shqiptarët. Qeveritë që mund të kenë prirje për t’i ndarë aq më keq t’ia kundërvënë veriu pjesëve të tjera gjeografike, atyre që jetojnë në lindje apo perëndim të Shqipërisë bëjnë krim të pafalshëm dhe absolutisht të dënueshëm. Përdorimi i ndarjes veri - jug apo lindje -perëndim është akti më i rëndë që mund t’u bëhet shqiptarëve. Jemi të gjithë shqiptarë nga Vermoshi në Konispol. Në deje na rrjedh i njëjti gjak. Jemi bij të kësaj toke. Kemi lindur, jetojmë dhe do vdesim këtu. Në këto troje kemi varret stërgjyshore. Asnjë ndarje nga njëri -tjetri. Kur politika ka dashur të na kundërvëjë ndaj njeri -tjetrit në përpjekje për të ruajtur pushtetin apo forcurat atë ka dështuar me turp. Se jemi një e të pandarë, jemi të gjithë shqiptarë. Gjatë tërë historisë tonë kur ka krisur pushka në veri nga pushtuesi serb apo në jug nga deti, shqiptarët janë bërë bashkë pa përjashtim. Aty ku rrodhi gjaku i veriorit atje u derdh edhe gjaku i jugorit. Poetët tanë të mëdhenj, mendimtarët e shquar, patriotët e njohur kanë demonstruar përmes krijimeve dhe heroizmit të tyre bashkim vëllazërimin. Kurrë nuk ka patur konflikte mes shtresave shoqërore dhe trevave mes shqiptarëve. Ndryshe nga shumë vende, afër e larg nesh, fatkeqësisht janë përfshirë në konflikte të armatosura që u kanë kushtuar jetë njerzore. Shumë plagë. Përpjekje të politikës për të shfrytëzuar ndarjet dhe fryrë urrejtjes ka patur edhe tek ne. Në momente të

veçanta janë bërë përpjekje për të përdorur individë me banim në veri kundër jugut, siç ndodhi fatkeqësisht gjatë trazirave të 1996-ës. Falë ndërjegjes së thellë kombëtare dhe pjekurisë të qytetarëve, kjo vepër dështoi me turp. Edhe pse historia jonë shekullore flet për bashkim të popullit për të mbrojtur trojet shqiptare dhe qytetarët e këtij vendi pa ndasi sipas zonave kanë lidhur besën mes tyre dhe kanë qëndruar të bashkuar. Mësimet e historisë të kombit tonë janë të provuara dhe mesazhet e dhëna kanë mbajtur shoqërinë në një kohezion të pacënueshëm. Këta jemi ne shqiptarët. Larg urrejtjes dhe cmirës, të afërm pavarësisht nga krahinat, zakonet apo fetë. Po çfarë po ndodh sot edhe pas shumë vitesh jetës në demokraci? Nuk është nevoja të jesh aktiv në politikë. As të bësh pjesë në parti të caktuara, të mbash një tesër dhe të kesh bindje politike për të eventuar përpjekjet për ndasi mes krahinave të vendit. Vite më parë u ndërtua “Rruga e Kombit”, një vepër domethënëse kjo pasi simbolikisht është një gjetje që duhet komplementuar. Buxheti i shtetit në këtë rrugë të rëndësishme investoi miliona euro. Detyrimisht duhej të vihej, si në tërë botën e ekonomisë së tregut, pagesa për çdo përdorues mjete. Në realitet, qeveria nuk kontaktoi paraprakisht grupet e interesit dhe nuk zhvilloi dëgjesa publike. Pa asnjë konsultim serioz me qytetarët u vendosën sportelet e pagesave. Opozita e shfrytëzoi këtë fakt për rrjedhojë protestat të drejtuara nga përfaqësues opozitarë, sportelet u dogjën demonstrativisht. Argumenti? Po diskriminohej popullsia e zonave veriore. Realisht, ky diskriminim ishte fantazi e atyre që nuk kishin shkelur asnjëherë në këtë segment që na lidh me Kosovën dhe më tej përmes saj më tutje. Ky segment duhej mirëmbajtur aq

më tepër që nuk ishte përfunduar dhe i kishte kushtuar ekonomisë kombëtare më shumë se 1.5 miliardë euro. Kjo shifër ishte gjysma e buxhetit të shtetit të një viti. Mirëmbajtja kërkonte shpenzime të papërballueshme për një ekonomi si jona. Për këtë u vendos një pagesë minimale në hyrje të saj. Kjo masë u quajt diskriminim i veriut të vendit. Me këtë logjikë u la mënjanë rruga e kategorisë autostradë, ku do kalojnë mijëra mjete në ditë dhe u sulmua egërsisht qeveria se vendosi një taksë pagese në sportele, siç veprohet në gjithë botën. Atentat kundër popullsisë së veriut të vendit e etiketoi opozita dhe figura të larta të opozitës udhëhoqën protestën e dhunshme. Në këtë segment udhëtojnë mbi 90 përqind qytetarë të zonave të tjera dhe të huaj, të cilët e njohin prej lindjes së tyre, tanët këtë praktikë e quajnë diskriminim të veriut. Ditë më parë një tjetër segment i rëndësishëm u përurua si pjesë e autostradës blu, Milot-Kashar. Autostradë që në të ardhmen do zgjatet drejt Hanit të Hotit dhe jugut të vendit. Sapo kaloi mjete i parë, Sali Berisha doli në dritare dhe lëshoi akuzat të rënda kundër qeverisë sipas tij, pagesa e taksës në këtë segment është kundër veriut të vendit, diskriminim ndaj qytetarëve të veriut. Dhe më tej akuzoi se ndëshkohet kjo zonë e vendit se qeveria nuk e do veriun?! Edhe ky segment u shërben të gjithëve dhe nuk është ndonjë masë diskriminuese ndaj veriut, po pagesë për të shlyer investimin, i cili është bërë me konçesion dhe paratë e hedhura duhet të kthehen mbrapsht dhe rruga kërkon mirëmbajtje. Si në tërë botën, përdoruesi i rrugës duhet të paguajë. Ai që nuk dëshiron mund të përdorë rrugët dytësore, alternative për këtë segment. Komitetet e drejtuesve të mjeteve që përshkujnë këtë segment shprehen të kënaqur

dhe e vlerësojnë si zgjidhje të shkëlqyer. Asnjëri prej tyre nuk u ankua për taksën. E konsideron normale sepse kursen karburant dhe kohë. Tek e fundit ky segment nuk është varianti i vetëm rrugor, kush do, mund të zgjedhë segmente rrugore të tjera. Këtu udhëtojnë nga tërë vendi dhe turistë nga tërë bota. Ku është diskriminimi këtu? Askush nuk diskriminohet, përkundrazi është i vlerësuar. Për rrugët, të gjithë përdoruesit e mjeteve duhet të kontribuojnë. Diskriminimi në këtë rast është në realitet pozitiv pasi janë investime të rëndësishme zhvillimi. Është luks të përdorësh rrugë të cilësisë së tillë. Dhe diskriminimi është thjesht në mendjen e atyre që kërkohen të bëjnë politikë përmes përçarjes. Veriu është në prioritetet e qeverisë dhe duhet të mbetet në strategjinë e zhvillimit të balancuar për një mijë arsye. Jo thjesht si pozicion gjeografik, po së pari se atje jetojnë denbaden shqiptarë, vëllezërit e jugorëve dhe veriorëve, lindorëve dhe perëndimorëve, pjesa vitale e kombit. Meriton shumë kjo trevë pasi veç të tjerave është destinacion i çmuar turistik. Është treva ku lulëzon turizmi dhe po ndryshon jeta e kësaj treve, e cila meriton të jetë në qendër të politikave zhvillimore, ashtu siç vërtetë po ndodh me paketat e zhvillimit dhe investimet në rrugë arterie kombëtare dhe zonale. Realisht, ky është diskriminim më pozitiv i veriut të vendit. Negativ është investimi politik për të përçarë shqiptarët dhe mbjellë urrejtjen mes tyre. Shqiptarët janë një dhe të pandarë dhe nuk bien pre e propagandës përçarëse dhe urrejtjes. Përkundrazi mbeten përjetësisht bashkë në udhëtimin drejt të ardhmes në shekujt që vijnë të këtuashmit dhe shqiptarët përtej kufijve të Shqipërisë, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë, Preshevës dhe kudo që ndodhen.

k o m e n t e & a n a l i z ë

www.sot.com.al

PD euroatlantike ka statut, baza kërkon dhënien fund tranzicionit dhe korrupsionit!

Nga Qamil GJYREZI

Në PD euroatlantike ka filluar një debat mediatik mbas vendimit për vulën. Debat i shtrohet në opsionet, që demokratët euroatlantikë të drejtohen me kolegjalitet nga një grup përfaqësuesish, jo parti e kryetarit, ose të drejtohet nga një fytyrë e re!? Mbas vendimit për vulën, është mbledhur kryesia e PD-së euroatlantike dhe janë diskutuar dy opsione, të cilat u reflektuan në bazë. Në PD në euroatlantike të Shkodrës u diskutuan opsionet dhe mendoj se PD duhet të bëjë rekurs, ka statutin, këshillin kombëtarë, kryetarin të zgjedhur me statut Basha. Vendimet duhet të merren nga elitat e

partisë, një grup i ngushtë me vizion për të ardhmen. Për idenë që PD të drejtohet me kolegjalitet, Basha është kritikuar shpesh se ka marrë vendime kolegiale dhe duhet të sillj me autoritarë me dorë të hekurt!? Po bëj komentim tim real-politik, para se të analizoj pretendimet e anëtarëve të kryesisë, që kanë ndryshuar edhe pamjen, për të shprehur 'shqetësimin' për humbjen e vulës, kurse një tjetër ka ndryshuar zërin dhe fjalorin për të shprehur idetë e tija!? Për demokratët euroatlantikë të bazës dhe drejtuesit e strukturave, as që e kanë ndërmend këta ide, por kanë besuar jo tek vula e PD-së, por tek Basha, tek misioni, programi euroatlantik i PD-së i prezantuar me datën 1 Qershor. Baza është për ndryshimin dhe dal-

jen nga kriza, duke i dhënë fund Katovicës 34-vjeçare dhe korrupsionit galopant. Vetëm një grup politik dhe politikanë që kërkajnë dhënien fund të tranzicionit dhe janë kundër marrëveshjeve në dëm të shqiptarëve, duhet të dëgjohen dhe mbështeten nga shqiptarët. Në këtë kontekst po citoj Zotin Basha në një emision televiziv me Znj Mirela Milori: 'Kryetari zgjidhet sipas rregullave që kemi rënë dakord, parti që ka caktuar rregullat se si do të drejtohet. Ka hapësirë dhe kohë për të eksperimentuar në PD-në euroatlantike. Sekush është i thirrur të thotë mendimet e vehta, por duhet të merren vendimet për të ecur përpara. Rekursi, lista e deputetëve për zgjedhjet e vitit 2025, aleatët, strukturat janë të gatshme për të bërë betejë kundër Ramës

dhe Berishës. Basha vazhdon më poshtë: 'Baza dhe drejtuesit politikë shprehin idetë dhe ndjesitë e tyre, por ka edhe një ide tjetër, që ky është debat që zhvillohet në një grup të ngushtë njerëzish. Shqiptarët duan të dinë çfarë bëhet me koston e jetës, me çmimet e shportës, me shëndetësinë, që është kthyer në vëmendje në formën më makabre. Shëndetësia falas nuk është as shëndetësi as falas, është vdekje me pagesë, arsimi, korrupsioni, kurrë nuk ka patur një përshkallëzim të tillë dhe një tallje të tillë të Ramës'. Si përfundim ka ardhur koha që të besojmë se Shqipëria do të behet dhe në 2025 duhet të vijë fundi i klasës korruptive që ka penguar zhvillimin ekonomik dhe ka sjellë vetëm varfëri dhe zhgënjim.

Gjemba e hithra, këto fakte e shifra

Nga Ilmi QAZIMI

Qeveria me kryetar Edi Ramën e ka transformuar Shqipërinë e vogël në një partner të madh, të besueshëm e të qëndrueshëm të shteteve të fuqishme mbi pesëqindvjeçare kapitaliste!? Janë arritur shumë suksese, drejt konsolidimit të kapitalizmit në këtë vend të Ballkanit Perëndimor, me një etnicitet të quajtur shqiptarë, por të ndarë e shkërmqur nga fuqitë e mëdha amerikano-europiane në gjashtë shtete; madje edhe një komb në dy shtete. Nëpër portale, emisione, video, filma, kronika deri edhe vizatime në mure, flitet e mblaçitet, manipulohet e mashtrohet rëndshëm me shifra e fakte për turizmomanië dhe plot të tjera shifra, fakte, të dhëna, të thëna, të bëra e të pabëra. Le të flasim sadopak me gjuhën e tyre. Strukturohen, emërtohen dhe ç'emërtohen apo suprimohen për t'u regjistruar me tjetër emër, organizma e organe të një zinxhiri administrativ militantësh partiakë gjysmë në dobi të problemeve të popullit. Jepen shumë shifra rezultatesh, ekzistencash, ngjarjesh, treguesish, nga më interesantët. Psh: çdo 24 minuta në Rinas, ulet një avion; Shqipëria ka 6000 sallone mode për gratë; nëpër Shqipëri lëvizin 2,7 milion targa makinash të huaja; amnistia nxori prej qelive 3800 të burgosur; për tre muajt e parë 2024 në Shqipëri erdhën 1,7 milion turistë; në krahasim me vitin 2013 kemi 43 % më pak njerëz të aksidentuar nga makinat; për një javë në Tiranë u vunë 28 mijë gjoba dhe u arrestuan 34 shoferë; Shqipërisë i shërbejnë dy satelitë amerikanë që kanë kushtuar 6 milion dollarë!; gjatë këtyre 11 vjetëve

janë emëruar e shkarkuar 19 ministra; importi kontrabandë më i lartë i cigareve në Shqipëri, është regjistruar në vitin 2010 me mbi 4.500 ton; dhanë provimet e gjuhës shqipe dhe letërsisë 31.667 maturanë; 28 mijë maturanë dhanë provimin e matematikës; 32 mijë maturanë i nënshtrohen provimit të lëndës me zgjedhje; (provimet janë detyrim shkollor për të gjithë por shifra e provimdhënësve është jo e njëjtë, këtë e di ministria përkatëse e cila, me sa duket, nuk di asgjë!); turizmi gjatë vitit 2024 do të jetë 35% më i shtrenjtë se një vit më parë; etj, etj. A patë kundë ndonjë të dhënë për prodhimin e bukës së gojës që quhet grurë? Po për mishin e qumështin, a keni gjetur ndonjë shifer kundë? Po numuri i lopëve në Shqipëri në vitin 2024 ku mund të gjendet vallë? Sa për këtë, janë lodhur shumë dy ministri nga ato të kësaj qeverie me emërtimet përkatëse, sepse kanë përpiluar një dokument nr. 06 datë 7.3.2024 ku parashikohen tetë lloj mbështetjesh për fermerët, por askund nuk zihet në gojë në se bëhet fjalë për lopë, derrë, dhi, dele, kaprollë apo... çfarë! Dhe të gjorëve fermerët u duhet të plotësojnë një mal me dokumente në 'e-albania' pa mezi a do të mund të fitojnë garën për t'u mbështetur me euro nga ky farë lloj 'euroshteti'? E vërteta gjysmë e vërtetë është se kemi 153 mijë lopë më pak se vitin e kaluar, dhe gjysmë milion dhi më pak se një vit më parë. Ndaj edhe qumështi që blejmë është 'bio'? Madje edhe më tej akoma: ka mbetur promovimi i heronjve te kombit vetëm në dorë të firmave që prodhojnë dhallë, që dihet nga tërë bota se, si nënprodukt i qumështit ai është me më pak vlere ushqyese dhe pa as më të voglin 'autoritet' ushqimor. Doli

edhe censusi: më në fund, marrim vesh një gjysmë të vërtetë tjetër se nga të dhënat e popullsisë, në Shqipëri rezultojnë 2.402.113 banorë. Krahasuar me ato të Censit e vitit 2011 në vendin tonë rezultojnë 419 mijë e 831 banorë më pak ose afër 17%. Ka më shumë banesa se banorë, ka më shumë makina se motorë, ka më shumë islamikë se katolikë (ky fakt as i ka interesuar kurrë shqiptarëve, sepse feja e shqiptarit ka qenë e mbetet shqiptaria, ndaj nuk përbën aspak tregues sinjifikativ veçse të nxitit përçarjen, si dhe shumë fakte e shifra të tjera të këtij paloregjistrimi të popullatës dhe banesave që vetëm shpajnë dhe helmojnë unitetin dhe qëndrueshmërinë historike të popullit tonë. Po ne jse!) Nuk po sjellim shembujt plot bujë e aroma vdekjesh të disa mjekëve dhe institucioneve mjekësore, të drejtorëve, ministrave dhe kryetarëve të bashkive të dënuruar nga ligjet për "shpërdorim të detyrës" (që të jemi të rezervuar edhe ky nen është tepër mashtrues dhe korruptiv se është çati për mbulim të aq shumë lloj aktesh armiqësore dikasteriale!). Atëherë, përse vallë nuk jepen humbjet, mosarritjet, dëmtimet, përkeqësimet? Sepse sundojnë mashtrimet! Është kjo arsye që kemi të drejtë të mendojmë se ndryshe flitet e ndryshe vepron. Ndryshe e kanë emrin organet qeveritare e ndryshe u reflektohet veprimtaria. A nuk do të ishte më mirë që ministratë e tanishme të kishin emërtimet si vijon?! Ministria e drejtësisë; Ministria e keqësimit të shëndetit dhe braktisjes së mbrojtjes sociale; Ministria e rritjes së pagave dhe uljes së pensione; Ministria e mungesës së kulturës, dijes dhe shkencës; Ministria e turistëve jo shqiptarë; Ministria e shkollave të mbyllura, rinisë së

munguar dhe sporteve të pa zhvilluara; Ministria e shkatërrimit total rural; Ministria që planifikon, zbukuron dhe amortizon mashtrimet parlament-qeveri, qeveri-drejtësi dhe qeveri-media. Por bolla me këto sepse kam harruar më kryesoren: ministratë janë dikasteret më hajdute 'ligjore' që ka vendi ynë sot! Mirëpo kryetari Edi Rama është shumë besimplotë për të ardhmen e sigurt dhe thotë: "Nga ana tjetër lufta me korrupsionin nuk është thjesht lufta e drejtësisë, por një luftë për të pasur në të gjithë frontin e institucioneve një solidaritet dhe kapacitet që ia kushton hapësirat për ta luftuar... Në këtë aspekt kemi bërë shumë gjëra pozitive. Duhet të ngrejmë shumë më tepër stekën e luftës kundër korrupsionit në të gjithë frontin, jo thjesht tek drejtësia. Ky është momenti, njëri nga dy momente, që ma bën më tundes se çdo gjë tjetër pozicionin në raport me mandatin e katërt. Se në kushte të tjera nëse do të kisha bindjen e plotësisë të mozaikut që kemi nisur me imazhin e Shqipërisë, turizmin e ngritjen e nivelit të turizmit, mbase nuk do të kisha më tunding." A muartë vesh gjë ju të dashur shqiptarë votues se ku i rreh kryetarit tonë kur thotë këto fjali kaq të 'bukura'? Ne kemi edhe një fjalor të spikatur "O Dudi, moj Dudi, ku më dhemb mua e ku më fërkonti!?" Qeveria dhe kryetari i saj "nuk pranojnë aspak" se janë ata autorë të bëmvave që u krijuan kushte për të hyrë në fjalorin e shqipes specifikisht pesë fjalë të reja të famshme depolitizim, dekriminalizim, dekurvërim, dekusarim dhe korrupsion, por shprehin kënaqësinë që po luftohet kundër korrupsionit dhe njerëzitet po përshtaten me kushtet e reja!?

"Atdheu dhe nëna nuk harrohen!"

Nga Gjon NEÇAJ

Nga anët tona, ne veri të Shqipërisë, është një shprehje popullore, e cila mbahet mend dhe zbatohet nga të gjithë. Atdheu e nëna nuk harrohen, thuhet në shprehjen popullore, e cila mbetet e paharrueshme për jetë. Ky shkrim u bë shkas nga të dhënat që po japin lajmet nga regjistrimi i popullsisë. Shqipëria ka aktualisht 2 milionë e 204 mijë e 113 banorë. Shifra u bë publike nga Instituti i Statistikave dhe krahasuar me regjistrimin e fundit të popullsisë të vitit 2011, rezultoi që shteti ka 419 mijë e 831 banorë

më pak. Ndërkaq, më 2001 numri i popullsisë së Shqipërisë ishte 3 milionë 69 mijë e 275 banorë. Sipas të dhënave të Institutit të Statistikave, numri i familjeve është 755.950 dhe një familje ka mesatarisht 3.2 anëtarë. Ndërsa, numri i popullsisë ka rënë me thirrje 17 për qind, teksa numri i shtëpive është rritur në 70.000. Sipas të dhënave të regjistrimit të popullsisë në vitin 2023 numri i shtëpive ishte 1 milion e 82 mijë e 529, ndërkaq më 2011 ishin 1 milion e 12 mijë e 400 shtëpi. Analiza dhe studime tematike do të kryhen për fusha të ndryshme të jetës. Këto analiza do të jenë për përdoruesit një burim informacioni për të ndërtuar një të ar-

dhme më të mirë, më të barabartë dhe të qëndrueshme për të gjithë shoqërinë. Hartuesit e politikave, vendimmarrësit, studiuesit, bizneset, mund t'i përdorin për planifikimin zhvillimor, analizën e dukurive demografike, sociale, ekonomike dhe mjedisore, marrjen e vendimeve të rëndësishme dhe zbatimin e tyre në praktikë në dobi të shoqërisë sonë. Regjistrimi i popullsisë ofron të dhëna edhe në lidhje me shtetësinë dhe në Shqipëri, 99.4 për qind janë shqiptarë. Si shtetas grek janë deklaruar 23.485 qytetarë, egjiptianë 12.375 dhe 13.507 nuk kanë dashur të deklarohen. Sa i përket besimit fetar, Shqipëria rezultoi me shumicë myslimane, me mbi 1.1 milion

banorë, rreth 200.000 banorë janë deklaruar si katolikë, ndërsa 173.000 si besimtarë të fesë ortodokse. Rreth 244.331 kanë zgjedhur të mos përgjigjen në pyetjen se cilës fe i përkasin. Bashkimi Evropian ka dhënë 4.8 milionë euro grante për INSTAT-in për të mbështetur këtë proces. Regjistrimi ndihmon në kuptimin e ndryshimeve demografike, planifikimin e shërbimeve publike si shkollat dhe spitalet, ofrimin e shërbimeve të ndryshme nga bashkitë, transportin, ndarjen buxhetore, ndarjen dhe kufizimet e personelit shtetëror në një zonë ose komunë, si dhe për planifikimet në të ardhmen. Është thelbësore për formësimin e së ardhmes së komuniteteve dhe kombit.

k o m e n t e & a n a l i z ë

Popullsia shqiptare Orthodoxe-pakësim natyral apo ka ndikuar politika?

Nga Pirro PRIFTI

Realizimi i Censurit mbetet në fakt një punë voluminoze e cila kërkon specialistët përkatës. Censuri i vitit 2023 megjithëse me vonesë, tregoi disa elementë të domosdoshëm të shtetit shqiptar nëpërmjet të cilave populli sheh si në pasqyrë veten e vet, kurse qeveria dhe pushtetet e tjera shikojnë problemet që duhen zgjidhur në të ardhmen. Pavarësisht rënies drastike të popullatës në raport me Censurin e vitit 2011, një rënie prej 450 mijë banorësh kryesisht nga emigracioni dhe më pak nga rënia e lindjeve apo rritja e vdekshmërisë për shkak të Pandemisë apo të Kancerit, mund të vihet re se disa të dhëna të tjera duket që ndikojnë jo për mirë në prosperitetin e popullit shqiptar dhe në integrimin e vëndit. Një nga këta faktorë përveç emigracionit (sidomos të të rinjve) gjë që ka shkaktuar rritjen e moshës së tretë deri në 700 mijë banorë pra ~¼ e popullsisë është plakur, janë edhe faktorë të tjerë që duken sikur përpiqen të pengojnë Shqipërinë të jetë një vend evropian dhe i integruar. Ashtu si shpjegoi edhe një nga përfaqësuesit e BE se... Shqipëria është praktikisht e integruar në BE meqenëse ka 1/3 e popullsisë të larguar e të integruar me BE dhe vëndet e tjera perëndimore. Gjendja demografike në Shqipëri tregon disa diskordanca në dukje të papërfillshme, porse mund të jenë me konsekuenca në të ardhmen sidomos në idenë e globalizimit, ku vëndet e vogla do të jenë më të humburat për sa i përket problemit të Etnisë dhe të traditave kombëtare dhe fetare. Dy problematika më kryesore mbi të cilat ka ndikuar politika shqiptare jo konsekuente dhe aspak kombëtare janë: Minoritetet dhe Religjionet. Përse i kam vënë në fokus këto dy faktorë bazë të Censurit, elementë të cilët nga shumë njerëz shihen thjesht si të dhëna statistike, dhe jo si problematika të krijuara gjatë viteve të demokracisë? Sepse këta dy faktorë mund të dëmtojnë Shqipërinë si shtet i shqiptarëve dhe Shqipërinë me një komunitet të konsiderueshëm të krishterë.

I. Censuri Minoriteteve.

Përse i përket minoriteteve, ashtu sikundër shihet nga statistikat e viteve 1923, 1927, 1945, 2011, 2023, që janë paraqitur më poshtë, vërehet se sipas burimit "T.Selenica", nuk paraqiten minoritete përveç se tregohet që kishte 99 hebrenj në prefekturat e Gjirokastrës, Vlorës dhe Tiranës. Sidoqoftë në vitin 1945, Censuri i atij viti u bë edhe për minoritetet, madje edhe u paraqit mesa duket me kërkesën tendencioze të grekëve për gjëndjen e minoriteteve në Shqipëri i cili u paraqit edhe në OKB e atëhershme. Dhe aty del se kishte 46.577 banorë të kombësive të ndryshme, 31.500 minoritare grekë në Gjirokastër+Sarandë; 9400 maqedonas ne Prespe e Gollorborde, 2000 malazezë e serbë, por nuk kishte asnjë grek ne Korçe dhe Himare. Censuri fetar nuk ishte bërë. Gjatë viteve të komunizmit, popullsia u rrit por nuk pati Censur fetar, kurse census minoriteteve vërehej vetëm ai për minoritarët grekë që ishin deri në 23.5 mijë deri në 1989. Në vitin 2011 u vu re një shtim i grupeve minoritare në Shqipëri kryesisht për tre faktorë kryesore:

Dëshira për të përfutuar, punë e pensione nga vëndet fqinjë

Dëshira për të marrë pasaportë të huaj, për tu larguar nga vendi jo më si emigrant por si i huaj

Mungesa dhe pa-afësia e shtetit shqiptar dhe e politikës shqiptare për të përmirësuar mirëqenien në Shqipëri, qoftë për shkak të drejtuesve vendorë dhe qendrorë të pa-afët dhe me mentalitet katundar e militant partiak, qoftë dhe ryshfetet dhe korrupsioni masiv që

plasën në kohën e demokracisë, duke e lënë vëndin për një kohë të gjatë në një demokraci të rrezikuar dhe anarki.

Shumë shqiptarë u bënë egjiptianë, grekë, maqedonas, bullgarë, malazez e serbë duke e ditur mirë se familjet e përzjera me shqiptarë nuk mund të quhen minoritarë por bilingualë, dhe së dyti, nuk mund të ndrrohet etnia me dëshirë sepse AND nuk gënjën.

Sidoqoftë paradokset në kohën e demokracisë-anarkike shqiptare janë të zakonshme, por sigurisht dora e politikave fqinje për ta nxjerrë Shqipërinë si një vënd heterogjen me atë strategjinë që sa më shumë minoritarë aq më shumë Shqipëria do të jetë e përçarë dhe se mund të shpërbëhet.

Kjo e ka fillimin në vitet '90 kur u prishën me urdhër, të gjitha fabrikat, uzinat, kombinatet, punishtet dhe detyruan që të largohen rreth 650.000 shqiptarë deri në 1999. Lejimi pa kriter i minoriteteve për shkak të presioneve greke, rumune, bullgare, maqedonase, të shoqëruara dhe me rrushfetet përkatëse, ka dëmtuar Shqipërinë në sytë e BE, pavarësisht se Demokracia liberale nuk e vë re këtë aspekt, por e parë me strategjitë e politikave fqinje, shtimi artificial i minoriteteve është në dëm të Shqipërisë.

2. Censuri Fetar është më i preکشëm dhe më i lakuari si nga politika shqiptare dhe atyre fqinje, ashtu dhe shumë i rëndësishëm përse i përket historisë së Shqipërisë, në të cilën komuniteti orthodox ka luajtur rolin e violinës së parë qoftë për Pavarësinë e Shqipërisë më 1912, ku 11 firmëtarët ishin orthodoxë, 2 ishin katolikë, 10 ishin kosovarë, dhe 17 ishin intelektualë myslimanë shqiptarë, qoftë në hapjen e shkollës së parë Shqipe në Korçënë 1887, qoftë për Kongresin e Alfabetit të bërë në Manastir më 1908, qoftë për bërjen e hymnit të Shqipërisë, qoftë për bërjen e këngëve patriotike, qoftë për luftën për pavarësi dhe luftën nacion-al-çlirimtare, qoftë për shoqatat patriotike që luftonin për pavarësinë e Shqipërisë në Bukuresht, Sofie, Misir, Stamboll, qoftë dhe për shkëputjen nga kisha greke nëpërmjet krijimit të Autoqefalisë që në 1922 në Berat ku roli i Fan Nolit të madh ishte vëndimtar në predikimin shqip në kishat e asaj kohe, qoftë edhe në kohën e demokracisë së bashku me komunitetet e tjera sidomos me komunitetin bektashi. Sipas statistikave të T. Selenicës për vitet 1923 dhe 1927, popullsia orthodoxe në raport me popullatën e përgjithshme ishte 171 mijë ose 20.5% në 1923, dhe 181 mijë ose 21.7% në 1927. Nuk ka të dhëna në Censurin e vitit 1945 për Censur fetar, por vërehet se vetëm numri i minoritarëve grekë, tregon për popullsinë orthodoxe pjesërisht sepse komuniteti orthodox shqiptar është 6 herë më tepër se ai grek. Në vitet e Diktaturës ka shtim gradual të popullsisë në Shqipëri deri në 3.12 milion banorë në vitin 1989 për shkak të izolimit, por edhe për shkak të politikave për të patur shumë fëmijë. Në një bisedë me Hrushovin, Diktatori Enver Hoxha i pyetur se sa orthodoxë ka Shqipëria, Diktatori u shpreh se orthodoxë janë rreth 30%.

Vetëm në vitin 2011 u realizua Censuri fetar ku çuditërisht popullsia e komunitetit orthodox u paraqit si 189 mijë vetë ose 6.7%, pra vetëm 8 mijë vetë më tepër se popullsia orthodoxe e vitit 1927 ku popullsia orthodoxe ishte 181 mijë vetë në një kohë kur popullsia e vitit 2011 ishte 2,8 milion pas 84 vitesh, dhe popullsia e vitit 1927 ishte 814 mijë?! Skandal! Edhe sikur emigrimi të kishte larguar shqiptarët, largimi do të ishte afërsisht njëjloj si edhe për komunitetet e tjera por jo në këtë shifër komplet absurde! Në Censurin fetar të 2023 shifrat ishin rregulluar disi duke paraqitur popullsinë

orthodoxe pak më shumë në një kohë që popullsia shqiptare mbetet më e vogël se e vitit 2011, praktikisht me 173.645 vetë ose 7.17% në një popullsi prej 2.14 milion banorë?! Interesant është fakti i popullsisë katolike ndër vite. Ka vetëm një element që nuk ka ndryshuar popullsia katolike: 10.5% në 1923; - 10.5% në 1927; 10% në 2011; dhe ~10.3% në 2023 ???!!! Si ka mundësi që popullsia katolike megjithë këtë emigrim nuk ka ndryshuar fare, popullsia myslimane nuk ka ndryshuar fare ose ka ndryshuar pak në raportet me bektashinjtë, kurse popullsia orthodoxe ka ulje drastike dhe mesa duket, aspak shkencore dhe statistike, po të shohësh në vijueshmëri datat e bërjeve të Censurit? Mendoj se ulja drastike e popullsisë orthodoxe ka shkaqe artificiale të cilat mund të rreshtoj si më poshtë:

-Politike sepse grupet politike shqiptare si dhe një pjesë e shoqërisë shqiptare janë të sensibilizuar dhe refraktarë ndaj Drejtuesit grek të KOASH-it shqiptar, dhe presioneve disa vjeçare të politikave greke për minoritetin grek, i cili sipas tyre "duhet të jetë më i madh se sa del në census".

Duke qenë kështu, politikanët kanë menduar që të ulin artificialisht popullsinë e komunitetit orthodox, megjithëse dihet që raporti i minoritarëve orthodoxë dhe orthodoxëve shqiptarë është rreth 6 herë më i madh në favor të shqiptarëve!

- Sociale, një pjesë e orthodoxëve shqiptarë që nuk janë dakort me Drejtuesin jo shqiptar të KOASH-it, nuk kanë preferuar të paraqiten si orthodoxë në Censurin. Sigurisht mund të ketë edhe të tjerë por si në gjithë komunitetet e tjera që mund të jenë larguar nga feja ashtu si paraqiten si "ateistë" apo që "nuk përgjigjen" apo "nuk disponohen", por ky kontigjent nuk mund të jetë vetëm orthodox!

-Indiferentizmi apo urrejtja e fshehur e disa qarqeve të cilat mund të jenë edhe si pjesë e "stafit të Censurit", duke i paraqitur orthodoxët shqiptarë të gjithë si "greqë".

-Ndikimi i ngjarjeve në Kosovë, ku shqiptarët e Kosovës dhe sidomos disa qarqe islamike kosovare të cilat duke urryer politikat serbe dhe vetë Serbinë orthodoxe, bëjnë gjithashtu dhe një lidhje të shkurtër edhe duke urryer edhe orthodoxët shqiptarë, madje duke transferuar klimën e urrejtjes ndaj orthodoxisë serbe e ruse edhe ndaj asaj shqiptare. Nuk duket e rastit, - e parë me këtë prizëm- harresa ndaj Rilindasve shqiptarë të cilët kanë dhënë kontributin kryesor për Shqipërinë për të cilët shkrova më sipër (pa ulur vlerat e intelektualëve myslimane e katolike).

- Zhgënjimi nga Diktatura e cila për të mbajtur sa më gjatë pushtetin, përdori Rilindasit orthodoxë, këngët e tyre, emrat e tyre, famën e tyre, për të krijuar Shqipërinë dhe shkrimin shqip, në disa raste mërziti shoqërinë shqiptare të asaj kohe me promovimin e tyre vazhdimisht, gjë që ka dhënë një ndikim negativ ndaj komunitetit orthodox të sotmë në sy të shoqërisë shqiptare të sotme.

-Emigracioni, sigurisht emigrimi ka qenë afërsisht në përpjesim të barabartë ndaj të gjitha komuniteteve fetare, dhe kështu nuk mund të thuash që janë larguar më shumë orthodoxë se sa katolikë apo myslimanë apo edhe ateistë.

Në përfundim, të para në këtë këndvështrim, sigurisht jam i mendimit se numri i popullsisë orthodoxe është shumë më i madh edhe në ditët e sotme, madje po aq sa ka qenë para 2011 rreth 21%. Këtë mund ta vërtetojë kushdo i cili shikon numratorin telefonik ose po të shkojë në varreza dhe të shohë emrat e të vdekurve.

Mund të vërehet numri i madh në raport me Censuset, i emrave dhe mbiemrave orthodoxë. Prandaj mendoj se Komisioni i Censurit nuk ka treguar saktësisht se sa është numri real i popullsisë orthodoxe si në vitin 2011 ashtu dhe në vitin 2023, dhe kjo mendoj se është bërë si i thonë "me urdhër nga lart"! Shpresojmë që me vendosjen e një Drejtuesi klerik orthodox shqiptar në KOASH, do të mund të tregohet realisht se sa është popullsia orthodoxe shqiptare, pavarësisht minoriteteve apo jo.

Më poshtë janë tabelat e Censuseve ndër vite në Shqipëri:

CENSUS FETAR 2023

Popullsia 2.402 milion banorë	
Besimi Fetar Mysliman 1.101.718 - 45%	
Mysliman-Bektashi 115.644	
Krishterë-katolikë 201.530	10.5%
Krishterë - Ortodoks 173.645	7.17%
Ungjillore 9658	
Tjetër besim 3670	
I pacilësuar 332.155	
Ateist. 85.311	
Nuk përgjigjen 244.331	
Nuk disponohet 134.451	
Minoritetet	
Shqiptarë	2.186.917
Grek	23485
Egjiptian	12375
Bullgarë	7057
Boshnjakë	2963
Maqedonisë së Veriut	2281
Serbë	584
Malazezë	511
Romë	9813
Aurumunë	2459
Pa përgjigje	13.507
Burimi: INSTAT/ CENSUS 2023	

CENSUS FETAR 2011

Popullsia -2.8 milionë banorë,	
Besimi mysliman 1.58 milionë ose 56.7 %	
Besimi bektashi 58,624 vetë ose 2.1%	
Besimi katolik 281 mijë vetë ose 10 %	
Besimi Orthodox 189 mijë vetë ose 6.7%	
Ateiste 70 mijë vetë ose 2.5%	
Besimtare pa religion 154 mijë vete 5.5%	
Besime të tjera 70 mije vete ose 2.5%	
Refuzoi te pergjigjet 112 mije ose 4%	
Nuk disponohen ~280 mije ose 10%	
Minoritetet	
Greke	24242
Arumune	8266
Rome	8100
Maqedonas	5512
Malazeze,	366
Egjiptiane,	3,368
(Burimi: INSTAT/CENSUS 2011)	

CENSUS I VITEVE 1923 DHE 1927

Popullsia 814 mijë banorë	
Përkatësia fetare 1923	
Besimi mysliman -558 mijë, ose 68.5%	
Besimi Orthodox 171 mijë ose 20.5%	
Besimi Katolik 85 mijë ose 10.5%	
Në vitin 1927	
Popullsia 833 mijë banorë	
Përkatësia Fetare	
Besimi mysliman -563 mijë, ose 67.6%	
Besimi Orthodox 181 mijë ose 21.7%	
Besimi Katolik 88.739 mijë ose 10.6%	
99 hebrenj, që jetonin në Prefekturat e Gjirokastrës, Vlorës dhe Tiranës.	
(Burimi: T. Selenica)	

CENSUS I VITIT 1945

Popullsia 1.122.044 banorë	
1 075 467 shqiptarë autoktonë dhe 46 577 të kombësive të ndryshme.	
Asnje grek ne Korçe dhe Himarë	
31500 minoritare ne Gjirokastrë+ Sarandë.	
9400 maqedonas ne Prespë e Gollobordë	
2000 malazeze e serbo& kroate	
Censur Fetar - nuk u regjistrua.	

Brentfordi kërkon 4 mln euro për të lënë të lirë Thomas Strakoshën

Paraqitjet e mira që bëri në Europianin e Gjermanisë, ku u zgjodh të lunate titullar në të tri ndeshjet në grup që Shqipëria luajti ndaj Italisë, Kroacisë dhe Spanjës, bënë që Thomas Strakosha të marrë vëmendje të shtuar në merkato dhe klubet që e kërkojnë atë janë të shumta dhe me shumë gjasë portieri i përfaqësueses kuqezi do të ndryshojë ambient në këtë merkato vere. Referuar asaj që shkruajnë mediat britanike, Thomas Strakosha do të largohet gjatë kësaj vere nga Brentfordi, pas dy sezonesh që e kanë lënë praktikisht në vendnumëro në karrierën e tij portierin

e Kombëtares shqiptare. Ai thaujse nuk është aktivizuar me klubin anglez, duke bërë që këto dy sezone t'i kalojë si spektator, edhe pse shkoi në Angli me dëshirën për të treguar veten në elitën e futbollit të këtij vendi. Tanimë, portieri po kërkon një sistemim të ri dhe emri i tij ka qarkulluar si në klube greke, ashtu edhe italiane. Interesi për të nuk mungon, sidomos pas paraqitjes së mirë në Euro 2024. Kjo ka shtyrë Brentford që të vendosë një çmim për kartonin e portierit shqiptar, pasi kërkon të përfitojë financiarisht nga shitja e tij, edhe pse mori lojtarin me parametër zero kur

ai kaloi në Angli pasi mbylli kontratën me Lacion. Sipas mediave italiane, Brentfordi ka caktuar shifrën e 4 milionë eurove për të lënë të lirë Strakoshën i cili ka edhe një vit kontratë me klubin anglez. Siç e thamë më lart, Strakosha bëri një paraqitje shumë të mirë në Europian dhe pavarësisht se Shqipëria pësoi 5 gola në Gjermani-2024, asnjëri nga golat nuk ishte për faj të tij të drejtpërdrejtë, por për shkak të gabimeve nga mbrojtësit. Sidomos në ndeshjen me Italinë dhe Kroacinë ai bëri shumë pritje, në ndonjë rast duke merituar edhe notë të lartë në vlerësimet e UEFA-s.



Emri i teknikut lakohet si kandidat i mundshëm për të marrë drejtimin e Korinthiasit në Brazil

Mediat amerikane thonë se Silvinjo nuk do të rinovojë me Shqipërinë, e pret një klub në Brazil

Adriatik BALLA

Lajmet që qarkullojnë në media të ndryshme europiane dhe amerikano-latine se tekniku brazilian Silvinjo nuk do ta vazhdojë kontratën e tij me Shqipërinë duket se nuk janë thashetheme por mes tyre ka gjëra të vërteta. Në fakt, sa më shumë kalojnë ditët aq më shumë Silvinjon e kërkojnë klube të rëndësishme në Brazil dhe në Europë dhe nuk përjashtohet mundësia që Silvinjo të nisë një karrierë si trajner klubi, gjë që ka qenë edhe ëndërr e kahershme e tij. Së fundmi janë mediat braziliane që thonë se klube portugeze dhe braziliane janë të interesuara për teknikun e kombëtares së Shqipërisë.

Situata

Përfundimi i aventurës së Shqipërisë në Euro 2024, ka mbyllur edhe aventurën e trajnerit Silvinjo në pankinën e kuqezinjve. Tekniku brazilian i mbaroi kontrata dhe për momentin nuk ka bërë asnjë hap para për rinovimin e saj edhe pse FSHF-i ka bërë një propozim atij prej disa muajsh për të drejtuar kuqezinjtë në rrugëtimin drejt Botërorit 2026. Megjithatë, trajneri heziton pasi ka marrë



edhe oferta të tjera gjatë këtyre ditëve, me ekipe portugeze të interesuara për të, e jo vetëm. Falë kualifikimit të Shqipërisë, karriera e Silvinjos është ringjallur dhe për të janë hapur dyer të rëndësishme që dukeshin të mbyllura, pas aventurave aspak të mira me Korinthians dhe Olimpik Lion. Në këto ditë, në Brazili ka filluar të qarkullojë përsëri emri i tij dhe media e njohur braziliane "Sambafoot", ka hedhur hipotezën që Silvinjo mund të kthehet përsëri të marrë drejtimin e klubit të Korinthians. Ai është një idhull për tiorerinë vendase pasi ka qenë futbollist i kësaj skuadre, por aventura e tij si trajner atje në vitet 2021-2022,

nuk shkoi siç pritej. Klubi ka shkarkuar dje trajnerin Antonio Oliveira pas rezultateve të dobëta të kohëve të fundit dhe portali i "Sambafoot" shpjegon në shkrimin e tij se Silvinjo mund të jetë një alternativë për t'u marrë në shqyrtim nga drejtuesit e klubit në fjalë, ndonjëse nuk ka sinjale konkrete që të ketë kontakt mes palëve deri tani.

Qëndrimi i Dukës për çështjen "Silvinjo"

Pak ditë më parë kreu i FSHF-së Armand Duka, në një intervistë që dha për mediat në Kosovë, vuri në dukje faktin se federata e drejtuar prej tij ishte e intereduar të rinovonte me Silvinjon dhe se ky rinovim do

të ndodhte javën e ardhshme. Ai konfirmoi se Silvinjo është me pushime, dhe do të kthehet në Shqipëri javën e ardhshme. Kontrata përfundon me mbylljen e Europianit, praktikisht i bie të jetë mbyllur, kështu që ose do të kemi rinovim, ose do të ketë largim. "Kontrata me trajnerin ka mbaruar pas Europianit. Ne i kemi propozuar rinovimin që në janar. Besoj se tani së shpejti do e finalizojmë. Ne kemi pasur biseda. Secili njeri mendon për veten e tij. Nëse i vjen një shifër marramendëse, edhe mund të shkojë. Kontrata është e përfunduar kur e firmos në letër. Gjasat që të rinovojë, sigurisht që është mbi 50%. Ne bëjmë aq sa mundim për ta mbajtur, nuk mund të bëjmë më shumë se kaq. Në karrigen time, duhet të mendosh të gjitha gjërat. Dëshira për ta pasur është aq e madhe, sa ia kemi bërë që në janar ofertën për rinovim. Pas kthimit në Shqipëri bëjmë një festë të vogël me stafin. Sot Silvinjo iku të pushojë dhe do të rikthehet për të vendosur për të ardhmen. Do vendosim para se të përfundojë Europiani. Do shkojmë ta shikojmë finalen bashkë. Nëse del një klub i La Ligës dhe i jep 5 milionë euro, e ka hallall. Mançini la Italinë për një ofertë të majme", tha Duka.

MERKATO

Fiorentina do
Asllanin, Interi kërkon
35 mln euro

Sipas mediave italiane, Fiorentina është shumë e interesuar për Kristjan Asllanin si dhe ka kërkuar informacione rreth transferimit të tij. Asllani atje do të gjente rregullisht më shumë hapësira se sa ka aktualisht të Interi, ku gjithësesi mbetet një alternativë në pankinë dhe jo një zgjedhje e parë për Inzagin. Por pikërisht ajo që ka treguar ai gjatë Euro 2024, ka rritur shumë vlerësimin për mesfushorin. Mësohet se Bepe Marota tashmë kërkon 35 mln euro për të lënë të lirë Asllanin.

SULMUESI

Kristal Abazaj i
bashkohet klubit turk
Ankara Keçiorençyçy

Ish-sulmuesi i Tiranës, Kristal Abazaj, do të vazhdojë një aventurë të re. Ai është prezantuar tek klubi turk, Ankara Keçiorençyçy. Lajmi është bërë i ditur nga vetë klubi përmes një postimi në rrjetet sociale. Abazaj do të luajë edhe krahe mesfushorëve shqiptarë Uerdi Mara dhe Jurgen Bardhi. "Mirësevjen Kristal Abazaj! Ankara Keçiorençyçy ka arritur marrëveshjen me Kristal Abazaj. E mirëpresim Kristalin në klubin tonë dhe i urojmë suksese të mëdha nën fanellën tonë bardhevjollcë.

AMBICIA

Milani s'heq dorë nga
Broja, sërish në Londër
për bisedime

Armando Broja vijon të jetë objektivi i Milanit. Pikërisht shqiptari duket të jetë objektivi kryesor i vizitës që drejtuesit e Milanit po bëjnë në Angli. Problemet për të siguruar Zirkzen dhe pengesat e mëdha ekonomike për emra si Sheshko e Gimenez, detyrojnë kuqezinjtë që të synojnë dikë më ekonomik si Broja. Dëshira e drejtuesve të "Djallit" është ajo e huazimit me të drejtë blerje, teksa sulmuesi do të ishte një shtesë e mirëfilltë për vijën e parë, sidomos pas largimit të Olivier Zhiru.

Surpriza/ Djali i Rudi Vatës, Roko, nga Sëlltiku tek Uotfordi për 4 vjet

Lajmer interesante vijnë për legjionarët shqiptarë që luajnë në kampionate të ndryshme europiane dhe që një pjesë përfaqësojnë edhe ngjyrat e vendeve të tjera, sikurse ndodh me djalin e Rudi Vatës, Rokon, i cili me shumë gjasë në sezonin e ri do të jetë pjesë e klubit të njohur anglez, Uotfordit. Këtë e ka zbuluar eksperti i merkatos, Fabricio Romano,

i cili ka bërë të ditur se djali i ish-kapitenit të Kombëtares shqiptare Rudi Vata, tani do të jetë pjesë e Uotford, me të cilin do të firmosë për 4 sezonet e ardhshme. "Uotfordi ka arritur marrëveshjen për të firmosur talentin e lindur në vitin 2005, Roko Vata. Vizitat mjekësore do të kryhen të enjten. Selltik do të përfitojë një kompensim që kalon 200 mijë paund, kontrata

do të jetë deri në qershorin 2028", shkruante Romano në një postim në rrjetet sociale. Vata, i cili përfaqëson Irlandën në arenën ndërkombëtare, ka arritur të debutojë në sezonin e kaluar edhe me ekipin e parë të Sëlltik. Por mundësia për të luajtur me shumë te Uotford si dhe për t'u provuar në një futboll më cilësor si ai anglez, e ka shtyrë të ndërmarrë këtë hap



të rëndësishëm. Roko Vata ka pasur ftesë edhe nga Shqipëria, por ka zgjedhur të luajë për Skocinë.

kulturë

Kineasti Skënder Jaçe: Publiku në këto filma veç nostalgjisë shikon dhe një ndryshim në figurë dhe tek zëri

Filmat e restauruar shqiptarë në aktivitetin "Open Cinema"

Nga Julia VRAPI

Prodhime kinematografike shqiptare që mbajnë emrin e regjisorëve të njohur janë pjesë e rëndësishme në "Open Cinema", që këtë vit ka nisur edicionin e tetë. Edicioni i tetë i këtij aktiviteti me filmat, muzikën, të ftuar artistë të kinemasë shqiptare e më gjerë vijon këtë vit në 12 qytete të vendit tonë. Pas bregdetit të Golemit ku dhe u bë hapja e aktivitetit, do të jetë qyteti i Kukësit vendi i radhës ku filmat do të shfaqen për publikun. Këtë aktivitet në Kukës do ta hapë filmi i restauruar shqiptar "Lulëkuqet mbi mure", me regji nga Dhimitër Anagnosti. Producenti dhe kineasti Skënder Jaçe flet për rëndësinë e këtyre prodhimeve kinematografike në vendin tonë para viteve 1990 dhe për rëndësinë që ka restaurimi i tyre. Ai thotë se këto filma që janë restauruar vijnë me një cilësi më të mirë të publiku. "Publiku tek këto filma veç nostalgjisë, shikon dhe një ndryshim në figurë dhe tek zëri. Shikojnë një teknikë ndryshe", thotë kineasti Jaçe. "Open Cinema 2024" kinemaja shëtitëse në Shqipëri organizohet nga shtëpia kinematografike "Production Cinemania", e cila për këtë aktivitet që do të vijojë dhe në qytete të tjera të vendit mbështetet dhe nga bashkitë përkatëse ku zhvillohet. Kineasti Jaçe thotë se në këtë aktivitet ku veç filmit është dhe muzika, këngët interpretohen nga artistë të njohur të skenës sonë. "Në Golem ky aktivitet u prit shumë mirë. Ajo që binte në sy ishin dhe turistët e huaj, polakë, çekë e gjermanë. Filmi shqiptar dhe muzikaliteti i këngës shqiptare u prit me duartrokitje dhe kënaqësi të veçantë", thotë kineasti Jaçe.



Në aktivitetin "Open Cinema" që në datën 17 korrik pritet të nisë dhe në qytetin e Kukësit, veç filmit të restauruar "Lulëkuqet mbi mure" do të shfaqen dhe të tjerë filma të restauruar të kinemasë shqiptare. Mes tyre përmendim dhe filmin "Mësonjëtorja" i prodhuar në Shqipëri në vitin 1979...


Filmat në "Open Cinema"

Në aktivitetin "Open Cinema" që në datën 17 korrik pritet të nisë dhe në qytetin e Kukësit, veç filmit të restauruar "Lulëkuqet mbi mure" do të shfaqen dhe të tjerë filma të restauruar të kinemasë shqiptare. Mes tyre përmendim dhe filmin "Mësonjëtorja" i prodhuar në Shqipëri në vitin 1979. Regjia Muharrem Fejzo, skenari Natasha Lako, muzika Limos Dizdari, ku filmi u shfaq premierë i restauruar vjet në shtator. Filmi "Lulëkuqet mbi mure" me regji nga Dhimitër Anagnosti u shfaq i restauruar 47 vite pas realizmit të tij vjet në dhjetor. Kjo premierë nga Arkivi Qëndror Shtetëror i Filmit bashkoi në kinema artistët, që realizuan filmin 47 vjet

më parë. Filmi "Lulëkuqet mbi mure" është një prodhim i vitit 1976 me regjisor Anagnostin, skenari i të cilit u bazua në romanin "Bonjakët" të shkrimtarit Petraq Qafëzezi. Ngjarja në filmin "Lulëkuqet mbi mure" zhvillohet në një nga jetimoret e Tiranës në vitet e pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste gjatë Luftës së Dytë Botërore. Muzika e filmit është nga Kujtim Laro. Në aktivitetin "Open Cinema" janë dhe të tjerë filma të huaj dhe shqiptarë. Në prodhimet e kinemasë shqiptare përmendim dhe filmin "Mbjellja e pemëve" apo dhe ai me titull "Krimineli". "Open Cinema" do të jetë dhe në Durrës, në Kuçovë, në Maliq për herë të parë, Ersekë, Leskovik, Pukë, etj.

Kisha e Shën Mërisë paraqet interes të veçantë si një dëshmi arkitekturore

Kisha e Shën Mërisë është pasuri kulturore, me status monument kulture i kategorisë së parë. Kisha ndodhet në fshatin Shënmëri, Mamurras dhe Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore shprehet se paraqet interes të veçantë si një dëshmi arkitekturore, që mbart gjurmë të disa fazave ndërtimore e disa duar pikturimi që përfshijnë periudhën rreth shek. XI-XIV. IKTK shprehet se në kuadër të restaurimit të rrënojave të kishës së Shën Mërisë, u realizuan ndërhyrjet si më poshtë: Pastrimi i hapësirës përreth objektit nga vegetacioni; Heqja e elementëve jo autentikë brenda kishës; Restaurimi i murit të gurit antik me teknikën shqep-qep; Restaurimi i çarjeve në mur guri me teknikën e injektimit; Ndërhyrje në konsolidimin dhe konservimin e pikturës murale; Vendosja e një strukture të re metalike, me funksion estetik dhe mbrojtës për faltoren e kishës dhe pikturat murale të restauruara. Kisha e Shën Mërisë është i vetmi monument kishtar në krahinën e Kurbinit që gjatë periudhës se regjimit komunist tërhoqi vëmendjen e specialistëve të Institutit të Monumenteve të Kulturës. Ajo është shpallur monument kulture i kategorisë së parë më 15.1. 1963. Kisha e Shën Mërisë në Mamurras ishte dhe kantieri i radhës i programit "EU4Culture". Nisur nga vlerat e rralla historike dhe arkitekturore, pas tërmetit të vitit 2019, ky monument i kategorisë së parë, i shquar për pikturat murale të ruajtura në rrënoja, u fut në listën e ndërhyrjeve restauruese.



Një koncert në kuadër të projektit "Edukimi përmes artit"

Artistët e Ansambllit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve Popullore bashkë me nxënës shkollash në një koncert. Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit shprehet se koncerti u zhvillua në fund të projektit "Edukimi përmes artit". "Kënduam dhe kërcyem me nxënësit e gjimnazeve "Ismail Qemali", "Qemal Stafa", Shkollës së Baletit dhe shtëpisë së fëmijës "Zyber Hallulli" në përmblyllje të

projektit "Edukimi përmes artit". Gjatë kësaj periudhe, nxënësit mësuuan teknika dhe valle të ndryshme nga profesionistët të valles popullore. Projekte të tilla ndihmojnë në ruajtjen e trashëgimisë tonë kulturore dhe transmetimin e saj tek brezat e rinj", thuhet nga TKOB. Artistët e Ansambllit Popullor gjatë kësaj kohe kanë zhvilluar dhe koncerte të tjera nëpër qytete të ndryshme.

Muzeu "Marubi" prezanton imazhe të albumit "Japan"

Gjatë kohës që ekspozita "Felice Beato dhe Adolfo Farsari - Dy italianë në Lindjen e Largët (1863-1890)" do të qëndrojë e hapur, muzeu "Marubi" në Shkodër bën me dije se do të prezantojë disa prej imazheve të përzgjedhura pjesë e albumit "Japan", të shoqëruara me disa përshkrime origjinale. Këtë herë muzeu ka zgjedhur "Priftërinjtë ose Zen Shu". "Këta priftërinj janë të sektit Nitchi-ren-shu, një urdhër

i cili ka rreth gjashtëqind vite që ekziston", thuhet te përshkrimi. Ekspozita është kuruar nga fondacioni "Alinari" për fotografimin me konsulencën shkencore të Rossella Menagazzo, që është profesore dhe asociuar e Historisë së Artit Aziatik në Universitetin e Milanos që nga 2012. Është emëruar Drejtuese e Departamentit të Kulturës në Pavijonin Italian të Expo 2025 në Osaka.

At Gjergj Guxeta botoi shkrime në mbrojtje të kombit shqiptar

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët kujtoi një prej figurave më të rëndësishme të kulturës arbëreshe, Gjergj Guxeta. QSPA shprehet se At Gjergj Guxeta (1682-1756), ishte një nga figurat më të rëndësishme të kulturës arbëreshe, me prejardhje nga Hora e Arbëreshëvet, që hodhi themelet për ruajtjen e gjuhës dhe traditave shqiptare në Sicili. "At Guxeta ishte themeluesi Seminarit greko-shqiptar të

Palermos më 1734, i njohur ndryshe si Seminari Arbëresh i Palermos, ku u përgatitën ipeshkvit, meshtarët, atdhetarët e shkrimtarët e njohur arbëreshë në Sicili që kishin origjinë të njëjtë si ai. Ai ishte nismëtar i themelimit të Kolegjit të vajzave arbëreshe të Sicilisë. Botoi një sërë shkrimesh në mbrojtje të kombit shqiptar dhe themelimin e Seminarit të Palermos, që do të bëhej një nga vatrave kryesore të kulturës", thuhet nga QSPA.

Tre shfaqje vijnë në skena të ndryshme gjatë korrikut

Artistët e TKOB me koncerte dhe shfaqje baleti në skena të tjera përgjatë korrikut

Nga Julia VRAPI

Vepra baleti apo dhe koncerte me muzikë filmash vijnë përgjatë muajit korrik nga artistët e Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit. Edhe pse sezoni artistik është mbyllur në këtë institucion, aktivitetet po vijnë për sezonin veror nëpër qytete të ndryshme. TKOB ka ndarë dhe programin artistik që do të vijojë përgjatë këtij muaji. Baleti "Fatalita" ishte vepra që mbylli sezonin artistik në Teatrin Kombëtar të Operës dhe Baletit, por që teatri bën me dije se do të shfaqet nesër në qytetin e Durrësit. "Në zemër të amfiteatrit, si ngahera, do të luhen për të gjithë artdashësit vendas dhe të huaj baletet "La Traviata" dhe "Carmen". Koreografi Toni Candeloro vendos në qendër të koreografisë së tij gruan përtej nocionit të vdekjes, duke sjellë primabalerinën e TKOB-së, Enada Hoxha, në rolet e Violetës dhe Carmen-it, dy mite të kryeveprave botërore", shprehet Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit për këtë shfaqje që do të jetë te amfiteatri antik i Durrësit, pas skenës së TKOB-së. Baritoni i mirënjohur shqiptar, Gëzim Myshketa vjen në qytetin e tij të lindjes, Durrës, me një koncert recital për të gjithë qytetarët që do të zhvillohet në mbrëmjen e 6 korrikut në amfiteatrin antik të Durrësit. Baritoni Gëzim Myshketa, "Mjeshtër i Madh" është fitues i disa çmimeve prestigjioze është i njohur për debutimet e tij në kryevepra botërore në skenat e teatrove të shteteve të ndryshme si të Italisë, Japonisë, Koresë, SHBA-së, Gjermanisë dhe më gjerë. I shoqëruar nga kori, solistët dhe Orkestra Simfonike e TKOB-së, baritoni Gëzim



Koreografi Toni Candeloro vendos në qendër të koreografisë së tij gruan përtej nocionit të vdekjes, duke sjellë primabalerinën e TKOB-së, Enada Hoxha, në rolet e Violetës dhe Carmen-it, dy mite të kryeveprave botërore", shprehet Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit për këtë shfaqje që do të jetë te amfiteatri antik i Durrësit, pas skenës së TKOB-së

Myshketa do të interpretojë një përzgjedhje këngësh shqiptare, duke përfshirë "Të falem i bukri Durrës", "Për ty At dhe" dhe "Pragu i vegjëlisë", po ashtu repertori do të përmbajë edhe pjesë të njohura ndërkombëtare si "Parla piu piano", "Funiculi Funicula" dhe "Caruso". Në datën 10 korrik "Carmina Burana", me thirrjen e saj të fuqishme "O Fortuna" është në qytetin bregdetar të Vlorës për të udhëtuar pastaj drejt Kotorit të Malit të Zi. "Carmina Burana" ndryshe nga herët e tjera në skenë më parë erdhi si një opera-balet me koreografi e skenografi të Yuri Vamos në TKOB. "Carmina Burana" është kompozuar nga gjermani Carl Orff në vitin 1936. "Uni" balet kontemporan që erdhi më parë në skenën e Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit për publikun me koreografi të Julind Dervishit

dhe nga trupa e baletit do të jetë më 12 korrik në Pogradec, 20 korrik në Sarandë, 21 korrik në Vlorë dhe 26 korrik në Durrës.


Koncertet në program

Programi artistik këtë muaj përmban dhe koncertin vokal-simfonik "Ennio Morricone" që do të jetë për publikun nga TKOB në Durrës më 19 korrik. Ennio Morricone ishte një prej kompozitorëve më të mëdhenj në botë i kolonave zanore. Kompozimet e mjeshtër të madh Morricone, të njohura botërisht për stilistikën e përdorur për kolonat zanore të mbi 500 filmave dhe seriale televizive erdhën më parë për publikun përmes një koncerti, që u zhvillua me artistët në Teatrin Kombëtar të Operës dhe Baletit. Në vijim për publikun vjen dhe një tjetër koncert. Koncerti simfonik "Kinostudio" do të jetë më 28 korrik në qytetin e Pogradecit.

Ekspozita, që i kushtohet 34-vjetorit të eksodit shqiptar në ambasada

"Tiranë, Korrik 1990 - Arratisje në Ambasadën Gjermane" është një ekspozita digjitale që u hap nga Ambasada Gjermane në vendin tonë. 34 vjet më parë, mijëra shqiptarë mësynë Ambasadën Gjermane në Tiranë për të kërkuar mbrojtje nga regjimi komunist. Rreth 5.000 persona kërkuar strehim në ambasadat e huaja dhe mbi 3.200 persona gjendeshin në ambientet e Ambasadës Gjermane. Ekspozita digjitale paraqet imazhe origjinale nga kjo periudhë dhe mundëson të mësohet më shumë rreth këtyre ngjarjeve historike. Ambasadori Karl Bergner, prezantoi këtë ekspozitë përmes një postimi në faqen online të Ambasadës Gjermane në vendin tonë. "Njerëzit

ishin në kërkim të lirisë, mirëqenies, në kërkim të një fillimi të ri. Një pjesë mes tyre ishin të frymëzuar edhe nga pamjet e transmetuara në televizion për refugjatët gjermano-lindorë të vitit 1989", shkruan ambasadori Bergner. Ambasadori tha se, përmes ekspozitës nderohet kurajoja e të larguarve si dhe përkujtohen viktimat e përndjekjes politike nën sundimin komunist. "Edhe pse ato dhjetë ditë të pushtimit të Ambasadës ishin vetëm një episod i shkurtër, ajo arratisje masive paralajmëroi fillimin e ndryshimit politik në Shqipëri", vijon më tej ambasadori Bergner. Sipas tij, kjo ekspozitë virtuale, e cila tregon pamje origjinale të asaj periudhe, u prezantua për herë të parë në vitin 2020 me rastin e 30 vjetorit. "Për shkak të rëndësisë së ngjarjeve dhe imazheve lëvizëse, ne kemi vendosur ta vendosim sërish këtë ekspozitë online", thotë më tej ambasadori. Më tej Bergner thotë se Shqipëria është sot pjesë e familjes evropiane dhe një vend me një proces jo gjithnjë të lehtë transformimi pas vetes. Gjermania sipas tij do të vijojë të jetë edhe në të ardhmen në krah të qytetarëve shqiptarë në rrugën e tyre drejt Bashkimit Evropian.



Pastrimi i territorit në kishën e Kosinës në Gjirokastrë

■ Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë ka kryer pastrimin e territorit nga vegetacioni në kishën Fjetja e Shën Marisë, që është monument kulture kategori e parë në fshatin Kosinë të Përmetit. DRTK shprehet se kjo kishë është e tipit Kryq i brendashkruar ku formimi i kryqit bëhet nga mbulesa me sistem qemeri në brendësi dhe ndërtimi i çatisë në nivel të ndryshëm

në anën e jashtme. "Narteksi është në formë drejtkëndëshi dhe mbulohet me qemer cilindrik me formë drejtkëndësh dhe mbulohet me qemer cilindrik me formuese veri-jug. Në pjesën qendrore të naosit vendosen dy shtylla dhe mure anësore dhe tamburi me kupolë ngrihet me ndihmën e trekëndshave sferikë. Kupola është tërësisht e zhvilluar dhe e variantit provincial", thuhet ndër të tjera nga DRTK.

Shfaqja e teatrit të kukullave "Smërfët dhe Gargamela" në Vlorë

■ Artistët e Teatrit të Kukullave po vijnë me shfaqje nëpër qytetet e vendit. Artistët e këtij teatri me shfaqjet do të jenë sot në Vlorë. "Teatri tashmë mikpritet kudo shkon me turin e tij veror, ndaj këtë herë ja lëmë radhën qytetit të bukur bregdetar të Vlorës, që të na presë me shfaqjen "Smërfët dhe Gargamela" në datën 4 korrik në orën 19: 30 në Lungomare. Ju presim fëmijë që të kalojmë

një pasdite plot energji e gëzim me personazhet tona të dashur", thuhet nga teatri në faqen e tij. Pak ditë më parë ishte shfaqja "Tre Muskëterët" që u shfaq në Rubik, duke plotësuar akoma edhe më shumë gjeografinë e turit artistik gjatë sezonit veror. Kjo shfaqje plot energji mori duartrokitje përgjatë gjithë lojës së aktorëve, duke i dhuruar kënaqësi fëmijëve të këtij qyteti.

MHK: Frang Bardhi shkruesi i parë i një fjalori për gjuhën shqipe

■ Muzeu Historik Kombëtar përkujtoi 381-vjetorin e ndarjes nga jeta të ipeshkvit, shkrimtarit, leksikografit, folkloristit dhe etnografit shqiptar, Frang Bardhi u lind në vitin 1606 në Kallmet, në krahinën e Nënshatit të Zadrimës. Vinte nga një familje e klerike e Zadrimës. Studioi në Seminarin e Loretos në Itali. MHK shprehet se Frang Bardhi ishte ipeshkvi i Sapës. "Ishte shkruesi i parë i një fjalori për gjuhën shqipe,

i cili ka rreth 5000 fjalë të përkthyer nga latinishtja në shqip, si dhe numërorë, emra vendesh dhe një sasi fjalësh të urta e shprehesh të mbledhura në krahina të ndryshme të Shqipërisë. Kjo bën që Bardhi të jetë leksikografi i parë i gjuhës shqipe dhe folkloristi e etnografi i parë shqiptar i njohur deri më tani", thuhet nga MHK. Vepra më e njohur e Bardhit është "Apologjia e Skënderbeut", botuar në latinisht më 1636 në Venedik.

kulturë

Aktorët Ben Affleck dhe Matt Damon në filmin e ri "RIP"

Ben Affleck dhe Matt Damon janë të suksesshëm në kinema. Por ata do të vijnë me role në filmin e ri "RIP", i cili do të shfaqet në platformën transmetuese "Netflix". Detaje të tjera nuk janë bërë të ditura, ndërkohë që filmi do të prodhohet nga kompania "Artists Equity", e cila u themelua nga Affleck dhe Damon, shkruan

"Deadline". Projekte të tjera të njohura të kësaj kompanie janë filmi "Small Things Like These", ku luan aktori Chillian Murphy, filmi "The Accountant", dhe filmat e udhëhequr nga artistja Jennifer Lopez "Unstoppable" dhe "Kiss Of The Spider Woman". Aktorët Ben Affleck dhe Matt Damon kanë qenë bashkëpunëtorë prej një

kohë të gjatë. Për herë të parë u bashkuan në vitin 1997 për realizimin e projektit filmik "Good Will Hunting", projekt ky që i çoi të dy të fitonin nga një çmim "Oscar" për skenarin më të mirë original. Ata luajtën bashkë në vitin 2021, në filmin e Ridley Scotit "The Last Duel", bashkë me artistë si Jodie Comer e Adam Driver.



FJALEKRYQI SOT

1	2	3			4	5	6			7	8	9	10		11
12				13						14					
15				16					17					18	
		19						20					21		
	22						23					24			
25					26						27				
28				29						30					31
32			33							34					35
		36							37				38		
39							40						41		

HORIZONTAL

1- Lloj sporti 4-I vogli i pelës 7- Një kryeqytet europiano-lindor 12- Koço, dirigjent 13- Tip autoveture ruse 14- Ish nxënës i shkollës së ulët ushtarake 15- Mane i skenës 17- Ceremonia martesore 18- Pohojnë italianët 19- Dele me lesh të dredhur 20- I prodhon druri i dushkut, janë ushqim për bagëtinë dhe e pëlqen ariu, shumë 21- Shkrimtari amerikan Tomas ... 22- Solo me klarinetë 23- Filmi artistik "... mbi tela" 24- Specialisti i sigurimeve shoqërore Fadil ... 25- Aktori Spiro ... 26- "... Koperfilm" një roman nga Dickens 27- I thonë dardhës italianët 28- Lum në Rusinë Lindore, rrjedh nga malet Altai 29- Jam në hall, në mëdyshje apo në ... 30- Një shtet në Lindjen e Mesme 32- Aktori amerikan Istvud në inic 33- Është gjini e humorit, i pashquar 34- Njeri që dyshon dhe nuk beson në realitetin e botës dhe të vërtetës objektive 36- Hekurpunues 37- Filmi italian "... dhe vëllezërit e tij", mbrapsht 38- Stacioni televiziv ... News 39- Bakërpunues 40- Ish aktori Boshnjaku 41- Kofi... ish sekretar i OKB-së.

VERTIKAL

1- Magazinë 2- Gjika aktore, tek filmi "Vetmi" 3- I thonë edhe kështu popullit 4- Shkuan, dialektore 5- Emër vajze 6- Ndajfolje sasive 7- I thuhet edhe uror, copë çeliku për të ndezur eshkën 8- Njëlloj si zakon, rit apo ves 9- Viç 1-3 vjeç, mashkull që mbahet për ndërzmim 10- Trebicka i skenës në inic 11- Është lum në veri 13- Cangonji i skenës 14- Një shtet në kontinentin amerikan me kryeqytet Otava, pa të fundit 16- Kuçedër 17- Atë e merr gjykata 18- Konstruksion betoni për ndërtim 20- Atje gjendet muzeu historik i Parisit dhe pallati presidencial 21- E ka hak, ose ... 22- Një figurë gjeometrike 23- Ulje mbi gjunjë 24- Bimë fjetet e së cilit bëhen thasë e litarë 25- Është hamall në port 26- Ai i Ana Frankut 27- Arbitri italian ... Luixhi Kolina 29- Sherr, grindje, shamatë 30- Robert ... eksplorator anglez 31- Nuk disponojnë 33- Gazeta që ke në dorë 34- Lloj sporti 35- Organizatë terroriste në Irlandë 36- Këshilli i Ministrave 37- Uzinë Elektrike.

SUDOKU

				5	2			
	3		6			2	9	
			8	3				6
		1	7					4
6	7					5		2
2					3	7		
9				4	6			
	8	4			1		6	
				5	8			

				2				
8	2					1		3
	9		3	1	7			
3					1	4		2
	6						3	
7		2	4					6
			5	7	2		8	
9	7						1	5
				8				

2	7					9	1	
		1					6	2
	9	4				8		
			4	7			9	6
7				8	9			
	1							
9			6	7			3	8
	4	6				5		
						3		

Bebe Rexha: Mund të shkatërroj një pjesë të industrisë së muzikës

Bebe Rexha ka sulmuar industrinë e muzikës përmes disa postimeve, që ka bërë në rrjetin social "X". Ajo u bë e famshme pasi shkroi këngë për emra të famshëm si Eminem, Selena Gomez, Tyler Hubbard, Nick Jonas e shumë të tjerë. Këngëtarja e hitit "Say My Name", e cila që nga fillimi i karrierës ka qenë në bashkëpunim me shtëpinë diskografike "Warner Records", pretendon se mund të shkatërrojë një pjesë të madhe të industrisë së muzikës. "Mund ta shkatërroj një pjesë të madhe të kësaj industrie. Jam e frustruar. Kam qenë e minuar. Kam heshtur për një kohë të gjatë. Nuk i kam parë shenjat edhe pse njerëzit më kanë paralajmëruar vazhdimisht dhe kanë qenë kaq të dukshme. Edhe kur kam folur jam detyruar të hesht dhe jam ndëshkuar nga kjo industri", ka shkruar ajo. Rexha filloi të merrej me muzikë që në fëmijëri.



Dënimi

Dy të burgosur bisedonin me njëri-tjetrin:
 -Sa je dënuar?
 I burgosuri i dytë, që ishte dhe më i vjetër në qeli:
 -Tre javë.
 I burgosuri që sapo kishte ardhur në atë qeli:
 -Tre javë? Po çfarë ke bërë që je dënuar kaq pak?
 I burgosuri më i vjetër:
 -Kam vrarë pesë persona.
 I burgosuri i ri, tepër i çuditur
 -Dhe të kanë dënuar vetëm tre javë? Unë vetëm pse kam vjedhur një portofol më kanë dënuar një vit
 I burgosuri i vjetër:
 -Po, por mua pas tre javësh më pret karrigia elektrike.

Peshqit në akvarium

Një çift kishte ditë që kishte blerë një akvarium të madh. Pasi kalon java gruaja i thotë bashkëshortit:
 -I dashur, ua ke ndërruar ujin peshqve?
 Burri përgjigjet:
 -Po, ata akoma nuk e kanë mbaruar atë që i kemi hedhur para një jave.

kulturë

www.sot.com.al

Një anije e braktisur ka ngjallur shumë kureshtje. E quajtur "një anije fantazmë" për pamjen e saj të frikshme, ajo u pa në breg disa javë pasi i mbijetoi një uragani. Sipas mediave të huaja, banorët e Pensacola Beach u tronditën kur panë një varkë me vela të grisura në Panhandle të Floridës. Ajo, siç thuhet tej, u pa në mbrëmjen e 18 qershorit. Postimet në rrjetet sociale të "anijes fantazmë" arritën në një përfundim. Sipas tyre, ajo kishte nisur lundrimin më 21 maj, duke u nisur për në Rockport, Teksas.

Anija, që i mbijetoi uraganit



Përgjigjet e fjalëkryqit

B	O	R	D	O	S	L	I	T	E
A	K	A	P	I	T	A	L	K	
S	D	B	E	L	I	K	M	I	
M	I	K	N	I	K	P	O	P	
E	N	E	T	R	A	K	E	T	E
A	N	E	T	T	O	N	I		
E	M	I	S	A	8/R	L	E	V	A
L	I	A	T	5/I	M	L	E	K	
I	T	S	I	4/N	O	R	T	O	
T	S	O	M	3/A	L	I	A	M	
A	L	E	T	E	A	M	I	T	A

Microsoft investim në qendrën e të dhënave në Spanjë

Një projekt i madh i qendrës së të dhënave në Spanjën verilindore bën që Microsoft të investojë 2.2 miliardë euro (2.4 miliardë dollarë). Njoftimi, i cili pason plane të tjera të zbuluara nga gjiganti i softuerit amerikan, rrit në afro 6.7 miliardë euro investimin e planifikuar të Microsoft në Aragon, u tha gazetarëve udhëheqësi rajonal Jorge Azcon, shkruajnë mediat e huaja. Ai gjithashtu pason një njoftim të ngjashëm nga Amazon, i cili në maj tha se divizioni i tij i kompjuterave cloud do të investonte 15.7 miliardë euro për të zgjeruar qendrat e saj të të dhënave në Aragon, ku aktualisht ka tre që operojnë.

Fjalëkryq i shifruar

5	1	2	3	4	5	10	2	1	4
1	13	4	11	4	1	2	3	7	
6	11	3	4	1	2	10	8	9	
8	2	14	10	4	11	3	15	8	
4	3	6	7	3	4	16	4	7	6
9	16	9	7	1	2	11	4		
12	10	4	3	6	1/T	3	4	1	2
5	2	1	17	4/A	1	1	9	3	
2	11	3	9	11/N	4	3	7	4	
8	8	2	10	2/I	1	9	11	8	
2	3	9	11	6	4	10	2	16	2

1			2	3		4	5			6
			7		8					
		9						10		
11	12			13				14	15	
16			17				18			
	19					20				
21					22					
23				24						25
26			27						28	
		29						30		
	31						32			
33						34				
35					36		37			38
39				40		41		42		
		43	44				45			
			46							
47								48		

HORIZONTAL

1- Teatri i Fierit 4- Është lidhëse, të paktën 7- Stacioni televiziv ... News 9-Pikë turistike në Pogradec 11- Profil metalik 13-Tani me dialekt 14- Ka edhe një të tillë fetar 16- Një ngjyrë 18- Është shpend shtëpiak femër 19- Greta e këngës popullore 20- Pjesë e penxheres 21- Kongoli i muzikës 22- Njësi e vogël e shitjeve të rrobave të gatshme 23- Një nënë gjirokastrite 24- Një variete rrushi 26- Notë muzikore 27- Njëllot si kapriçiot 28- Notë në pentagram 29- Kacak prej lëkure ku mban ushqimet bariu 30- I thërrasin myzeqar për ledhatim 31- Sëmundje e rëndë e mushkërive 32- Janë 114 kapitujt e Kuranit 33- Vend me baltë dhe llucë 34- Filmi artistik italian "... me vëllezërit e tij" 35- Vladi i këngës 37- "... e Forsajtëve", një roman trilogji (1906-1921) nga novelisti Xhon Gollsuorth 39- Lumë në Gjermani 40- Është figurë gjeometrike 42- Ish-kancelari gjerman Helmut ... 43- Pjesa përmblyëse e një veprë letrare 46- Difekt 47- Personazhi kryesor të filmi "Brazdat" 48- Erë e këndëshme që gudulis hundën.

VERTIKAL

1- Një mineral me ngjyrë 2- Gjika e skenës të filmi "Vetmi" 3- Ndërtesa ku ushtron funksionet e tij një organ drejtues 4- "plaku ..." të filmi "Njeriu me top" 5- Ngatër e mbjellë 6- Ato nuk vijjnë shpesh prandaj duhen shfrytëzuar 8- Futbollisti gjerman Khedira, luan me Juven 9- Ovale 10- Ngjarje të shkurtra në RTV 12- Qytet në Zvicër 15- ... Newton, fizikant, filozof, astronom, teolog dhe matematicien i madh anglez 17- Vasili gazetarë 18- Shlyerja e borxhit pjesë-pjesë, shumë 20- Ish-fshatar i pasur i pasluftës 21- Një qytet bregdetar në jug të Italisë 22- Aktori Fehmiu 24- Po ky numër njësoj si horizontalisht dhe vertikalisht 25- Veprim mashtrues apo dredhi për mashtrim 27- Grup njerëzish me mendime dhe interesa të përbashkëta 28- Vajza që qëndisi flamurin e I.Qemalit 29- I thonë ndryshe pishës së zezë 30- Futbollisti Romelu ... që luan me Interin 31- Çekiç i madh 32- Sinjal i koduar për ndërhyrje emergjente 33- Lloj makaronash italiane 36- Ish-sopranoja Nina ... 38- Vegla 40- Një frutë mesdhetar dhe tropikal 41- Lloj detergjenti larës 44- Firmë e njohur e baterive të automjeteve 45- Aktori amerikan Riçard ...

HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI

Dashi
21 mars – 20 prill

Hëna dhe Venusi do ju bëjnë me humor të mirë gjatë kësaj dite. Do e shihni çdo gjë me pozitivizëm.

Demi
21 prill – 21 maj

Pavarësisht sfidave që do iu dalin para sot, ju sërish do dini si të ruani qëndrueshmërinë dhe ekuilibrin në çdo plan.

Binjakët
22 maj – 21 qershor

Sot do keni një vendosmëri për t'u adhuruar dhe do ja dilni mbanë të përmblyni edhe gjërat më të vështira.

Gaforrrja
22 qershor – 22 korrik

Në punë do e keni paksa të vështirë për të realizuar çdo gjë që keni planifikuar, megjithatë nuk do dorëzoheni.

Luani
23 korrik – 22 gusht

Saturni do jetë planeti që do ju mbështetë sot dhe do vërë rregull në çdo fushë. Durimi do jetë një virtyt i çmuar.

Virgjëresha
22 gusht – 22 shtator

Në planin financiar duhet të bëni kujdes nga influenza negative e planetëve, sepse ata do iu nxitin të shpenzoni shumë.

HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI

Peshorja
23 shtator – 22 tetor

Gjatë kësaj dite do dini të bëni ndryshimet e nevojshme vetëm që gjërat t'iu ecin sa më mirë dhe të ndihen më të qetë.

Akrepi
23 tetor – 21 nëntor

Gjatë kësaj dite do jeni të gatshëm të bëni edhe kompromise vetëm për të arritur më të mirën në çdo fushë.

Shigjetari
22 nëntor – 21 dhjetor

Sot nuk do keni më një ditë të vështirë për kundrazhi do ndiheni më të qetë e do bëni gjëra interesante.

Bricjapi
22 dhjetor – 21 janar

Gjatë kësaj dite do jeni në gjendje të kontrolloni humorin tuaj dhe inatin do e largoni me diplomaci.

Ujori
22 janar – 19 shkurt

Në punë duhet të keni besim tek intuita dhe keni për ta parë sa mirë kanë për t'iu ecur gjërat.

Peshqit
20 shkurt – 20 mars

Sot do keni tendencë të ngatëroni çdo gjë dhe nuk do arrini dot atje ku doni. Nuk ka për të qenë fiks dita që keni ëndërruar.

Turqia mes suksesit dhe frikës së penalteteve nga UEFA, shkak organizata terroriste “Ujqërit Gri”

Futbollisti ka festuar golat e tij me shenja naziste të triumfit të kombeve turke, gjeste këto që janë cilësuar në Austri si të lidhura me organizatat terroriste

Adriatik BALLA

Turqia ishte skuadra e fundit nga 16-shja që u kualifikua për në 8 më të mirat e Kampionatit Europian Gjermani-2024. Por sukcesi i saj 2-1 ndaj Austrisë pati dhe episode që kanë nxitur UEFA-n të hapë hetime nëse kemi të bëjmë me sjellje raciste të lojtarëve dhe gjeste që janë të lidhur me organizata terroriste apo dhe fyerje me baza racore e fetare ndaj rivalëve në Europian. Kështu, referuar raporteve të fundit që japin media të ndryshme sportive në Europë, UEFA ka nisur një hetim ndaj mbrojtësit të Turqisë, Merih Demiral. Ky i fundit, autori i dy golave që i dhuruan fitoren 1-2 turqve përballë Austrisë, është nën hetim për festën e tij pas golit të dytë. 26-vjeçari, festoi me dy duart lart duke bërë atë që quhet gjesti i “Ujqërve Gri”. Një gjest i konsideruar si fashist, ndërsa në Turqi



ka edhe një parti e cila quhet “Zemrat Idealiste”, por që në informalitet të gjithë e njohin si “Ujqërit Gri”, teksa përfaqësojnë unitetin e atyre që konsiderohen si kombe turke në botë. Ky gjest i Merih Demiral është i ndaluar në Francë dhe Austri, teksa në parlamentin austriak në vitin 2019, u kalua një ligj që ndalonte simbolet e organizatave ekstremiste. Nga ana tjetër, për këtë ligj të kaluar në parlamentin

austriak, Turqia e dënoi duke e konsideruar si një gabim të madh. Kështu, Demiral ka përfunduar nën hetim nga UEFA për një gjest që konsiderohet ideologji ekstremiste dhe raciste dhe rrezikon një gjobë apo edhe pezullim. Mbetet të shihet se cili do të jetë ndëshkimi për futbollistin turk, ndërkohë që një tjetër lojtar, i cilësuar madje si talent i kombëtares turke, ka thënë se ambicia e Turqisë është të shkojë

në katërshe. Ai është Arda Guler, i cili ishte vendimtar me asistimin për golin e dytë të Demirali-t në fitoren 2-1 të Turqisë ndaj Austrisë, në raundin e 1/8-ave të EURO 2024. Duke folur për mediet pas këtij takimi, mesfushori turk u shpreh se Holanda, kundërshtari i radhës, është shumë i vështirë, teksa shtoi se synon që të shkojnë në gjysmëfinale. “Merih shënoi dy gola të bukur, goli i dytë erdhi falë një goditjeje të shkëlqyer me kokë. Jam shumë i lumtur që kam dhënë asistimin tim të parë, pasi shënova golin tim të parë në turne, por më e rëndësishmja është fitorja e ekipit. Jam shumë i lumtur që kam kontribuar. Në çerekfinale? Jam shumë i emocionuar që do të luaj në Berlin para tifozëve tanë. Holanda do të jetë një kundërshtar i vështirë për t'u përballur, por ne besojmë dhe duam të shkojmë në raundin tjetër”, deklaroi Guler.

Deklarata/ Bufon: Askush i sigurt pas Europeanit, Italia dështoi

Italia zhgënjeu në Euro 2024, teksa axurrët kaluan mes shumë vuajtjesh grupin dhe më pas u eliminuan në 1/8-tat nga Zvicra. Kritikat nuk kanë munguar, ku në “gijotinë” janë lojtarët dhe trajneri Luciano Spaletti. Ky i fundit kërkon që të vazhdojë aventurën me Italinë pavarësisht kritikave, megjithatë ka edhe nga ata që e vendosin veten në diskutim. Fjala është për shefin e delegacionit të kombëtares, Xhianluigji Bufon. Ish-portieri

shprehet se nuk e di nëse do të vazhdojë detyrën në kombëtare ndërsa tha se nuk fshihet kurrë nga përgjegjësitë. “Pas asaj që ndodhi, e sigurt është se një reflektim duhet ta bëjmë të gjithë. Nuk më pëlqeu ai eliminimi me Zvicrën dhe sidomos mënyra se si u eliminuam. Dhe, duke qenë një nga ata që nuk fshihem kurrë nga përgjegjësitë, më duket normale që edhe roli im në kombëtare të jetë në diskutim”, u shpreh Bufon.



BEFASIA

Një tjetër Thuram i bashkohet Juves, këtë herë Kefren



Juventus po bën namin në merkato dhe, pas Daglas Luiz, ka arritur marrëveshjen me një tjetër mesfushor. Kefren Thuram do të jetë futbollisti më i ri i bardhezinjve, me 23-vjeçarin që do të provojë të lërë gjurmë në të njëjtin klub ku ka shkëlqyer edhe i ati, Lilian Thuram. Torinezët kanë arritur marrëveshjen me Nice për shifrën e 20 milionë eurove, plus 5 të tjera


në formë bonusi, teksa Thuram do të firmosë një kontratë 5-vjeçare, me pagë 2.5 milionë euro në sezon. Aktualisht klubet po shkëmbejnë dokumentet, me mesfushorin 23-vjeçar që pritet të fluturojë në Itali për të kryer testet mjekësore dhe për të bërë prezantimin zyrtar me klubin bardhezi. Kefren Thuram e bën kështu edhe më interesant duelin Juventus-Inter në Serinë

A, pasi me fanellën zikaltër luan tashmë vëllai i tij, sulmuesi Marcus Thuram, i cili është titullar i padiskutueshëm i formacionit të Inzagit. Thuram luajti 29 ndeshje me Nice, duke treguar se di të bëjë disa role të mesit të fushës, përfshi edhe atë para mbrojtjes, teksa bashkë me Daglas Luiz, pritet të ndryshojnë jo pak mesfushën e klubit të Juventusit.

EUROPIANI

Joselu: Spanja duhet të ruhet nga Kros i Gjermanisë

Spanja ka bërë një rrugëtim shumë të mirë në Kampionatin Europian deri më tani, megjithatë tashmë është momenti për t'u përgatitur për një nga ndeshjet më vendimtare, atë ndaj Gjermanisë. Duke folur për mediet, ndërsa janë duke u përgatitur për këtë përballje, sulmuesi i Spanjës, Joselu u shpreh se Gjermania është një ekip i madh, por theksoi se rëndësi për spanjollët ka vetëm fitorja. “Ne përballemi me një ekip të madh. Për ne është



shumë e rëndësishme të fitojmë për t'u kualifikuar. Duhet të bëjmë kujdes veçanërisht nga Toni Kros”, u shpreh Joselu.

SITUATA

Zvicra e shqetësuar, Xhaka bën stërvitje individuale

Zvicra mposhti Italinë në 1/8 dhe u kualifikua. Në çerekfinale ajo do të përballlet me Anglinë. Ndërkohë, edhe ditën e djeshme kapiteni i Zvicrës, Granit Xhaka, është stërvitur i vetëm. Ai ka pasur telashe me muskujt e kofshës javën e kaluar, por një kontrollim i detajuar ka treguar që Xhaka nuk ka lëndim. Megjithatë të martën e të mërkurën mesfushori ka bërë stërvitje individuale. Të mërkurën stërvitje individuale bëri



edhe Ruben Vargas. Xhaka pritet të jetë i gatshëm për ndeshjen çerekfinale të Euro 2024 ndaj Anglisë, që zhvillohet të shtunën.

DEKLARATA

Lehman: Spanja ekip “fëmijësh”, kualifikohet Gjermania

Ish-portieri i Gjermanisë, Jens Lehman, tha se Gjermania e futbollit ka përparësi, pasi e sheh Spanjën si ekip “të rinjsh pa eksperiencë”. Spanja e drejtuar nga Luis de la Fuente dhe Gjermania e Julian Ngaelsmanit, kanë qenë dy prej më të mirave në këtë Evropian. “I kemi parë rezultatet e mira të arritura nga Spanja në grupe. Në aspektin e teknikës, ata ndoshta janë më të mirë se ne. Por lojtarët janë të rinj dhe pa eksperiencë,



ekip fëmijësh. Kanë lojtarë shumë të rinj që nuk kanë eksperiencë ndërkombëtare”, është shprehur Lehman për “Welt TV”.

STAFI/

DREJTOR/ Arjan PRODANI;
ZV/KRYEREDAKTOR: Elmas BOGDANI;

KRYEREDAKTOR/ Rigels SELIMANI; (067 5000 200)
KULTURË/ Julia VRAPI; SPORT/ Adriatik BALLA; MENAXHER SHITJE/ Shpëtim Caco

MARKETING: Glen PRODANI (Cel: 068 60 33 098);
email: gazetasotnews@gmail.com